



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 28/2024 regjistër (JR)  
Datë 19.07.2024

Nr. 80 i vendimit  
Datë 06.11.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 06.11.2025, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit, z. Agron Zhukri, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 759, datë 19.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 5 dhe 63 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Agron Zhukri (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë (në vijim “Kushtetuta”), dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave<sup>1</sup> (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar i Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
3. Komisioni kreu hetimin e plotë administrativ vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe në përfundim të procesit të rivlerësimit, *Komisioni krijoi bindjen se, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Agron Zhukri nuk arrin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të vlerësimit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, dhe vendimi është marrë bazuar vetëm në përfundimet e arritura pas rivlerësimit të kriterit pasuror, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.*
4. Komisioni, në përfundim, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, dhe të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 759, datë 19.04.2024, vendosi: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Agron Zhukri, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*”.

### II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

5. Kundër vendimit nr. 759, datë 19.04.2024 të Komisionit, ka ushtruar ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) subjekti i rivlerësimit Agron Zhukri, i cili i ka kërkuar prishjen e vendimit të Komisionit dhe urdhërimin e KLGj-së, si organ tashmë me kompetencë

---

<sup>1</sup> ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2018, me lëndë: “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Agron Zhukri, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, informon se, në përfundim të verifikimeve të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstaton se, për subjektin Agron Zhukri: a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin, pasi bashkëshortja e subjektit ka përfutuar të ardhura në kundërshtim me nenet 21 dhe 24 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; ç) nuk ka kryer deklarim të rremë.

funkcionale për procesin e rivlerësimit, të kryejë procesin e rivlerësimit kalimtar për dy kriteret e tjera, të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

6. Vendimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit e konsideron produkt të një procesi të zhvilluar në shkëlqe të ligjit procedural dhe, arsyetimin e këtij vendimi, produkt të interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, në injorim të provave të administruara në dosje. Sipas subjektit të rivlerësimit në ankim, vendimi i Komisionit është marrë: (i) në shkëlqe të parimeve të përcaktuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), dhe nenit 42 të Kushtetutës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor; (ii) në vlerësim të gabuar dhe shkëlqe të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016; (iii) në interpretim të gabuar dhe keqdashës, si dhe ometim të provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit. Për të mbështetur pretendimet e ngritura në ankim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe disa akte shkresore për t’u administruar në cilësinë e provës nga trupi gjykues i Kolegjit<sup>2</sup>.
7. Në zbatim të nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrimet me shkrim, të cilat u administruan në Kolegji me nr. 956/19 prot., datë 27.10.2025. Përmes këtyre parashtrimeve, përpos pretendimeve të paraqitura më herët në ankim, referuar nenit 51, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, me qëllim garantimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor.

### III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

#### A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuara

---

<sup>2</sup> (1) Akt ekspertimi, përgatitur nga inxhinieri E. L., datë 08.07.2024; (2) Analiza financiare, datë 09.07.2024, përgatitur nga eksperti kontabël E. S.; (3) Tabela financiare përmbledhëse, përgatitur nga i njëjti ekspert [licencë nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2001]; (4) Kërkesë, datë 03.04.2024, e bashkëshortes së subjektit, drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj; (5) Shkresë “Kthim përgjigje”, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, drejtuar znj. R. Zh.; (6) Kërkesë, datë 25.03.2024, me kërkuar Agron Zhukri (përfaqësuar nga av. A. Zh.), drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; (7) Shkresë “Kthim përgjigje”, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; (8) Ekstrakt historik i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me NUIS {\*\*\*}; (9) Planimetria e sheshit të ndërtimit të objektit. Miratimi i lejes së ndërtimit për objektin 6 deri në 8 kate, me 2 kate parkimi nëntokë, në rrugën “{\*\*\*}”, në pronësi të disa familjeve, në favor të subjektit ndërtues “{\*\*\*}” ShPK; (10) Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 31.05.2005, i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, për leje ndërtimi; (11) Leje ndërtimi – formulari nr. 4, me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.01.2005, i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë; (12) Shkresë “Kthim përgjigje”, nr. {\*\*\*} prot., datë 10.07.2024, e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme; (13) Kërkesë, datë 08.07.2024, e subjektit të rivlerësimit, drejtuar Komisionit, për sqarim dhe interpretim vendimi; (14) Shkresë “Kthim përgjigje”, nr. {\*\*\*} prot., datë 08.07.2024, e Komisionit.

nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit Ë, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Zhukri, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, për shqyrtimin e vendimit nr. 759, datë 19.04.2024, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Agron Zhukri, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, e zhvilluar në datën 06.11.2025.
11. Trupi gjykues i Kolegjit, fillimisht mori në analizë shkaqet procedurale të ankimit, që lidhen me procesin e rregullt ligjor, duke analizuar dhe vlerësuar si vijon:

11.1. Subjekti në ankim ka sjellë në vëmendje kërkesat e përsëritura drejtuar Komisionit, në lidhje me kryerjen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Ai pretendon se, ndonëse Komisioni e ka njoftuar se arsyetimi i vendimit për mospranimin e kësaj kërkesë do të jetë pjesë përbërëse e vendimit përfundimtar, në këtë të fundit nuk gjendet e arsyetuar kjo vendimmarrje. Nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstaton si më poshtë.

11.1.1. Më datë 25.03.2024, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision kërkesën për plotësimin e hetimit, duke e shtrirë vlerësimin për të tria kriteret e rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për efekt të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, hetimi i kryer, sipas subjektit, duhet të jetë i mbështetur në të tria kriteret që Kushtetuta dhe ligji i posaçëm parashikojnë në këtë proces, në të kundërt: (a) krijohet perceptimi se vendimmarrja është e paracaktuar, duke u paragjykuar çështja në disfavor të subjektit. Në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vendimmarrja e Komisionit apo Kolegjit mund të bazohet në një ose disa prej komponentëve, por, për asnjë arsye, nuk mund të pranohet që hetimi të jetë i paplotë/i mangët; (b) cenohet procesi i rregullt ligjor, i parashikuar në nenin Ç, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi nëse procesi i rivlerësimit përmbillet vetëm në bazë të një kriteri, ankimi nuk do të mundësonte realizimin e ndreqjes së kësaj të mete procedurale, në kushtet kur Kolegji nuk mund dhe nuk duhet të hetojë e gjykojë për herë të parë akte, të cilat nuk i janë nënshtruar hetimit dhe gjykimit në shkallë të parë, duke mos pasur juridiksion fillestar. Kolegjit do t'i vendosej në dispozicion një dosje e mangët, që do ta vinte në pamundësi për t'u shprehur

mbi komponentët e tjerë në eventualitetin e pranimit të kërkesës ankimore dhe nxjerrjen e rezultatit pozitiv për komponentin e pasurisë. Në këto kushte, alternativat e mundshme të Kolegjit do të cenonin në mënyrë të pandreqshme procesin e rregullt ligjor, eventualisht: -- në drejtim të vonesave të pajustificuara, -- dy kriteret do t'i nënshtroheshin vetëm një nivel gjykimi, ose -- pamundësimin për të ushtruar të drejtën për t'u mbrojtur në mënyrë efektive dhe shkeljen e parimit të barazisë së armëve.

11.1.2. Me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 26.03.2024, trupi gjykues në Komision vendosi: *mospranimin e kërkesave të subjektit të rivlerësimit, z. Agron Zhukri; -- vendimi i arsyetuar me shkrim në lidhje me kërkesat e tij do të jetë pjesë përbërëse e dosjes dhe e vendimit përfundimtar*<sup>3</sup>. Në lidhje me përfshirjen e dy kriterëve të tjera në procesin e rivlerësimit, është arsyetuar se, sipas standardit të Komisionit dhe qëndrimit të konsoliduar tashmë të Kolegjit, si dhe bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni mund të përfundojë hetimin administrativ bazuar vetëm në një nga kriteret dhe, pas shqyrtimit të parashtrimeve dhe provave shkresore, do të vlerësojë nëse ka vend për riçelje të hetimit edhe për dy kriteret e tjera. Më datë 27.03.2024, nëpërmjet *email*-it, Komisioni i njofton subjektin qëndrimin e tij shkurtimisht, lidhur me kërkesat, duke e informuar mbi refuzimin e tyre, dhe se *vendimi i arsyetuar me shkrim do të jetë pjesë përbërëse e dosjes dhe vendimit përfundimtar*.

11.1.3. Më datë 11.04.2024, së bashku me prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur përsëri në Komision kërkesën me objekt: *“Për plotësimin e hetimit, duke e shtrirë vlerësimin për të tria kriteret e parashikuara në legjislacion”*, me pretendimin se, nga provat e administruara, ka rezultuar e provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, që ai dhe bashkëshortja kanë pasur mjaftueshëm të ardhura nga burime të ligjshme për përfitimin e pasurive dhe përbalimin e shpenzimeve, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, dhe se, për këtë kriter, Komisioni duhet të vlerësojë se subjekti ka arritur nivelin e besueshëm, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

11.1.4. Trupi gjykues i Komisionit u mblodh më datë 15.04.2024 për të diskutuar në lidhje me këtë kërkesë dhe, me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, datë 15.04.2024, vendosi mospranimin e saj. Kjo vendimmarrje është mbështetur në faktin se, sipas analizës financiare në format *Excel*, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, për periudhën 2003 – 2016, totali i viteve me balancë negative është (-) 12.055.828 lekë. Komisioni, në këtë vendim të ndërmjetëm, ka arsyetuar se, sipas praktikës së ndjekur në raste të ngjashme, çështja ka kaluar në seancë dëgjimore dhe, pas dëgjimit të parashtrimeve nga subjekti në seancë, si dhe pas administrimit të çdo prove e dokumenti të ri që ai mund të paraqesë, Komisioni ka vlerësuar nëse duhet të riçelet hetimi administrativ edhe për kriteret e tjera. Përmes *email*-it të së njëjtës datë, Komisioni e njofton subjektin mbi këtë arsyetim dhe vendimmarrje, si dhe për faktin se vendimi i arsyetuar me shkrim do të jetë pjesë përbërëse e vendimit përfundimtar.

---

<sup>3</sup> *Subjekti i rivlerësimit, më datë 26.03.2024, kishte paraqitur edhe kërkesa të tjera procedurale për marrje prove dhe njohjen e identitetit të personit që kishte kryer funksionin e këshilltarit ekonomik në çështjen e tij.*

11.1.5. Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 17.04.2024, pas çeljes së saj dhe konstatimit të pranisë së palëve, kryesuesi i trupit gjykues të Komisionit ka informuar se, nëse do të vlerësohet se të gjitha shpjegimet e dhëna dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në çdo fazë të hetimit, përfshirë edhe gjatë seancës dëgjimore, do të jenë bindëse, atëherë do të vendoset për rihapjen e procesit të rivlerësimit edhe njëherë. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit e parashtroi përsëri këtë kërkesë dhe, Komisioni, me vendimin nr. 6, datë 18.04.2024, vendosi mospranimin e saj. Ashtu si deklaruar gjatë seancës për shpalljen e vendimit më datë 19.04.2024, Komisioni, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, vlerësoi se: “[...] subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, lidhur me kriterin e pasurisë dhe, për pasojë, vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit për riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e figurës dhe profesional”.

Në vendimin objekt shqyrtimi nr. 759, datë 19.04.2024, në paragrafin 101 të tij, thuhet se Komisioni, “[...] përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Agron Zhukri, duke rrëzuar kërkesën e tij për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, për shkak se subjekti nuk përmbysi barrën e provës në lidhje me kriterin pasuror”.

11.1.6. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se arsyet e mospranimit të kërkesës së subjektit janë argumentuar qartazi në vendimmarrjet dhe qëndrimet e Komisionit në këtë çështje. Trupi gjykues vëren se, përcaktimi i nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës<sup>4</sup>, zbërthehet në dispozitat e ligjit të posaçëm nr. 84/2016, përkatësisht në nenin 4, pikat 1 dhe 2, si dhe në nenin 59, pika 1 e këtij ligji. Përfundimi i hetimit administrativ dhe vendimmarrja vetëm për një kriter rivlerësimi, nuk duhen perceptuar si paragjykim i procesit apo paracaktim i vendimit, pasi referuar jurisprudencës së konsoliduar tashmë të Kolegjit, një situatë e tillë procedurale vlerësohet në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi. Në kuptim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që për konfirmimin në detyrë kërkon domosdoshmërisht vlerësimin pozitiv të të 3 (tria) kriterëve së bashku, nuk e ndalon Komisionin të përfundojë procesin e rivlerësimit për një subjekt, në rast se për një apo dy kritere të hetuara/rivlerësuar, ka rezultuar se ai nuk ka arritur një nivel të besueshëm. Sa më sipër, edhe në funksion të efikasitetit të procesit të rivlerësimit për kritere, të cilat, edhe në eventualitetin e arritjes së një niveli kualifikues, nuk e ndryshojnë në tërësi rezultatin mbi procesin e rivlerësimit të subjektit. Mbi këtë arsyetim, trupi gjykues i gjen të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

11.1.7. Nga ana tjetër, për t’iu përgjigjur pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, në eventualitetin e pranimit të ankimit dhe arritjes së një rezultati pozitiv për kriterin e vlerësimit të pasurisë nga Kolegji, ky i fundit nuk do të kishte në dispozicion aktet që i përkasin dy kriterëve të tjera, si dhe nuk mund të hetojë dhe gjykojë për herë të parë akte të cilat nuk i janë nënshtruar hetimit e vlerësimit në Komision, trupi gjykues sjell në vëmendje se, ligjvënësi, në kuadër të garantimit të procesit të rregullt ligjor, nëpërmjet përcaktimeve kushtetuese (neni 179/b, pika 8 e Kushtetutës), është kujdesur të parashikojë edhe institucionet e tjera, që do të vijojnë me procedurat e rivlerësimit deri në përfundimin e këtij procesi për secilin nga subjektet e

---

<sup>4</sup> Neni Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon se “1. Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit”.

rivlerësimit, përfshirë këtu edhe rastet nëse Kolegji do të dispononte me prishjen e vendimit dhe urdhërimin e kryerjes së këtij procesi edhe për kriteret e tjera të rivlerësimit.

11.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se vendimi i Komisionit karakterizohet nga mangësi të theksuara në trajtimin e elementeve arsyetuese për të përligjur vendimmarrjen e tij, duke cenuar procesin e rregullt ligjor në drejtim të shkeljes haptazi të parimit kushtetues të arsytimit të vendimit, dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>5</sup>, duke zbardhur një vendim, në të cilin konstatimet, në pjesën më të madhe të tyre, janë kontradiktore me faktet dhe provat e paraqitura, dhe se konkluzionet e arritura nuk mbështeten në arsyetim. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti përmend kërkesat që i ka drejtuar Komisionit në datat 05.07.2024 dhe 08.07.2024, përkatësisht për vënien në dispozicion të analizës së rishikuar financiare, si dhe për sqarim e interpretim vendimi. Subjekti ka pretenduar se kërkesën procedurale për sqarim dhe interpretim vendimi, bazuar në nenin 314 të Kodit të Procedurës Civile<sup>6</sup>, Komisioni e ka konfunduar me kërkesën për informacion dhe dokumentacion që ai kishte paraqitur në një datë të mëparshme, në shkelje të detyrimit ligjor për krijimin e një fashikulli të ri dhe dërgimin për shqyrtim të kësaj kërkesë procedurale trupit gjykues që ka dhënë vendimin, duke cenuar të drejtën e subjektit për t'u pajisur me një vendim të arsyetuar.

11.2.1. Nga analizimi i këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur më datë 26.06.2024 me vendimin e arsyetuar të Komisionit, nr. 759, datë 19.04.2024, duke e konsideruar atë të paqartë në drejtim të metodologjisë së përdorur në kryerjen e analizës financiare, si dhe në kushtet kur analiza e rishikuar nuk i është bashkëlidhur vendimit, i drejtohet Komisionit me një kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e tij, në kuptim të respektimit të një procesi të rregullt ligjor, që i shërben, ndër të tjera edhe ushtrimit të së drejtës së ankimit nga palët pjesëmarrëse në proces. Me fjalë të tjera, për diferencat e ndryshme negative mes rezultateve të hetimit administrativ dhe vendimit përfundimtar, si dhe citimit në mënyrë të përsëritur në tekstin e vendimit të Komisionit të “analizës së rishikuar financiare”, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Komisionit sqarim për metodologjinë dhe analizën financiare të përdorur për arritjen e përfundimeve të ndryshme. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 08.07.2024, Komisioni e ka informuar se analiza financiare bëhet vetëm një herë, në mbylljen e rezultateve të hetimit administrativ dhe, në varësi të pretendimeve të subjektit që janë marrë në konsideratë, analiza financiare ka ndryshuar, dhe çdo ndryshim është i arsyetuar në vendimin përfundimtar. Sipas Komisionit në këtë komunikim, subjekti në ankim mund të parashtrojë të gjitha pretendimet kundër vendimmarrjes së tij.

11.2.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në rezultatet e hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe mbuluar shpenzimet gjatë periudhës 1993 – 2002, në vlerën (-) 21.218.058 lekë, dhe për periudhën 2003 – 2016, në vlerën (-) 72.217.608 lekë, në total, në

---

<sup>5</sup> Subjekti i rivlerësimit i referohet vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 118, datë 22.09.2015, paragrafët 8, 9, 11, 12, mbi arsyetimin e vendimit gjyqësor.

<sup>6</sup> “Gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët. Kërkesa për sqarimin dhe interpretimin e vendimit mund të paraqitet në çdo kohë, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar. Kundër vendimeve të mësipërme mund të bëhet ankim i veçantë, sipas rregullave të përgjithshme”.

vlerën (-) 93.435.666 lekë. Pasi analizoi prapësimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në vlerën (-) 83.110.519 lekë.

Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni, për çdo ndryshim në zërat e analizës financiare, ka arsyetuar dhe evidentuar në vendim faktin që analiza është rishikuar, duke pranuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit në prapësimet e tij. Për të qenë më konkret në konstatimet e tij, trupi gjykues evidenton si vijon: (1) për periudhën 1993 – 2002, balanca negative ka ndryshuar nga (-) 21.218.058 lekë në (-) 20.361.407 lekë, si rrjedhojë e korrektimeve të disa zërave të analizës, të arsyetuara në vendim<sup>7</sup>; (2) Për periudhën 2003 – 2016, balanca negative, nga (-) 72.217.608 lekë, ka ndryshuar në (-) 62.749.112 lekë. Reduktimi me 9.468.496 lekë konsiston kryesisht në: (i) vlerën e banesës dhe truallit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, nga 7.608.300 lekë (70.000 USD) llogaritur në rezultatet e hetimit administrativ, në vendim është llogaritur sipas kontratave, në vlerën 2.200.000 lekë – paragrafi 45.6 i vendimit objekt shqyrtimi; (ii) ndryshimi i përlllogaritjes së ndërtimit të shtesës për periudhën 2004 – 2006, nga 3.124.825 lekë në 1.407.669 lekë – paragrafët 35.4 dhe 35.6 të vendimit; (iii) në vendim, nuk janë përfshirë në analizë zërat: (a) zbritur shpenzimet e komunikimit me 2.9% dhe (b) shtuar shpenzimet për pagesë telefonike sipas bankës, referuar paragrafit 100 të vendimit objekt shqyrtimi; (iv) shpenzimet e studimeve të djalit, A. Zh., në Hagë, Holandë, për periudhën 2009 – 2011, në rezultatet e hetimit janë konsideruar në shumën 7.819.378 lekë, ndërsa në vendim 4.975.094 lekë – arsyetimi në paragrafin 100.2 të vendimit objekt shqyrtimi.

**11.2.3.** Përpos përkohshmërisë së këtij procesi dhe institucioneve të tij, trupi gjykues nuk konstaton asnjë shkelje nga ana e Komisionit në qasjen e tij procedurale ndaj subjektit të rivlerësimit, në drejtim të cenimit të procesit të rregullt ligjor, sa i përket parimit të arsyetimit të vendimit, dërgimit për shqyrtim të kërkesës procedurale trupit gjykues që ka dhënë vendimin, për sqarim dhe interpretim, sipas përcaktimeve të nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile, apo në drejtim të ushtrimit të së drejtës së ankimit. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar nga trupi gjykues i Kolegjit.

**11.2.4.** Në këtë këndvështrim, trupi gjykues gjen të pabazuar edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit në parashtrimet me shkrim, që për ndreqjen e kësaj të metë procedurale dhe për të mundësuar korigjimin e saj, i kërkohet Kolegjit kalimi i çështjes në seancë gjyqësore publike, duke vlerësuar gjetjet e Komisionit dhe prapësimet e subjektit nga ekspertë financiarë, nën përgjegjësinë e betimit para ligjit. Kolegji e ka trajtuar gjerësisht këtë natyrë pretendimi në jurisprudencën e tij, duke theksuar se ligji i posaçëm i këtij procesi ka parashikuar se pranë Komisionit dhe Kolegjit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë, që ushtrojnë veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës. Ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar në asnjë dispozitë të tij thirrjen e ndonjë eksperti kontabël

---

<sup>7</sup> Përkatësisht -- të ardhurat nga paga e bashkëshortes, nga 577.430 lekë, kanë ndryshuar në 610.884 lekë; -- shpenzimet jetike, nga 2.322.351 lekë, kanë ndryshuar në 1.925.048 lekë, -- vlera e automjetit, nga 2.207.940 lekë, ka ndryshuar në 2.015.168 lekë; -- nuk janë llogaritur shpenzimet e komunikimit/pagesa telefonie. Ndryshime të arsyetuara, respektivisht në paragrafët 35.2.4, 35.2.5, 86 dhe 100 të vendimit objekt shqyrtimi.

për efekt të rivlerësimit. Mënyra e vlerësimit të subjekteve në drejtim të aspektit financiar gjen përgjigje në praktikën e konsoliduar të Komisionit dhe Kolegjit.

11.3. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se disa nga provat e depozituara<sup>8</sup> prej tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, të cilat janë paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe me fuqi të plotë provuese, në mënyrë tërësisht abuzive dhe arbitrare, janë injoruar nga Komisioni, pa asnjë argument apo shpjegim ligjor ose logjik. Ky fakt, sipas subjektit, jo vetëm që përbën shkelje të natyrës procedurale që faktojnë në mënyrë të përsëritur cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, por impaktojnë negativisht në mënyrë të drejtpërdrejtë analizën financiare, duke prodhuar si pasojë komplekse një balancë negative që nuk i përgjigjet gjendjes faktike.

11.3.1. Trupi gjykues do t'i vlerësojë aktet shkresore gjatë shqyrtimit të themelit të kësaj çështjeje, në kuadër të vlerësimit të pasurive dhe të ardhurave objekt analize. Megjithatë, në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues vlerëson të ndalet e të analizojë pretendimin e subjektit lidhur me “shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë”, për të cilin Komisioni, në paragrafin 80.1 të vendimit është shprehur se, pavarësisht se subjekti e ka cituar këtë shkresë, nuk e ka depozituar një provë të tillë pranë Komisionit. Subjekti në ankim ka pretenduar se Komisioni, në mënyrë absurde e mohon paraqitjen e kësaj prove të depozituar prej tij në mbështetje të parashtrimeve në seancë dëgjimore, e cila është përdorur për të rrëzuar konstatimin lidhur me mospagimin e tatimit në burim nga shoqëritë e sigurimit, prej të cilave bashkëshortja ka përfituar të ardhurat nga ndërmjetësimi në sigurime, në vlerën 25.046.446 lekë.

11.3.2. Nga aktet e administruara në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues nuk konstaton të jetë administruar shkresë me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ndërkohë që është paraqitur shkresë me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, e kësaj drejtorie. Pra, që i përket së njëjtës datë, dhe lëshuar nga i njëjti institucion, si dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj). Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 17.04.2024, rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë përmendur shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, të organeve tatimore, pra, jo shkresën e pretenduar, me ekstremitetet përkatëse. Në shkresat e sipërcituara, e para ka të bëjë me informacionin lidhur me pagesën e tatimit për të ardhurat nga qiraja për vitet 1994 – 1996 dhe, e dyta lidhet me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e bashkëshortes si agjente në sigurime, një pjesë të përmbajtjes të së cilës, subjekti i rivlerësimit e citon gjatë kësaj seance. Referuar datës së shkresës, 04.04.2024, prezumohet që ajo të jetë paraqitur me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit më 11.04.2024, por një gjë e tillë nuk rezulton as në listën e akteve të paraqitura për secilën çështje nga subjekti i rivlerësimit, dhe as nuk rezulton të jetë përmendur prej tij gjatë

---

<sup>8</sup> (i) dokumenti bankar “Banca Nazionale di Lavoro (BNL)”, i datës 17.02.1994; (ii) akti i kolaudimit të realizuar nga eksperti i licencuar J. K.; (iii) vendimi nr. {\*\*\*} datë 15.08.1996, i Gjykatës së Rrethit Tiranë; (iv) kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.05.2003, dhe kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.01.2003; (v) deklaratat e z. I. O. në lidhje me pagesat e përfituara për efekt të shitjes së pasurisë “banesë”, në {\*\*\*}, Kavajë, si dhe shkresa e datës 03.04.2024, e noteres M. Ll.; (vi) Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë; (vii) vërtetimet e lëshuara nga shoqëritë e sigurimit.

seancës dëgjimore. Gjatë kësaj seance, nuk rezulton të jenë depozituar prova të reja, dhe subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar faktin që aktet shkresore të përmendura janë të njëjtat me ato të depozituara në kuadër të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, depozituar edhe në formë elektronike me CD, më datë 16.04.2024.

Përpos sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë ta paraqiste këtë shkresë në Kolegj, së bashku me ankimin, ashtu siç ka vepruar edhe për akte të tjera shkresore që ishin tashmë pjesë e fashikullit gjyqësor të Komisionit. Po ashtu, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se, pas njoftimit nga Kolegji për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit, më datë 03.10.2025 ka paraqitur kërkesën për verifikim të akteve të dosjes. Subjektit të rivlerësimit iu mundësua njohja me aktet e dosjes më datë 08.10.2025. Pasi verifikoi aktet, me qëllimin, sipas tij për të ushtruar në mënyrë sa më efektive të drejtat procedurale, subjekti i rivlerësimit, si nëpërmjet komunikimit elektronik me *email*-in e datës 08.10.2025, ashtu edhe me parashtrimet e datës 27.10.2025, depozitoi dy akte, që sipas tij, ishin paraqitur në Komision, por mungonin në fashikujt gjyqësorë, përkatësisht: (i) deklaratë financiare për z. A. Zh., lëshuar nga Universiteti i Hagës, si dhe (ii) vendimi nr. {\*\*\*}, datë 08.02.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pra, subjekti i rivlerësimit nuk parashtrroi që në fashikujt gjyqësorë të Komisionit të mungonte shkresa e pretenduar. Thënë ndryshe, subjekti ka pasur dy herë mundësinë ta sjellë vetë këtë shkresë në Kolegj, si me ankimin, ashtu edhe pas verifikimit të akteve, gjë të cilën nuk e ka bërë. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se citimi i shkresës me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, mund të ketë qenë një lapsus nga Komisioni në vendim.

**11.3.3.** Për sa i përket dy akteve të cituara më sipër, përkatësisht deklaratës financiare për A. Zh., si dhe vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 08.02.2022, në parashtrimet në Kolegj të datës 27.10.2025, subjekti ka pretenduar se mungesa e dokumentacionit që ka ndikuar në vendimmarrje, sipas parashikimit të nenit 467, shkronja “dh” e Kodit të Procedurës Civile<sup>9</sup>, është një shkelje që përbën një nga rastet tipike të parashikuara nga ligji si shkak për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, me qëllim korigjimin e defekteve procedurale, në shërbim të realizimit të procesit të rregull ligjor. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve, konstaton se në dosjen e Komisionit është administruar “shkresë përcjellëse”, me nr. {\*\*\*} prot., datë 16.04.2024, së bashku me provat në format *CD*, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit përfaqësuar me prokurë nga djali, A. Zh.<sup>10</sup>, në të cilat përfshihen edhe dy aktet e sipërcituara. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë dokumentacioni gjendet i pabazuar.

**11.4.** Në ankim, subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e barazisë së armëve në proces, si dhe parimin e kontradiktoritetit, duke mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta në lidhje me vlerën provuese të deklarimeve të personave të tretë, përzgjedhjen e të cilëve e bën përmes një procesi tërësisht arbitrar dhe tendencioz, në funksion të prezumimeve negative në

---

<sup>9</sup> “Gjykata e Apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kufijve të nenit 121, të këtij Kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim : [...] dh) kur mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit [...]”.

<sup>10</sup> Shih fashikullin nr. 23, faqe 148 dhe 149, si dhe paragrafin nr. 15, të vendimit nr. 759, datë 19.04.2024, të Komisionit, objekt shqyrtimi.

ngarkim të tij, duke mos konsideruar me fuqi të mjaftueshme provuese, ato që impaktonin pozitivisht balancën ekonomike. Të njëjtin qëndrim paragjykues dhe standard të dyfishtë vlerësimi, Komisioni përdor edhe në trajtimin e raporteve apo të dhënave nga ILDKPKI-ja, duke marrë të mirëqena dhe në cilësinë e provës deklarimet e subjektit dhe përlllogaritjet e shpenzimeve/standardit të jetesës, kurse raporti pozitiv i të njëjtit institucion lidhur me mungesën e problemeve të justifikimit të pasurive nuk merret në konsideratë, pavarësisht se është në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Aplikimit të standardit të dyfishtë të Komisionit nuk mund t'i shpëtonte as analiza financiare, pasi në metodologjinë e përdorur, nuk merret në asnjë rast në konsideratë balanca pozitive e viteve paraardhëse (*e cila konsiderohet e shpenzuar*), ndërsa balancat negative paraardhëse mbarten në çdo vit dhe në çdo çelje tablele, për efekt të kontestimeve të Komisionit, lidhur me pamundësitë financiare. Dhunimi i standardit i shërben dukshëm një qëndrimi paragjykues negativ, qasje për të cilën subjekti i rivlerësimit kërkon të mbahet parasysh nga Kolegji, në vlerësimin tërësor të vendimit objekt ankimi, pasi përbën një *indicie* shumë serioze të paragjykimit të vendimit dhe të mungesës së paanshmërisë dhe objektivitetit të Komisionit në marrjen e këtij vendimi.

**11.4.1.** Nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues nuk konstaton që në rastin objekt analize të jetë shkelur parimi i barazisë së armëve apo kontradiktoritetit. Nëpërmjet deklaratës së datës 12.03.2024, subjekti i rivlerësimit, i përfaqësuar nga avokat A. Zh.<sup>11</sup>, djali i tij, është njohur me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të hetimit të zhvilluar nga Komisioni, duke deklaruar se nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materiallet e tërhequra, dhe se ky dokumentacion është konform me dokumentacionin e dosjeve që iu vunë në dispozicion në format elektronik (CD). Komisioni, si nëpërmjet pyetësorëve, ashtu edhe me rezultatet e hetimit, i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit konstatimet e tij, duke i lënë hapësirën kohore të nevojshme për t'iu përgjigjur dhe për t'i prapësuar ato. Më konkretisht, pasi ishte njohur me rezultatet e hetimit dhe aktet e administruara nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, më datë 18.03.2024, kërkoi edhe 30 ditë shtesë për dorëzimin e shpjegimeve mbi këto rezultate, Komisioni me vendimin nr. 3, datë 20.03.2024, vendosi të pranojë kërkesën, duke e shtyrë afatin për dorëzimin e dokumentacionit deri në datën 11.04.2024. Ky fakt provohet në vijim edhe nga kohëzgjatja prej rreth 4 (katër) orë e gjysmë e seancës dëgjimore të datës 17.04.2024, në të cilën janë parashtruar rezultatet e hetimit administrativ, prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe përgjigjet e pyetjeve të ngritura gjatë kësaj seance. Sa më sipër, nuk konstatohet shkelje e këtyre parimeve në drejtim të së drejtës së mbrojtjes efektive, në kuptim të procesit të rregullt ligjor.

**11.4.2.** Në përgjigje të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues mban në konsideratë si përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, se *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre*

---

<sup>11</sup> Me prokurorë të posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.03.2024, i përfaqësuari Agron Zhukri emëron avokatin A. Zh. ta përfaqësojë në mungesë për çdo çështje civile. Përfaqësuesi i caktuar ka të drejtë dhe kompetencë të plotë të ndjekë çështjen në rrugë administrative dhe, nëse është e nevojshme, edhe në rrugë gjyqësore në gjykatë administrative, në të gjitha shkallët e saj, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA), duke pasur të drejtën për të ngritur çdo kërkesë të nevojshme në raport me hetimin administrativ që po kryhet pranë këtij organi në lidhje me dosjen administrative të subjektit Agron Zhukri, që ndodhet pranë këtij organi etj.

të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”, ashtu edhe qëndrimin e mbajtur gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me nivelin e provueshmërisë së deklaratave të personave të tretë gjatë procesit të rivlerësimit, duke i analizuar ato në raport me provat e tjera të çështjes. Sa i përket konstatimeve të ILDKPKI-së, ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse. Ndërsa, pretendimin mbi metodologjinë e përdorur në analizën financiare, trupi gjykues e ka analizuar në paragrafin 11.5.3 më poshtë në këtë vendim. Për sa më sipër, pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përdorim të standardit të dyfishtë, qëndrim paragykyes dhe mungesë paanshmërie nga Komisioni, trupi gjykues e gjen të pabazuar.

**11.5.** Subjekti, në vijim ka pretenduar se Komisioni në paragrafin 100.8 të vendimit, nëpërmjet shtrembërimeve të qëllimshme të deklaramit të ekspertit kontabël gjatë seancës dëgjimore, ka synuar të përligjë qëndrimin lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare, duke e trajtuar atë si vetëdeklarim negativ të subjektit të rivlerësimit. Në fakt, deklarimi i ekspertit ka rrëzuar metodologjinë e palogjikë financiare të Komisionit, i cili injoron parimin e progresivitetit kronologjik ekonomik dhe parcelizon në mënyrë selektive periudhat kohore për të nxjerrë deficite ekonomike, pa marrë në konsideratë të ardhurat/kursimet e gjeneruara nga periudhat e mëparshme ekonomike.

**11.5.1.** Trupi gjykues, në analizë të këtij pretendimi, konstaton se Komisioni, ashtu siç është shpjeguar më sipër me rezultatet e hetimit administrativ, i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit analizën financiare, metodologjinë e përdorur për hartimin e saj dhe shpjegimet sipas zërave, duke i kaluar subjektit, në bazë të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, barrën e provës për të provuar të kundërtën.

**11.5.2.** Subjekti i rivlerësimit, së bashku me prapësimet, rezulton të ketë paraqitur dokumentet “Analizë financiare” dhe “Tabelë përmbledhëse financiare”, të përgatitura nga kontabilisti i miratuar E. S.<sup>12</sup> Referuar rezultateve të përlllogaritura nga ky ekspert për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative në vitet 2003, 2006, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, në total (-) 12.055.818 lekë. Në seancën dëgjimore të datës 17.04.2024, relatorja e çështjes ka shtruar pyetjen, si e shpjegon subjekti i rivlerësimit këtë balancë negative. Kësaj pyetjeje rezulton t’i jetë përgjigjur kontabilisti, i cili sqaroi se “*balanca negative, sipas çdo viti, jo progresivja sipas çdo viti, del si pasojë e mospasjes së burimeve të mjaftueshme për të mbuluar këtë balancë negative. [...]*”. Kryesuesi i trupit gjykues të Komisionit, në këto kushte, i është drejtuar më pas subjektit të rivlerësimit, duke i shtruar pyetjen nëse ai i qëndronte analizës financiare në të gjithë detajet, shifra e elemente, dhe subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se i qëndron. Pas seancës së datës 19.04.2024 të shpalljes së vendimit, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka dërguar ndërmjet *email*-it, më datë 29.04.2024,<sup>13</sup> përsëri “analizë financiare” dhe

<sup>12</sup> E. S. i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, me NIPT {\*\*\*}, dhe i pajisur me dëshmi “Kontabël i Miratuar”, me nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2001, nga Ministria e Financave.

<sup>13</sup> Regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2024. Në këtë komunikim, subjekti shprehet: “[...], duke ju kërkuar ndjesë për këtë përsëritje *email*-i, i gjendur nga unë në *outbox*-in e *email*-it, po ju ridërgoj rishtazi

“tabelë përmbledhëse financiare”, të përgatitura nga i njëjti kontabilist, në të cilin janë korrigjuar të gjitha balancat negative ndër vite, konstatuar në aktin e mëparshëm, dhe konvertuar në pozitive.

**11.5.3.** Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi Komisioni, në vendim ka reflektuar pikërisht atë që kontabilisti i miratuar ka deklaruar në seancë dëgjimore, arsye për të cilën subjekti i rivlerësimit ka depozituar një analizë tjetër financiare, duke korrigjuar pikërisht balancat negative të analizës pararendëse. Paraqitja e dy analizave të ndryshme mbi të njëjtat fakte dhe prova nuk e bën objektive këtë analizë, por duket si një përpjekje për të justifikuar diferencat negative të konsiderueshme të gjendjes së tij financiare. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të palogjikë metodologjinë financiare të Komisionit, i cili injoron, sipas tij, parimin e progresivitetit kronologjik ekonomik dhe parcelizon në mënyrë selektive periudhat kohore, si dhe nuk merr në konsideratë të ardhurat/kursimet e gjeneruara nga periudhat e mëparshme ekonomike. Lidhur me këtë pretendim, nisur dhe nga mënyra e përlllogaritjes së kryer nga kontabilisti i miratuar, trupi gjykues konstaton se ata e kryejnë analizën dhe ngrenë pretendime sikur të kishin për objekt veprimtarinë ekonomiko-financiare të një subjekti tregtar, i cili mbart në vitet pasardhëse ushtrimore fitimet/humbjet, ndërkohë që prej vitit 2003, z. Agron Zhukri është një subjekt që mbart detyrimin për deklarim pasurie, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”). Në kuadër të këtij detyrimi ligjor, në zbatim të nenit 4, shkronja “d” e këtij ligji, subjektet deklarues kanë pasur detyrimin e deklarimit, ndër të tjera edhe të gjendjes në *cash* jashtë sistemit bankar. Në kushtet kur në një vit, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive, që në vetvete nënkupton mundësinë e tij për kursim, dhe ky kursim nuk është deklaruar si gjendje *cash* në banesë, do të thotë që shuma *cash* është shpenzuar dhe, për pasojë, nuk ka çfarë të mbartet në vitin/vitet pasardhës.

**11.5.4.** Sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se disa nga pagesat për krijimin e pasurive, shlyerjet e kredisë dhe shpenzimet për shkollimin e djalit në Holandë etj., janë paguar nga llogaria e biznesit të bashkëshortes, dhe jo nga llogaritë individuale të tyre, trupi gjykues vlerëson se elementet e analizës financiare të cilat pasqyrojnë gjendjen e familjes së subjektit të rivlerësimit si njësi ekonomike janë të përcaktuara tashmë në legjislacionin e zbatueshëm, dhe qarkullimi monetar i subjektit tregtar si person fizik apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të konsiderohet një e ardhur e ligjshme e subjektit deklarues, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, si dhe ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

**11.6.** Në vijim të ankimit, subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur afatin ligjor të parashikuar në nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e referuar edhe në dispozitivin e vendimit, duke e arsyetuar atë një muaj e një javë me vonesë. Kjo, sipas tij, përbën shkelje të ligjit, që vjen në kundërshtim me të gjithë kuadrin ligjor të brendshëm dhe atë ndërkombëtar që normon zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke shkaktuar vonesa të paarsyeshme të cilat shoqërohen me pasoja, jo vetëm personale, por edhe financiare për subjektin e rivlerësimit. Në

---

*materialin e analizës financiare dhe tabelës përmbledhëse. Këtë material do jua dërgoj dhe ‘hard copy’ ditën e nesërme në sekretari, në mënyrë që të jetë pjesë e materialit tonë, të depozituar pranë organit tuaj”.*

kushtet kur ka një ngjashmëri në masën 90% të rezultatit paraprak të hetimit dhe vendimit përfundimtar, sipas subjektit, shtohen dyshimet se vonesat në zbardhjen e vendimit nuk kanë të bëjnë me vështirësi që lidhen me çështjen konkrete, duke lënë kështu të paqartë arsyen e vonesës.

**11.6.1.** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se vendimi i Komisionit është shpallur në seancën e datës 19.04.2024, vendimi i arsyetuar i është dërguar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.06.2024, referuar “Lajmërim marrje”, i cili është marrë në dorëzim prej tij më datë 26.06.2024. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, neni 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016 përcakton detyrimin që vendimi me shkrim i Komisionit, në të cilin janë përshkruar dhe arsyetuar në mënyrë të plotë përfundimet dhe qëndrimi i tij, t’i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës në të cilën shpallet vendimi përfundimtar. Ushtrimi efektiv i së drejtës së ankimit nga subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 63, pika 1 e ligjit të sipërcituar, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me njoftimin dhe njohjen e subjektit me vendimin e arsyetuar të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur më datë 26.06.2024 me vendimin e arsyetuar të Komisionit, ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi më datë 10.07.2024, i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 759/1, datë 15.07.2024. Për sa më sipër, ndonëse vendimi nr. 759, datë 19.04.2024, nuk është arsyetuar brenda afatit ligjor, Komisioni ka përmbushur efektivisht detyrimin për njoftimin e subjektit të rivlerësimit me këtë vendim, në zbatim të kërkesave procedurale për njoftimin e tij dhe, për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk është cenuar në të drejtat e tij për ushtrimin e ankimit, duke mos pasur si rrjedhojë shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor.

**11.6.2.** Sa i përket pasojave financiare, subjekti i rivlerësimit referon në parashikimet e nenit F, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 62, pika 1 e ligjit nr. 84/2016<sup>14</sup>, për shkak të pezullimit *ex lege*. Trupi gjykues vëren se pezullimi nga detyra i subjekteve të rivlerësimit sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore, lidhet me periudhën nga ushtrimi i ankimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Kolegji, në këto kushte, pasojat financiare lidhur me periudhën rreth një muaj e një javë, që përfaqëson tejkalimin nga Komisioni të afatit për të dërguar vendimin me shkrim, trupi gjykues nuk i gjen me peshë përcaktuese në vlerësimin e tij në drejtim të cenimit të procesit të rregullt ligjor. Këto pretendime mund të ishin adresuar nga subjekti i rivlerësimit tek organet kompetente, si gjykata pranë së cilës ka ushtruar funksionin.

**11.6.3.** Trupi gjykues i Kolegjit e gjen gjithashtu të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi dyshimet se vonesat në zbardhjen e vendimit nuk kanë të bëjnë me vështirësi të çështjes konkrete, dhe se mbetet e paqartë arsyeja e tyre në kushtet e ngjashmërisë në masën 90% të rezultatit paraprak të hetimit dhe vendimit përfundimtar. Në këtë vendim, Komisioni ka reflektuar jo vetëm rezultatet e hetimit, por edhe qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit lidhur me to, duke bërë një vlerësim të detajuar për secilën pasuri/konstatim të trajtuar. Nga

---

<sup>14</sup> Neni F, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit, subjekti i rivlerësimit paguhet në masën 75 për qind të pagës. Nëse Kolegji pranon ankimin duke shfuqizuar vendimin e Komisionit, pjesa prej 25 për qind e pagës i paguhet subjektit për të gjithë periudhën e ndërprerjes. [...]”; neni 62, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet *ex lege* nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimeve”.

praktika e deritanishme, nuk konstatohet ndonjë vonesë e qëllimshme e Komisionit në arsyetimin e vendimit të tij për subjektin e rivlerësimit Agron Zhukri.

12. Nga analizimi i akteve shkresore të paraqitura me ankimin, trupi gjykues konstaton se:

12.1. Një pjesë e këtyre akteve: (i) *kërkesë, datë 03.04.2024, e znj. R. Zh., drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj*, (ii) *shkresë “Kthim përgjigje”, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj*; (iii) *kërkesë, datë 25.03.2024, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë*; (iv) *shkresë “Kthim përgjigje”, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë*, janë depozituar në Komision nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të prapësimeve mbi barrën e provës, dhe nuk gëzojnë cilësinë e provave të reja që meritojnë të analizohen mbi pranueshmërinë, sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

12.2. Akt ekspertimi, përgatitur nga inxhinieri E. L., datë 08.07.2024, lidhur me dimensionet teknike të ndërtesës së ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me konkluzionin se *“Njolla (baza) ndërtimore, e cila sot, aktualisht është me sipërfaqe 81.4 m<sup>2</sup>, nuk ka zgjerim (shtesa anësore) nga viti 1993 – 1994 e në vijim”,* në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duket i panevojshëm, në kushtet kur në fashikullin e Komisionit janë të administruara edhe akte ekspertimi të kryera më afër kohës së ndërtimit të kësaj banese.

12.3. Aktet shkresore si: (i) *analiza financiare, datë 09.07.2024, dhe tabela financiare përmbledhëse, përgatitur nga eksperti E. S.*; (ii) *kërkesë, datë 08.07.2024, e subjektit të rivlerësimit, drejtuar trupit gjykues të Komisionit*; (iii) *shkresë “Kthim përgjigje” nr. {\*\*\*} prot., datë 08.07.2024, e Komisionit*, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duket se janë tërësisht të panevojshme, në kushtet kur analiza financiare e kryer nga Komisioni është objekt kontrolli në Kolegj, dhe pretendimet lidhur me elemente të saj gjejnë përgjigje gjatë analizimit të shkaqeve ankimore, si procedurale, ashtu edhe ato të themelit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

12.4. Lidhur me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.07.2024, të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas së cilës, në zbatim të vendimit nr. 181, datë 12.12.1979 të Këshillit të Ministrave *“Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës Socialiste të Shqipërisë në shtetet e huaja dhe për shpenzimet e udhëtimit e të dietës për personat që dalin jashtë shtetit”,* - - vendimit nr. 473, datë 29.09.1993, të Këshillit të Ministrave, *“Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja dhe për shpenzimet e udhëtimit e të dietës për personat që dalin jashtë shtetit”,* -- shkresës së Ministrisë së Financave nr. {\*\*\*} prot., datë 08.11.1993 *“Për dietat jashtë vendit”,* sipas së cilës, *përcaktohet se punonjësit e kategorisë së III-të, (ku përfshihen punonjësit e ministrive, institucioneve, ndërmarrjeve, përfaqësive etj., si dhe teknikët dhe specialistët që dërgohen jashtë me shpenzimet e shtetit), përfitojnë dietë 35 dollarë dita ose shpenzime të vogla 12 dollarë dita,* trupi gjykues vlerëson se nuk plotëson kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi se, pa fajin e tij, nuk ka mundur ta paraqesë këtë shkresë në Komision. Pavarësisht këtij arsyetimi, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit

në jurisprudencën<sup>15</sup> e tij lidhur me dietat, duke i konsideruar ato vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen në analizë si të ardhura.

**12.5.** Aktet si: (i) ekstrakt historik i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; (ii) planimetria e sheshit të ndërtimit të objektit. Miratimi i lejes së ndërtimit për objektin 6 deri në 8 kate, me 2 kate parkimi nëntokë, në rrugën “{\*\*\*}”, në favor të subjektit ndërtues “{\*\*\*}” ShPK; (iii) vendimi nr. {\*\*\*}, datë 31.05.2005 i KRrT-së, Bashkia Tiranë, për leje ndërtimi në pronën e këtyre familjeve dhe në favor të subjektit ndërtues “{\*\*\*}” ShPK, dhe (iv) leje ndërtimi – formulari nr. 4, me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.01.2005, i KRrT-së, Bashkia Tiranë, nëpërmjet të cilave subjekti i rivlerësimit do të justifikojë ligjshmërinë e shumës 30.000 euro që do të trajtohet në nënparagrafët e paragrafit 43 në këtë vendim, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, konsiderohen të panevojshme dhe pa ndikim ligjor në vendimmarrjen e Kolegjit.

13. Për sa më sipër arsyetuar, në analizë të pretendimeve të subjektit, Kolegji e gjeti të pambështetur në fakte e në parashikimet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, kërkesën për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji nuk ndodhet përpara situatës së parashikuar nga neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, që do të legjitimonin mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjonte ndonjë gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit. Në konkluzion të këtij arsyetimi, trupi gjykues vendosi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

## **B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

*B/1. Për pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe 101.45 m<sup>2</sup> dhe “ndërtesë me tri kate”, me sipërfaqe totale 269.4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë.*

14. Komisioni ka arritur në përfundimet se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me balancë negative prej (-) 2.328.365 lekësh për ndërtimin e banesës në vitin 1996, me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 19.159.126 lekë për investimin e vlerës 1.407.669 lekë për kthimin e papafingos në kat të plotë me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, për periudhën 2005 – 14.08.2006, dhe se likuiditetet e përdorura në vitin 2004 nuk kanë burime të ligjshme për shkak të balancës negative për periudhën deri në vitin 2003, prej (-) 26.159.397 lekësh.
15. Nga analizimi i ankimit, trupi gjykues konstaton se nëpërmjet shkaqeve të ngritura në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton periudhën e ndërtimit të shtesës 125 m<sup>2</sup> në banesën e ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, dhe konkluzionin e Komisionit lidhur me mospërfshirjen si burim të krijimit të kësaj pasurie, të të ardhurave nga shitja e truallit 450 m<sup>2</sup>, i ndodhur në “{\*\*\*}”, Tiranë, si dhe të të ardhurave nga puna e subjektit të rivlerësimit e të bashkëshortes në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Itali.
16. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me periudhën e ndërtimit të shtesës 125 m<sup>2</sup>, me pretendimet se: (i) Komisioni e konsideron si “shtim” në

<sup>15</sup> Shih ndër të tjera, vendimin nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 36, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

sipërfaqe atë që në fakt është rikonstruksioni i katit nën çati, i përfunduar që në vitin 1996 dhe, në kushtet kur deklarimi për herë të parë i pasurisë është bërë pas përfundimit të rikonstruksionit të banesës, nuk ka pasur më një “shtim” që duhej të deklarohet; (ii) Komisioni, në mënyrë të padrejtë ka nxjerrë përfundime në bazë prezumimesh, kur e konsideron investimin në ndërtimin e shtesës në periudhën 2004 deri më datë 14.08.2006, në të cilën është plotësuar dhe dorëzuar vetëdeklarimi për efekt të legalizimit të rikonstruksionit; (iii) pajisja me leje legalizimi në vitin 2011 është një titull fitimi pronësie që ligjëron/formalizon një situatë faktike ekzistuese prej vitesh, të deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, 2003, (në vijim “deklarata e pasurisë 2003”) dhe nuk klasifikohet mosdeklarim. Për pasojë, është i pabazuar edhe qëndrimi i Komisionit mbi vlerën e investimit për përfundimin e objektit gjatë periudhës 2003 – 2011.

17. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

17.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur (bashkëshortja) deklaroi: “Shtëpi banimi e ndërtuar në vitet 1963 – 1965 dhe e rikonstruktuar në vitin 1996, maj e në vazhdim, vlera monetare e shpenzuar për këto punime është e përafërt, pasi është bazuar në shënime të mbajtura nga unë. Për këtë rikonstruksion, nuk disponojmë leje ndërtimi të veçantë dhe preventiv të aprovuar, pasi punimet kryheshin në kuadrin ekzistues, sigurisht duke bërë përmirësime. Vlera e shpenzimeve 2.800.000 lekë. Burimi i financimit, shitja e truallit në {\*\*\*}, 450 m<sup>2</sup> . [...] Vlera e shitjes 2.600.000 lekë, e kryer në vitin 1995, [...]. Pjesa e mbetur e financimit nga të ardhurat e familjes ndër vite, të cilat do të paraqiten në seksionin e të ardhurave. Origjina e pronës është akt dhurimi i dyfishtë, dhurim bashkëshortit tim Agron Zhukri nga familjarët e tij më 23.03.1995 dhe, më pas, dhurim R. nga Agroni, më 27.01.1996. [...] Pjesa takuese 100%”.

17.2. Në deklaratën e pasurisë 2003, subjekti ka deklaruar: “Shtëpi banimi, ndërtuar përpara vitit 1990, rikonstruktuar pas vitit 1990, në vlerën 3 milionë lekë, me pjesë takuese 50%, sipas ligjit, me adresë rr. ‘{\*\*\*}’, nr. {\*\*\*}, Tiranë, nr. pasurie {\*\*\*}, përfutur me kontratë dhurimi nga të gjithë pjesëtarët e trungut familjar, 1995. Shfrytëzim vetjak”.

17.3. Aktet e administruara paraqesin këtë situatë faktike lidhur me origjinën dhe ecurinë e zhvillimit të kësaj pasurie:

17.3.1. Me kontratë shitblerjeje shtëpie të datës 12.04.1965, babai i subjektit të rivlerësimit, H. Zh., ka blerë dy shtëpi: (i) një shtëpi e përbërë nga dy dhoma e një korridor, me konstruksion tulle, portë më vete, me nr. {\*\*\*}, (ii) një shtëpi tjetër qerpiçi në gjendje të pabanueshme (jashtë përdorimit), e cila përbëhet nga dy dhoma e një sallon përdhes dhe një dhomë *nalt*<sup>16</sup>, portë më vete, nr. {\*\*\*}, të ndodhura në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 185.000 lekë.

17.3.2. Me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë nr. {\*\*\*}, datë 05.07.1994, janë përcaktuar 8 (tetë) trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit H. Zh.: bashkëshortja A. Zh., dhe fëmijët Xh.

<sup>16</sup> “Nalt”- formë dialektore (gegërisht), me kuptim “lart” në shqipen letrare.

Zh., E. Zh., B. Zh., S. Zh., D. Zh., F. Zh. dhe Agron Zhukri.<sup>17</sup> Më datë 05.08.1994, nënshkruhet kontratë dhurimi, me palë dhuruese A., Xh., E., B., S. e D. Zh., dhe palë pranuese e dhurimit F. dhe Agron Zhukri. F. Zh. bëhet pronare e banesës me nr. {\*\*\*}, me konstruksion tulle, ndërsa Agron Zhukri i dhurohet banesa nr. {\*\*\*}, me konstruksion qerpiçi, 1/2 e oborrit dhe oborri mbrapa.

17.3.3. Me kontratë dhurimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.02.1996, Agron Zhukri, banesën nr. {\*\*\*} ia dhuron bashkëshortes R. Zh., regjistruar në hipoteke me nr. {\*\*\*}, datë 27.02.1996.

17.3.4. Me vendimin nr. {\*\*\*} të datës 23.03.1996, Këshilli i Rregullimit të Territorit (në vijim “KRrT”) i Bashkisë Tiranë vendosi miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit “Për rikonstruksion dhe shtesë kati në rr. ‘{\*\*\*}’”, për znj. R. Zh. Vendimi është dhënë për sheshin e ndërtimit me sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>, për projektin me numrin e kateve mbi tokë 2 (dy), si dhe çati të shfrytëzueshme<sup>18</sup>.

17.3.5. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.08.1996, që i përket çështjes civile me palë paditëse R. Zh., palë e paditur Bashkia Tiranë, me objekt “Njohje pronësie mbi një shtëpi banimi”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur, *pranimin e kërkesëpadisë për njohjen e pronësisë mbi një shtëpi banimi dykatëshe, në pronësi të paditëses R. Zh., e ndodhur në rr. ‘{\*\*\*}’, nr. {\*\*\*}, e cila përbëhet nga dy kate dhe një papafingo nën çati. Kati i parë përbëhet nga një dhomë (studio), një holl, një kuzhinë, si dhe një banjë. Kati i dytë përbëhet nga tre dhoma, një holl, dy banja, si dhe një ballkon llozhë, ndërsa mbi tavanin e katit të dytë nën çati, ndodhen dy dhoma dhe dy anekse. Shtëpia është ndërtuar me themele butobetoni, me konstruksion mur tulle, si dhe mbuluar me çati të tjegullt, me sipërfaqe 80 m<sup>2</sup>. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 31.08.1996.*

17.3.6. Sipas “Aktit të kolaudimit tekniko ekonomik”<sup>19</sup>, me objekt “Rikonstruksion banesë dhe shtesë kati me çati të shfrytëzueshme” shtator 2000, punimet kanë nisur në datën 17.03.1996 dhe kanë përfunduar në shtator 1996. Vlera faktike e punimeve llogaritet 25.000 USD. Në këtë akt kolaudimi janë përcaktuar sipërfaqet takuese: kati përdhe 85 m<sup>2</sup>, kati i parë 97.4 m<sup>2</sup> dhe papafingo, 85.4 m<sup>2</sup>.

17.3.7. Në aktin “Vërtetim pronësie”, datë 04.08.1999, të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme<sup>20</sup>, thuhet se: “Në regjistrin hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 23.09.1996, në pronësi të R. Zh. [...] figuron e regjistruar [...] një shtëpi banimi, e ndodhur në rrugën ‘{\*\*\*}’, nr. {\*\*\*}, e përbërë nga dy kate dhe një papafingo nën çati. Kati i parë përbëhet nga një dhomë

---

<sup>17</sup> Në një pjesë të akteve të dosjes, kryesisht deri në vitin 1994, mbiemri i familjes së subjektit referohet si “Zhugri”. Në këtë vendim, për efekt unifikimi, aktet referohen të gjitha me mbiemrin “Zhukri”.

<sup>18</sup> Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.10.1996, ka vendosur, ndër të tjera, lejimin e servitutit të kalimit të të paditurës kundërpaditëse, R. Zh., nëpër pronën e paditësve të kundërpaditur Z. P., si dhe detyrimin e së paditurës kundërpaditëse, R. Zh., të shpërblejë paditësit e kundërpaditur në lidhje me servitutin e kalimit, në vlerë 54.000 lekë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

<sup>19</sup> Përgatitur nga kolaudatore S. M., me licencë nr. {\*\*\*}. Përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.05.2023, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “ASHK”), Drejtoria Vendore Tiranë Jug.

<sup>20</sup> Pjesë e akteve bashkëlidhur shkresës së ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.07.2021.

*(studio), një holl, një kuzhinë dhe një banjë. Kati i dytë përbëhet nga tri dhoma, një holl, dy banja, si dhe një ballkon llozhë, ndërsa mbi tavanin e katit të dytë nën çati, ndodhen dy dhoma dhe dy anekse, me dalje kryesore nga lindja”.*

17.3.8. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.05.2001, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP”) Tirana 1 ka vendosur regjistrimin e pasurisë nr. {\*\*\*} në emër të R. Zh., e ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, me sipërfaqe truall 85 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 85 m<sup>2</sup>.

17.3.9. Me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.07.2001, R. Zh. ka blerë nga F. Th. një sipërfaqe truall prej 10 m<sup>2</sup> në shumën 150.000 lekë. Kjo sipërfaqe truall prej 10 m<sup>2</sup> u regjistrua në pronësi të znj. R. Zh. si pasuria nr. {\*\*\*}. Me kërkesën e datës 29.04.2003, R. K. (Zh.) i ka kërkuar ZVRPP-së Tirana 1 rifreskimin e vërtetimit të pronësisë së pronës së saj dhe bashkimin e pasurisë për sipërfaqen 10 m<sup>2</sup>.

17.3.10. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 19.04.2005, në pronësi të znj. R. K. Zh. rezulton pasuria “truall” me sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>, dhe “ndërtesë” 68 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie {\*\*\*}, zona kadastrale {\*\*\*}. Nga kartela e pasurisë, në rubrikën “Përshkrim i veçantë” rezulton se *shtëpia ka dy dhoma, sallon dhe dhomë sipër*.

17.3.11. Këtë objekt, bashkëshortja e subjektit ia ka nënshtruar procedurave të legalizimit nëpërmjet vetëdeklarimeve “Për legalizimin e shtesës”, të datave 11.08.2006 dhe 14.08.2006, shtesë trekatëshe në banesën ekzistuese, ndërtuar para vitit 1990.

17.3.12. Nga procesverbali i konstatimit të ALUIZNI-t,<sup>21</sup> i datës 25.01.2011, shtesa e përgjithshme e ndërtimit është 125.2 m<sup>2</sup>, sipas kateve, 13.4 m<sup>2</sup>, 17.8 dhe 94 m<sup>2</sup> dhe, sipas aktit të kualifikimit nr. {\*\*\*}, datë 27.07.2011, objekti është trekatësh. Sipas planimetrive, sipërfaqja totale ekzistuese dhe shtesa është 269.4 m<sup>2</sup>.

17.3.13. Me kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.07.2011, R. Zh. ka blerë nga ALUIZNI parcelën ndërtimore me sipërfaqe 6.85 m<sup>2</sup> në vlerën 14.700 lekë, sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 04.05.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”, si dhe ka paguar taksë ndikimi në infrastrukturë, në shumën 17.737 lekë.

17.3.14. Në përfundim të procedurave të legalizimit është lëshuar dokumenti “leje legalizimi” nr. {\*\*\*}, datë 15.08.2011, për objektin “Shtesë anësore 3 kate dhe shtesë kati mbi objektin ekzistues 2 kate”. Të dhënat e objektit pasqyrohen si vijon: (i) sipërfaqja e parcelës ndërtimore 101.85 m<sup>2</sup>, (ii) sipërfaqja e ndërtimit 68 m<sup>2</sup> + 13.4 m<sup>2</sup> = 81.4 m<sup>2</sup>, (iii) sipërfaqe totale e ndërtimit për banim, shtesë 125.2 m<sup>2</sup>, numri i kateve mbi tokë, 2 (dy) + 1 (një).

17.4. Pjesë e dosjes së legalizimit të vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.06.2021, është edhe dokumenti aktekspertizë “Relacion teknik konstruktiv”, në lidhje me zbatimin e objektit “Kthim ambientesh nën çati në të

---

<sup>21</sup> ALUIZNI, akronim për “Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtime Informale”.

shfrytëzueshme – papafingo (shitesë kati)”, përgatitur nga inxhinieri i licencuar J. K.<sup>22</sup>. Referuar këtij akti, në zërin “Përshkrimi konstruktiv i objektit” citohet: “Objekti - shitesë kati është realizuar e ndërtuar në vitin 1996, vit në të cilin është realizuar edhe rikonstruksioni i godinës ekzistuese. [...], ky kat është kthim i ambienteve të nënçatisë në ambiente të shfrytëzueshme (papafingo). Konstruksioni bazë i dy kateve ekzistuese është me themele të vazhduara, e mure mbajtëse, të cilat vazhdojnë dhe në ambientet e nënçatisë. [...]. Vihet re se nuk ka ndërhyrje a cenim të konstruksionit bazë të godinës. [...]. Vila numër {\*\*\*}, rruga ‘{\*\*\*}’, 2 kate ekzistuese + shitesa e katit (papafingo) punon si një objekt i tërë që nga viti 1996”.

17.5. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 28.01.2012, rezulton e regjistruar në pronësi të znj. R. Zh. pasuria “truall” me sipërfaqe 101.85 m<sup>2</sup>, nga kjo, “ndërtesë” me sipërfaqe 81.4 m<sup>2</sup>, nr. pasurie {\*\*\*}, z. k. {\*\*\*}, rr. “{\*\*\*}”, Tiranë. Në kartelën e pasurisë evidentohet shënimi: *Leje legalizimi {\*\*\*}, dt. 15.08.2011, shitesë anësore 3 kate dhe shitesë mbi objektin ekzistues 2 kate, sip. trualli 101.85 m<sup>2</sup>, sip. ndërtese 81.4 m<sup>2</sup>*. Konfirmuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresat drejtuar Komisionit<sup>23</sup>.

17.6. Në deklaratat periodike vjetore 2011 dhe 2012, ashtu siç konstaton edhe Komisioni, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur të kenë deklaruar lejen e legalizimit dhe regjistrimin e pronës sipas situatës ndërtimore faktike.

17.7. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkon subjektit të rivlerësimit sqarime mbi faktin se si ka evoluar sipërfaqja e kësaj pasurie, duke saktësuar periudhat e rikonstruksionit të saj deri në gjendjen aktuale, të shoqëruara me fotografi, llojin e ndërtimit apo rikonstruksionit, kostot përkatëse provuar me dokumentacionin financiar e ligjor respektiv, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e rikonstruksionit, sipas periudhave. Në përgjigjet e tij, subjekti ka sqaruar se rikonstruksioni i kësaj pasurie është përfunduar në verën e vitit 1997, duke u kthyer banesa në gjendje të banueshme dhe të mirorganizuar, duke shpjeguar se kati i parë është ambienti i ndenjes, kati i dytë ambienti i fjetjes e studimit për fëmijët dhe, për pjesën nën çati u mundësua aksesimi me shkallë të brendshme, por nuk ishte e banueshme. Nga viti 1997 deri në vitin 2011, janë kryer punime vit pas viti për ta sjellë në gjendje të banueshme, dhe shpenzimet vjetore nuk e kanë kaluar vlerën 300.000 lekë në vit, prandaj nuk janë pasqyruar në shpenzime në deklaratimet periodike vjetore. Në lidhje me sipërfaqen e ndërtimit, subjekti ka sqaruar se ekspertët e ALUIZNI-t kanë saktësuar me matje se nga 68 m<sup>2</sup>, ajo bëhet 81.4 m<sup>2</sup> (68 m<sup>2</sup> + 13.4 m<sup>2</sup>). Sipas tij, shtimi i sipërfaqes së ndërtimit pas rikonstruksionit ka ardhur si rezultat i shembjes së mureve të qerpiçit me një trashësi prej 80 cm dhe kalimi në mure tulle 25 cm. Në lidhje me kostot, subjekti i rivlerësimit sqaroi se në deklarin e parë të vitit 2003, ka deklaruar vullnetarisht rikonstruksionin e banesës me një kosto rreth 2.600.000 lekë. Punimet janë kryer me një brigadë punëtorësh dhe pagesat janë bërë në *cash*, në vlera të vogla, sipas situacioneve të punës që kryenin, si muraturë / suvatim / shtrim pllakash etj., duke sjellë në vëmendjen e Komisionit se, deri në vitin e trazuar 1997, kostot financiare të ndërtimit dhe të materialeve të ndërtimit e hidrosanitareve kanë pasur nivele shumë të ulëta<sup>24</sup>.

<sup>22</sup> Me licencë nr. {\*\*\*}.

<sup>23</sup> Me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 07.07.2021 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 26.05.2023.

<sup>24</sup> Shih paragrafin 27.3.2 të vendimit nr. 759, datë 19.04.2024, të Komisionit.

17.8. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni evidenton se, në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit nuk jep vlera konkrete të shpenzimeve të kryera për përfundimin e ndërtimit të kësaj pasurie. Subjekti shprehet se ka deklaruar vullnetarisht kosto rikonstruksioni prej 2.600.000 lekësh në deklaratën e pasurisë 2003, por, nga verifikimi i kësaj deklarate, vlera e pasurisë figuron e deklaruar 3.000.000 lekë. Gjithashtu, nuk është dhënë informacion se sa ka qenë vlera e investimit për përfundimin e objektit gjatë periudhës 2003 – 2011.

17.9. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se:

17.9.1. Mbi këtë pronë janë kryer investime vetëm në vitin 1996, punime për rikonstruksion dhe përshtatje për banim të katit nën çati, sipas lejes përkatëse nga organet e qeverisjes vendore, dhe sipas vetëdeklarimit për legalizimin e objektit informal. Ashtu siç provohet në aktkolaudimin e hartuar në shtator të vitit 2000, punimet e kryera për rikonstruksionin / shtesën e katit kanë filluar në pranverën e vitit 1996 dhe kanë përfunduar në shtator 1996. Vlera e punimeve ka qenë 25.000 dollarë. Për këtë pasuri janë shpenzuar 150.000 lekë për blerjen e truallit me sipërfaqe 10 m<sup>2</sup> nga F. Th. Në përfundim të procedurave të legalizimit, është nënshkruar kontrata për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore, është paguar shuma 14.700 lekë sipas formularit të pagesës së parcelës ndërtimore, si dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë, në vlerën 19.737 lekë. Për këtë arsye, sipas subjektit, vlera e kësaj pasurie është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në total në vlerën e përafërt prej 2.800.000 lekësh, duke përfshirë kostot e mësipërme që janë paguar ndër vite për krijimin e saj.

17.10. Komisioni, duke marrë parasysh faktin se, në deklaratën periodike vjetore 2004, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar ndryshime në pasurinë e deklaruar si të rikonstruktuar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, dhe duke marrë për bazë vetëdeklarimet për legalizim, në rezultatet e hetimit administrativ e konsideroi shtesën 125.2 m<sup>2</sup> të ndërtuar në periudhën 2004 – gusht 2006, nga 42 m<sup>2</sup>/vit. Për të përcaktuar vlerën e shtesës objekt verifikimi, për efekt të analizës financiare, Komisioni u bazua në kostot e ndërtimit, sipas të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”) për vitet 2004, 2005 dhe 2006, në vlerën totale 3.124.825 lekë, të shpërndarë ndër vite përpjesëtimisht.

17.10.1. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij e konsideron të paqartë marrjen e të dhënave në këtë analizë, në kushtet kur është deklaruar në mënyrë të përsëritur ndër vite, por edhe gjatë përgjigjeve të pyetësorëve që realizimi i punimeve të ndërtimit ka përfunduar në vitin 1996, dhe që në atë kohë nuk ka pasur më ndryshime teknike/strukurore në këtë pasuri. Ky fakt rezulton nga akti i kolaudimit, akti i ekspertimit, deklarata e pasurisë 2003, deklarata e pasurisë *vetting*, si dhe formulari për vetëdeklarimin e objektit informal, i depozituar konform parashikimeve të ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Si një tjetër provë në këtë drejtim, subjekti i rivlerësimit përmend edhe vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.08.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

17.10.2. Subjekti i rivlerësimit ka konsideruar gjithashtu të padrejtë konstatimin e Komisionit se, nga subjekti dhe bashkëshortja, nuk është deklaruar shtesa me sipërfaqe 125 m<sup>2</sup>, ndërkohë që ndërtimi është realizuar në vitin 1996, është vetëdeklaruar në vitin 2006 pranë ish-ALUIZNI-t, është legalizuar në vitin 2011 dhe është regjistruar në regjistrat e pasurisë së paluajtshme në

vitin 2012. Kjo pasuri është deklaruar në sipërfaqe të saktë, sipas objektit ekzistues dhe punimeve shtesë që në vitin 1996, vit në të cilin punimet ishin përfunduar. Leja e legalizimit, sipas subjektit, është një titull fitimi pronësie që vetëm ligjëron një situatë faktike ekzistuese prej vitesh tashmë, të deklaruar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003. Për sa kohë kjo pasuri është deklaruar në vlerë dhe sipërfaqe në kohën kur është përfutur, ai dhe personi i lidhur nuk vendosen në kushtet e mosdeklarimit.

**17.10.3.** Pas prapësimeve të subjektit, Komisioni, në pamundësi për të përcaktuar saktë vlerën e investimit dhe duke marrë për bazë faktin që kati papafingo nuk ishte një ndërtim i ri, vendosi të përlllogarisë koston për sipërfaqen 94 m<sup>2</sup> në masën 60% të vlerës së çmimeve të referencës së EKB-së për periudhën 2004 – gusht 2006, në vlerën 1.407.669 lekë.

**17.11.** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në deklaratën e pasurisë 2003, ndryshe nga pasuria “ambient zyre 50 m<sup>2</sup>”, për pasurinë objekt shqyrtimi në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar sipërfaqen e truallit dhe sipërfaqen totale të banesës, gjë që do të evitonte paqartësitë lidhur me ndryshimin e tyre në vitet 2006, 2011 dhe 2012. Ndonëse subjekti pretendon se nuk ka ndryshuar sipërfaqja pas vitit 1996, apo pas deklarimit të vitit 2003, ka rezultuar e provuar se personi i lidhur ka shtuar sipërfaqen e truallit me 6.85 m<sup>2</sup> në vitin 2011, si rezultat i procesit të legalizimit, shtesë të cilën nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike të këtij viti. Në vlerësim të trupit gjykues, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të arsyetojë faktin se përse bashkëshortja, një rikonstruksion banese, dhe shtesë e ndërtuar me leje ndërtimi lëshuar nga KRRt-ja e Bashkisë Tiranë në vitin 1996, ia nënshtroi procedurave të legalizimit në vitin 2006, si një ndërtim informal. Po kështu, subjekti i rivlerësimit duhet të argumentonte se për cilat arsye vendimi gjyqësor i sipërpërmendur për njohje pronësie, i vitit 1996, nuk prodhoi efekte me pasojë regjistrimin në ZVRPP, sipas gjendjes faktike të pronës, në kushtet kur në vërtetimin e pronësisë të datës 19.04.2005, pasuria përshkruhet: “truall me sipërfaqe 95 m<sup>2</sup>” dhe “ndërtesë 68 m<sup>2</sup>” - “shtëpia ka dy dhoma, sallon dhe dhomë sipër”. Pra, në këtë dokument nuk janë pranuar shtesat e bëra në vitin 1996, dhe ky përshkrim korrespondon me atë të vitit 1994, kur prona fillestare kaloi në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk duhet të mjaftohej vetëm me sqarimin se pasaktësitë në dokumentet pronësore vijnë për shkak të gabimeve eventuale të autoriteteve shtetërore që i lëshojnë, por, në vlerësim të trupit gjykues, duhet të kishte sqaruar saktësisht situatën teknike dhe ligjore të kësaj pasurie.

**17.12.** Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se nuk provohet që pas vitit 1996, në ndërtesën në rrugën “{\*\*\*}”, objekt shqyrtimi, të jenë bërë ndryshime në dimensione teknike, infrastrukturore, shtesa anësore apo shtesë kati. Janë dy akte ekspertimi e kolaudimi, të administruara dhe të vëna në dispozicion të Komisionit nga ZVRPP/AShK, të cilat, në vlerësim të trupit gjykues, tregojnë që kjo pasuri nuk ka pësuar ndryshime në vëllim, sa i përket sipërfaqes dhe kateve, përkatësisht: (i) *akti i kolaudimit tekniko-ekonomik* i shtatorit të vitit 2000, me objekt “Për rikonstruksion dhe shtesë kati me çati të shfrytëzueshme”, sipas të cilit, punimet kanë nisur më datë 17.03.1996 dhe kanë përfunduar në shtator 1996, dhe se vlera faktike e punimeve llogaritet 25.000 USD. Në këtë akt kolaudimi janë përcaktuar sipërfaqet e secilit kat: *kati përdhe* 85 m<sup>2</sup>, *kati i parë* 97.4 m<sup>2</sup>, *papafingo* 85.4 m<sup>2</sup>, të cilat janë të përafërta me sipërfaqet pas procesit të legalizimit; (ii) *aktekspertizë* “Relacion teknik konstruktiv” në lidhje me zbatimin e objektit “Kthim ambientesh nën çati në të shfrytëzueshme – papafingo

(shitesë kati)”, përgatitur nga inxhinier J. K., në kuadër të procesit të legalizimit, sipas së cilit, “objekti – shitesë kati është realizuar e ndërtuar në vitin 1996, vit në të cilin është realizuar dhe rikonstruksioni i godinës ekzistuese [...] Vila numër {\*\*\*}, rruga ‘{\*\*\*}’, 2 kate ekzistuese + shitesa e katit (papafingo) punon si një objekt i tërë që nga viti 1996”. Po kështu, vendimi nr. {\*\*\*}, datë 15.08.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Njohje pronësie mbi një shtëpi banimi”, në të cilin gjykata ka vendosur, *pranimin e kërkesëpadisë për njohjen e pronësisë mbi një shtëpi banimi dykatëshe në pronësi të paditëses R. Zh., e ndodhur në rr. ‘{\*\*\*}’, nr. {\*\*\*}, e cila përbëhet nga dy kate dhe një papafingo nën çati. [...]*, ndonëse nuk rezulton të ketë shërbyer për fitimin e pronësisë, sipas përshkrimit, përsëri paraqet situatën faktike të pasurisë objekt analize në vitin 1996. Për këto arsye, ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se objekti është ndërtuar në vitin 1996, dhe nuk është kryer shitesë anësore apo kati në vitet 2004 – 2006 dhe, për pasojë, për këtë periudhë nuk janë përlogaritur kosto ndërtimi.

*Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie*

18. Sa i përket burimit nga shitja e pasurisë “truall” me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.600.000 lekë, Komisioni konstatoi se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting* ka bërë deklaram të pasaktë, si për sa i takon faktit të shitjes, ashtu edhe vlerës së saj, pasi pasuria e llojit “truall” me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup> nuk është shitur nga subjekti i rivlerësimit, por është dhuruar prej tij te vjehri, dhe është ky i fundit që e ka shitur. Në mungesë të ndonjë kontrate dhurimi apo dokumenti tjetër që të provohet se vlera prej 1.600.000 lekësh e përfituar nga shitja i është dhuruar bashkëshortes së subjektit (pra, jo 2.600.000 lekë, siç është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*), këto të ardhura nuk janë konsideruar në analizën financiare si burim krijimi për ndërtimin e shtëpisë së banimit objekt verifikimi.

Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, jo vetëm nuk ka provuar me dokumentacion përfitimin e kësaj vlere nga vjehri i tij, por edhe ka ndryshuar burimin e krijimit të saj, duke deklaruar se vetëm 1.600.000 lekë buron nga kontrata e shitjes dhe vlera prej 1.000.000 lekësh është nga të ardhurat e prindërve të bashkëshortes. Për arsyet e mësipërme, Komisioni nuk i ka marrë këto të ardhura në konsideratë, për më tepër kur subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor kursimet e prindërve të bashkëshortes, në vlerën 1.000.000 lekë.

19. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit pasi, sipas tij, vlera 2.600.000 lekë që subjekti dhe bashkëshortja kanë përfituar nga prindërit e saj është e ligjshme dhe duhet të përfshihet në analizën financiare. Në ankim, subjekti pretendon se në vendimin e Komisionit nuk është pasqyruar shpjegimi i detajuar i dhënë prej tij në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, si dhe në seancën dëgjimore. Në kushtet kur gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë një sqarim të plotë dhe shterues sa i përket këtij burimi të ardhurash, duke paraqitur edhe prova mbështetëse, këto duhet të konsiderohen plotësisht të deklaratës së pasurisë *vetting* dhe, për këtë arsye, konstatimi i Komisionit, i cili e konsideron të pasaktë deklarimin e bashkëshortes së subjektit, është i pabazuar.
20. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

20.1. Më datë 13.09.1993, mes shitësit, Bashkia Tiranë, dhe blerësit, Agron Zhukri, nënshkruhet kontrata e shitblerjes, në të cilën përcaktohet se Bashkia Tiranë, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Territorit nr. {\*\*\*}, datë 02.12.1992, si pronare e trojeve të ndërtimit, i shet truallin me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, blerësit Agron Zhukri, për ndërtimin e një banese dykatëshe, në vlerën 101.970 lekë.

20.2. Këtë pasuri “truall”, subjekti i rivlerësimit ia dhuron nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.10.1995, babait të bashkëshortes, z. Dh. K. Ky i fundit, më datë 20.03.1996, ia shet me kontratë shitjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., z. N. F., kundrejt vlerës 1.600.000 lekë.

20.3. Në kushtet kur kjo pasuri nuk ka rezultuar e shitur, por i është dhuruar babait të bashkëshortes nga ana e subjektit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i dhurimit vjen për shkak të harresës në momentin e deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe se ka ardhur në kujtesë të tyre kur janë vënë në dijeni nga Komisioni. Akti i dhurimit, sipas subjektit, ka qenë një mënyrë që të mos ishin të detyruar të përgatisnin akte përfaqësimi për kontratat e ndërtimit apo edhe për shitjen, si pasojë e mosrealizimit të projektit të ndërtimit nga shoqëria ndërtuese. Të ardhurat nga shitja, z. Dh. K. ia dorëzoi vajzës së tij.

20.4. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se bashkëshortja e subjektit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, si lidhur me faktin e shitjes, ashtu edhe me vlerën e realizuar prej saj. Në mungesë të ndonjë kontrate dhurimi apo dokumenti tjetër me anë të të cilëve të provohet se vlera prej 1.600.000 lekësh e përfituar nga shitja i është dhuruar bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit (*pra, jo 2.600.000 lekë, siç është deklaruar në deklaratën vetting*), këto të ardhura nuk do të konsiderohen në analizën financiare si burim krijimi për ndërtimin e shtëpisë së banimit objekt verifikimi.

20.5. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar rrethanat që e kanë çuar drejt këtyre veprimeve juridike, më konkretisht:

20.5.1. Në kohën e lidhjes së kontratës në vitin 1995, subjekti sapo ishte emëruar gjyqtar, ndërkohë bashkëshortja ishte në pritje të lindjes së djalit të tyre të dytë. Për këto arsye, si dhe për shkak të marrëdhënies shumë të ngushtë familjare, ata kishin vendosur ta kalonin këtë pasuri në emër të vjehrrit, i cili në profesion ishte inxhinier, me një përgatitje shkencore dhe arsyetuese, pedagog dhe hartues i teksteve për fushën e tij të ekspertizës. Sipas subjektit, i vjehri ishte personi më i përshtatshëm dhe njëherësh shumë i besuar për të vepruar në dobi të zhvillimit të truallit, si dhe njihte në detaje zhvillimin e pronës, pasi në mungesë të tij dhe bashkëshortes, gjatë qëndrimit në Itali, ai ka ndjekur çdo element të kësaj procedure. Subjekti sjell në vëmendje se të dy prindërit e bashkëshortes, ndër vite kanë qenë prezent dhe kanë kontribuar, jo vetëm përmes asistencës financiare si në rastin konkret, por edhe në rritjen e edukimin e të dy fëmijëve të tyre. Në atë periudhë, i vjehri ishte diagnostikuar me një sëmundje të rëndë dhe, në të njëjtën periudhë, kishte ardhur në jetë djali i vogël i subjektit. Në këto kushte, ai, krahas dëshirës për të ndihmuar ekonomikisht vajzën e tij, bashkëshorten e subjektit, kishte edhe dëshirën për të bërë një dhuratë të tillë në kuadër të një gëzimi kaq të madh familjar siç ishte ardhja në jetë e fëmijës.

Kjo marrëdhënie kaq e afërt dhe e ngushtë, sipas subjektit, ka qenë edhe arsyeja përse këtë kalim pasurie nga ai tek vjehri nuk e kanë formalizuar nëpërmjet veprimeve juridike.

**20.5.2.** Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar Komisionin se vlera 2.600.000 lekë ka qenë në dispozicion të tij e të bashkëshortes në vitin 1996, dhe është përdorur për të realizuar punimet ndërtimore. Fakti që vetëm 1.600.000 lekë janë përfitur si rezultat i tjetërimit të kësaj prone dhe pjesa tjetër ka qenë e kursyer prej vjehrit nga burime të tjera të të ardhurave, është konstatuar vetëm së fundmi, pasi nuk kanë pasur në dispozicion dokumentacionin përkatës. Në kushtet kur babai i bashkëshortes ka ndërruar jetë në vitin 1997, pak kohë pas dhënies së kësaj vlere, ka qenë e pamundur që të kishin dijeni mbi këto elemente kur kanë deklaruar për herë të parë burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**20.5.3.** Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale të së vjehrës, znj. V. K.,<sup>25</sup> e cila ka konfirmuar shpjegimet e dhëna nga subjekti. Sipas saj, së bashku me vlerën e përfitur nga shitja, i kanë dhuruar vajzës së tyre edhe vlerën prej 1.000.000 lekësh, të akumuluar nga kursimet e tyre. Me të ardhurat nga pagat, shitja ndër vite e disa veprave të artit të familjes K. (piktura të vjehrit të saj, piktorit të mirënjohur A. K.), gjendja e likuiditeteve në formën e *napolona floriri* të trashëguara nga familja e z. Dh. K., të ardhura nga aktiviteti i babait të tij, si dhe nga kryerja e veprimtarive të tilla si mësimdhënie, botime librash shkollorë të përdorura nga departamenti i ndërlidhjes dhe rrymave të dobëta në katedrën e Universitetit Ushtarak, të z. Dh. K., inxhinier elektronik, si dhe nga mësimdhënia private e znj. V. K. si mësuese fizike dhe matematike. Bashkëlidhur deklaratës përcillet edhe shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 06.08.2021,<sup>26</sup> e Galerisë Kombëtare të Arteve, mbi veprat e të ndjerit A. K.

**20.6.** Trupi gjykues, sikurse edhe Komisioni në vendim, konstaton se bashkëshortja ka bërë deklaratë të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, jo në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me faktin e shitjes së kësaj pasurie dhe të vlerës së saj, pasi ashtu siç rezulton nga kontratat noteriale, kjo pasuri nuk është shitur nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja, por i është dhuruar babait të saj, dhe ky i fundit e ka shitur dhe, siç është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, ia ka dhënë vajzës si dhuratë vlerën e shitjes dhe një vlerë prej 1.000.000 lekësh të kursyera. Me të drejtë, Komisioni nuk e ka përfshirë këtë shumë si burim për ndërtimin e pasurisë në vitin 1996, në kushtet kur një fakt i tillë nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë 2003, dhe nuk provohet me asnjë dokument që vlera 2.600.000 lekë i është dhuruar bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

21. Në lidhje me të ardhurat nga dhënia me qira në favor të z. G. C. e banesës në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, për një periudhë 2-vjeçare, prill 1994 – prill 1996, në shumën 6.000 USD, pavarësisht

<sup>25</sup> Nr. {\*\*\*}/\*\*\* rep./kol., datë 02.04.2024.

<sup>26</sup> Në këtë kërkesë citohet se: “Veprat e artit të artistit A. K. janë bërë pronë e Galerisë Kombëtare të Arteve (GKA) gjatë harkut kohor të viteve 1956 deri në 1979, nëpërmjet procedurës së shitblerjes, sipas legjislacionit në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve, dhe GKA disponon dokumentacionin përkatës për çdo vepër. Të drejtën për formën e prezantimit dhe promovimit për publikun na e njeh ligji, konkretisht neni 83 i ligjit nr. 35/2016, datë 31.03.2016 ‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’, ligji nr. 10352, datë 18.11.2010 ‘Për artin dhe kulturën’, i ndryshuar dhe ligji nr. 27/2018, datë 17.05.2018 ‘Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë’. Galeria Kombëtare e Arteve ju ka kthyer përgjigje për sa keni kërkuar dhe, në bazë të dispozitave ligjore, siç dhe ju keni gjithë të drejtën të mund të provoni të kundërtën, sipas legjislacioni shqiptar pranë institucioneve përkatëse”.

pretendimeve të subjektit se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të mbajtur kopje të mandatpagesave që vërtetojnë pagesat e tatimit në burim, i cili, sipas kontratës së qirasë, i takonte subjektit, Komisioni vlerësoi që, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë titullar i pasurisë së dhënë me qira, nuk ka vërtetuar përfitimin e ndonjë të ardhure apo pagimin e ndonjë tatimi mbi të ardhurat, të ardhurat e pretenduara nga qiraja nuk mund të konsiderohen të ligjshme në kuadër të këtij procesi.

22. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga marrëdhënia e qirasë, duke e konsideruar konkluzionin e Komisionit të kundërligjshëm. Subjekti ka pretenduar se: (i) Duhet të mbahet parasysh vështirësia e tij në mbledhjen e provave, për arsye të mosfunksionimit normal të instancave shtetërore, problematikë kjo e hasur dhe nga vetë Komisioni në lidhje me pagat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të gjatë punësimit në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Itali. Komisioni e konsideroi të ezauruar detyrimin për kryerjen e një hetimi administrativ, duke u mjaftuar vetëm me dërgimin e kërkesës për informacion, e duke mbajtur një qëndrim pasiv, kur nuk është pajisur me informacionin e kërkuar. I njëjti standard, subjekti i rivlerësimit kërkon të aplikohet, edhe në rastin kur me të tilla përgjigje ndeshet edhe subjekti i rivlerësimit, i cili vijon dhe kryen çdo përpjekje të nevojshme e të mundshme për t'i shërbyer procesit në drejtim të plotësimit të kuadrit të dokumentacionit provues. (ii) Konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pronar i pasurisë së dhënë me qira është tërësisht i paligjshëm, ndërkohë që pasuria është fituar nëpërmjet trashëgimisë ligjore, si dhe kontratës së dhurimit nga vëllezërit dhe motrat e tij, akte të cilat janë nënshkruar përfundimisht në korrik 1994.

23. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

23.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e banesës në rrugën “{\*\*\*}”, nr. {\*\*\*}, për periudhën prill 1994 deri në prill 1996, me qira mujore 250 USD, në total 6.000 USD. Sipas subjektit, bashkia nuk disponon të dhëna për tatimin e paguar për këtë periudhë.

23.2. Kësaj deklaratë, subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur edhe një kontratë qiraje banese (akt jonoterial), e datës 01.04.1994, lidhur mes tij, S. Zh. dhe qiramarrësit G. B. C., me objekt dhënie me qira e banesës nga qiradhënësi tek qiramarrësi, në rrugën “{\*\*\*}” nr. {\*\*\*}, që do të përdoret për nevoja strehimi dhe si zyrë e shoqërisë “{\*\*\*}”. Referuar kushteve të përcaktuara në kontratë, ajo lidhet për një afat prej dy vitesh, në vlerën 250 USD/muaj. Qiradhënësi i lë në dispozicion qiranë e tre muajve qiramarrësit për restaurimin e saj, në vleftën 750 USD. Në pjesën hyrëse të kontratës përcaktohet: “*e lidhur sot, në datën 1 prill 1994*”, ndërkohë që në pjesën fundore të kontratës, rezulton e nënshkruar më 09.03.1994.

23.3. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se *nuk ka dokumentacion në lidhje me pagesën e tatimit mbi këto të ardhura. Si rrjedhojë, këto të ardhura nuk do të konsiderohen në analizën financiare të kësaj periudhe.* Në prapësimet e tij, subjekti, ndër të tjera ka sqaruar se në harkun kohor 1994 – 1996, në të cilën ka pasur fuqi juridike dhe është zbatuar kjo kontratë, ka qenë në fuqi ligji nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i cili, në nenin 2, pika 4, përfshinte në kategorinë e të ardhurave të tatueshme, edhe

të ardhurat nga qiratë e banesave, dyqaneve, magazinave, tokës dhe objekteve të tjera. Për të provuar kryerjen e pagesave për tatimin mbi këtë të ardhur, subjekti i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, është përgjigjur se *administrata tatimore është në pamundësi objektive për të vënë në dispozicion të dhëna që i përkasin periudhës 1994 – 1996, pasi për shkak të kohës së largët, nuk disponohen të dhëna të plota në arkivin e institucionit për të gjithë subjektet si persona fizikë apo individë, si dhe për shkak të mungesës së një sistemi unik dokumentar apo elektronik për atë periudhë.*

23.4. Në vijim të prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se për këtë të ardhur është bërë pagesa e çdo detyrimi tatimor që buron nga ligji i sipërcituar dhe përcaktohet në nenin 8 të përmbajtjes së kontratës së qirasë, që *“detyrimet tatimore ndaj shtetit, që mund të lindin nga kjo banesë do të përballohen nga qiradhënësi”*. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit depoziton deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.04.2024, të znj. S. I., e cila deklaron se, nga muaji prill 1994 deri në prill 1996, së bashku me ish-ortakun G. C. kanë marrë me qira shtëpinë e z. Agron Zhukri për përdorim zyre dhe ambiente për jetesë. Për të vërtetuar pagimin e detyrimit kontraktual mujor dhe bazuar në kontratën e ligjet e kohës, tatimi për të ardhurën nga qiraja, sipas deklaruësës, paguhej nga qiradhënësi. Duke qenë se kishin edhe ambientet e aktivitetit tregtar të shoqërisë “{\*\*\*}”, kërkohej rregullisht çdo muaj të vërtetonin pagimin e tatimit në burim, pasi ishin subjekt kontrolli. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, rreth 28 – 30 vite nga koha e vlefshmërisë dhe përdorimit të kësaj rezidence banimi e biznesi, nuk disponohen dokumentet e kërkuara nga z. Agron Zhukri.

23.5. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me këtë burim të ardhurash të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, pikësëpari konstaton mospërputhje sa i përket banesës së lënë me qira, pasi në deklaratën e pasurisë *vetting*, i referohet banesës nr. {\*\*\*}, që subjekti i rivlerësimit u bë pronari i saj më datë 05.08.1994, pas procedurave të trashëgimisë dhe dhurimit, ndërsa në tekstin e kontratës së qirasë së datës 01.04.1994, përcaktohet dhënia me qira e banesës me nr. {\*\*\*}, që ishte përfituar nga e motra e tij F. Zh., në të njëjtën mënyrë sikurse edhe nga subjekti i rivlerësimit. Përpos sa më sipër, kjo kontratë ka edhe një specifike që lidhet me datën e nënshkrimit, pasi në përmbajtje të saj, njëherë përcaktohet e lidhur më datë 01.04.1994, dhe më pas, e nënshkruar më datë 09.03.1994. Po kështu, ndonëse në kontratë përcaktohet vlera 250 USD në muaj, që për dy vjet rezulton 6.000 USD në total, sipas përmbajtjes së vetë kontratës, qiradhënësi Agron Zhukri i lë në dispozicion qiranë e tre muajve qiramarrësit për restaurimin e saj, në vleftën 750 USD. Në këto kushte, të ardhurat nga qiraja nuk do të ishin 6.000 USD, sa deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, por 5.250 USD. Nëse banesa me qira ka qenë ajo e përcaktuar në kontratën e qirasë me nr. {\*\*\*}, e përfituar nga e motra F. Zh., ashtu siç përcakton edhe Komisioni në vendim, subjekti ka lënë me qira një banesë të cilën nuk e ka pasur ai në pronësi, por e motra e tij. Nëse banesa me qira do të ishte ajo e subjektit të rivlerësimit, me nr. {\*\*\*}, si deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, atëherë ky fakt do të binte në kundërshtim me deklarinimin e tij në përgjigjet e pyetësorit standard se: *“Detyrën e gjyqtarit e ushtror prej datës 01.07.1994. Që prej kësaj kohe e deri më sot, adresa ime e banimit ka qenë e pandryshuar dhe ndodhet në rrugë ‘{\*\*\*}’, banesa nr. {\*\*\*}, Tiranë”*. Përpos këtyre mospërputhjeve të cilat afektojnë besueshmërinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur subjekti nuk arriti të provonte ekzistencën e këtyre të ardhurave, nuk mund të kalohet në testin e dytë, atë të ligjshmërisë së tyre, sa i përket shlyerjes së detyrimit

tatimor. Për sa më sipër, ashtu si Komisioni, në kontrollin e analizës financiare, trupi gjykues nuk konsideroi në mesin e të ardhurave të ligjshme, ato të pretenduara nga qiraja.

24. Komisioni në vendim ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë të ardhurat e përfituara nga punësimi i tij dhe personi i lidhur me të në Ambasadën e Shqipërisë në Romë, të cilat, në analizë të provave rezultuan në vlerën 7.735 USD për subjektin dhe 8.330 USD për bashkëshorten. Të ardhurat e përfituara janë marrë në formë *alokacioni*, që konsiston në një pagesë e cila mundëson jetesën bashkë me familjen. Në këtë kuptim, këto të ardhura janë përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja për të përballuar jetesën në shtetin italian. Komisioni vlerëson se këto të ardhura janë shpenzuar sipas destinacionit për të cilin janë dhënë, referuar kjo edhe nivelit minimal të shpenzimeve jetike në Itali dhe, si të tilla, ato nuk mund të jenë kursyer dhe të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të subjektit dhe personit të lidhur. Pavarësisht dokumentit bankar i cili konfirmon balancën prej 15.000.000 liretash italiane në datën 17.02.1994 (depozituar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*), nga analizimi i mundësisë për kursime me të ardhura të ligjshme gjatë qëndrimit në Itali, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë përfituar në total, të ardhura në vlerën 16.065 USD ose 1.524.569 lekë (konvertuar me kursin e këmbimit të vitit 1994), ndërsa shpenzimet jetike sipas standardit italian (përfshirë qiranë) janë në vlerën 1.651.784 lekë, pra, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e kursimeve në bankë, në vlerën 15.000.000 lireta, me të ardhura nga puna pranë Ambasadës së Shqipërisë në Itali.
25. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e arritura nga Komisioni, me këto pretendime: (i) Qëndrimi i Komisionit për të mos përfshirë vlerën 15.000.000 lireta italiane në analizën financiare të kryer prej tij është tërësisht i paligjshëm në kushtet kur kjo shumë ka një burim të identifikuar të origjinës, që është paga e kaluar nëpërmjet bankës për subjektin dhe bashkëshorten, si dhe ka rezultuar e patërhequr nga shërbimi bankar, por e kursyer në gjendje llogarie, në vlerën e mësipërme. (ii) Kuadri ligjor në lidhje me shërbimin e jashtëm, në vitet 1992 – 1994 është rregulluar nëpërmjet vendimit nr. 473, datë 29.09.1993, të Këshillit të Ministrave, dhe vendimit nr. 181, datë 12.12.1979, të Këshillit të Ministrave “Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës Socialiste të Shqipërisë në shtetet e huaja dhe për shpenzimet e udhëtimit e të dietave për personat që dalin jashtë shtetit”, në të cilin është përcaktuar mënyra e trajtimit financiar të trupës së përfaqësive diplomatike dhe stafit mbështetës gjatë periudhës që ushtron detyrën, sipas misionit në shtetin e huaj, si dhe trajtimin me dietë për punonjësit e përfaqësive diplomatike. Kjo dietë, për ditë të plotë pune ka qenë në masën 35 dollarë amerikanë, dhe për gjysmë dite pune, në vlerën 12 dollarë amerikanë. (iii) Të gjitha shpenzimet e nevojshme të jetesës për familjen përballoheshin nga shteti shqiptar, si shteti dërgues. Në lidhje me shpenzimet për ushqim, për përfaqësitë diplomatike dhe stafin mbështetës të akredituar në shtetin italian, kishte vende të posaçme ku furnizoheshin me produkte ushqimore, si dhe çdo produkt tjetër të nevojave të përditshme, me çmime të skontuara, të përjashtuara nga çdo taksë.
26. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:
  - 26.1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 ka deklaruar të ardhura nga puna në Itali, si një nga burimet e pasurive të krijuara prej tij dhe personit të lidhur.

26.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi pagën e përfituar gjatë punës në Ambasadën Shqiptare në Romë për periudhën janar 1993 deri në prill 1994, për 16 muaj, me total pagash 760.000 lireta italiane, konvertuar në 1.002.016 lekë, ndërsa bashkëshortja ka deklaruar të ardhurat nga paga si financiare 420.000 lireta italiane për 15 muaj, shkurt 1993 – prill 1994, në vlerën 519.400 lekë. Të dy bashkëshortët deklarojnë se i janë drejtuar administratës tatimore, të cilët janë përgjigjur që nuk disponojnë të dhëna të kësaj periudhe. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, përcillen: (i) një kopje e noterizuar e gjendjes së llogarisë së përbashkët të tyre në “Banca Nazionale del Lavoro”, në Romë, nga ku evidentohet se më datë 17.02.1994, balanca e kësaj llogarie ka qenë 15.000.000 lireta italiane, si dhe (ii) biletat e avionit për vajtjen në Romë të blera nga Ministria e Jashtme me linjën *Albanian Airlines*. Bashkëshortja deklaroi në të njëjtën deklaratë se, me kthimin në Tiranë dispononte në llogari rreth 1.250.000 (*nuk përcakton valutën*) nga konvertimi i llogarisë që dispononte në Romë, vlerë e cila më pas është depozituar në ish-Bankën e Kursimit (aktualisht, Raiffeisen Bank ShA).

26.3. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se deri në këtë fazë të hetimit, nuk rezultoi i vërtetuar punësimi i subjektit dhe bashkëshortes në Ambasadën e Shqipërisë në Romë, dhe as të ardhurat nga punësimi e, si rrjedhojë, shumat e deklaruara, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk u konsideruan në analizën financiare të kryer prej tij. Në këto kushte, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka provuar burimin e kursimeve në bankë në vlerën 15.000.000 lireta italiane me të ardhura nga puna në Ambasadë apo të ardhura të tjera, si dhe faktin që këto të ardhura janë të ligjshme, sipas pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të kundërtën, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

26.4. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar se ai dhe bashkëshortja kanë jetuar dhe punuar në Itali nga muaji dhjetor 1992 deri në prill 1994, pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Romë, respektivisht ai në pozicionin e shoferit, nga data 16.01.1993 deri më 19.04.1994 dhe bashkëshortja në pozicionin e financieres, nga muaji shkurt 1993 deri në prill 1994. Ky fakt vërtetohet, sipas tij nga: (i) librezat e punës; (ii) vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 27.03.2024, i Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme, në të cilin citohet ndër të tjera se: “Vërtetohet se znj. R. Zh. ka shoqëruar bashkëshortin, z. Agron Zhukri, me detyrë shofer në Ambasadën e RSH-së në Romë dhe, gjatë kësaj periudhë, ka punuar financiare deri më 01.05.1994. Alokacioni për znj. Zh. në këtë pozicion ka qenë 490 dollarë”, si dhe; (iii) vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 27.03.2024, me të cilin Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, vërteton se: “z. Agron Zhukri ka qenë me detyrë shofer në Ambasadën e RSH-së, në Romë, nga data 02.12.1992 deri më 01.05.1994. Alokacioni për z. Zhukri në këtë pozicion ka qenë 455 dollarë”. Referuar këtyre pagave, subjekti pretendon në ankim e parashtrime se, në total, ai ka përfituar vlerën 7.280 USD, e konvertuar në 782.022 lekë dhe bashkëshortja 8.330 USD, konvertuar në 842.178 lekë. Këto vlera janë kaluar nëpërmjet shërbimit bankar dhe kanë qenë të disponueshme e janë përdorur për rikonstruksionin e pasurisë objekt analize.

26.5. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit depoziton deklaratën e datës 21.03.2024 të z. G. K., ish-diplomat pranë Ambasadës së Shqipërisë në Romë, i cili deklaroi se z. Agron Zhukri ka qenë shofer i ish-ambasadorit dhe, gjatë kësaj periudhe, ka qenë i shoqëruar nga personi i lidhur, e cila mbulonte sektorin e financës, si dhe nga djali i tyre, A. Zh. Në këtë periudhë, familja e tij ka jetuar në apartamentet pronë e shtetit shqiptar, në të cilat kanë qenë të sistemuara familjet e personelit diplomatik dhe/ose administrativo-teknik të ambasadës, në adresën “{\*\*\*}”. Po kështu, depozitohet nga subjekti edhe urdhri i brendshëm i datës

02.05.1994, i Ambasadës së Shqipërisë në Romë, për rregullimin e debiteve përkatëse mes ambasadës dhe familjes Zhukri pas përfundimit të marrëdhënies së punës. Në fund të tekstit të këtij urdhri, citohet: “[...] porositen edhe njëherë z. G. K. dhe z. Agron Zhukri për lirimin e menjëhershëm të apartamenteve të banimit, përkatësisht me nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} në rrugën ‘{\*\*\*}’, në bazë të inventarëve përkatës. Qëndrimi i mëtejshëm do t’i ngarkojë ata edhe me detyrimet financiare përkatëse ndaj shtetit”.

26.6. Komisioni i është drejtuar me kërkesë për informacion Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, lidhur me të dhënat e punësimit të Agron dhe R. Zh. në Ambasadën Shqiptare në Itali, për periudhën janar 1993 – prill 1994, për të ardhurat e tyre bruto dhe neto. Kjo ministri, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 27.03.2024, bën me dije se, referuar vendimit nr. 473, datë 29.09.1993, të Këshillit të Ministrave, punonjësit e përfaqësive të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, në vend të *pagës* kanë përfituar *alokacion*. Për z. Agron Zhukri, i cili ka ushtruar detyrën e shoferit në Ambasadën Shqiptare në Romë, Itali, alokacioni ka qenë në masën 455 dollarë amerikanë në muaj, ndërsa për znj. R. Zh., e cila ka mbajtur pozicionin e llogaritares/financieres në këtë përfaqësi diplomatike, alokacioni ka konsistuar në masën 490 dollarë amerikanë në muaj. Bashkëlidhur kësaj shkrese, përcillen vendimet nr. {\*\*\*}, datë 02.12.1992, dhe nr. {\*\*\*}, datë 19.04.1994, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, për emërimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për z. Agron Zhukri.

26.7. Nga analizimi i deklaratës së pasurisë *vetting* dhe akteve të dosjes, trupi gjykues konstaton se të ardhurat nga paga, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur i deklarojnë nga viti 1993 e në vijim, pra, nuk rezulton që të jetë administruar dokumente për të ardhurat nga paga para këtij viti. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar me deklaratën e pasurisë *vetting*, edhe dokumentin bankar të lëshuar nga *Banca Nazionale del Lavoro (BNL)*, Romë, Itali, sipas së cilit, në llogarinë bankare nr. {\*\*\*} të Agron Zhukrit dhe R. Zh., më datë 17.02.1994, rezulton të jetë gjendje vlera 15.000.000 lireta italiane, e investuar në depozitë me afat 18 muaj, dhe interes 7.25% në vit. Pavarësisht se kjo shumë ka qenë gjendje përpara se subjekti i rivlerësimit të merrte detyrën e gjyqtarit, pra, e pavarur me statusin për të cilin i nënshtrohet këtij procesi, në kushtet kur është pretenduar si burim për pasurinë e krijuar gjatë periudhës që subjekti ushtronte prej dy vitesh detyrën e gjyqtarit, si dhe janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e këtyre kursimeve. Sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë analizën e kryer nga Komisioni, i cili, në kontrollin e kryer për krijimin e kësaj vlere, i referohet të ardhurave të realizuara nga punësimi në Itali, të provuara me dokumente, të cilat në total arrijnë vlerën 16.065 USD ose 1.524.569 lekë. Sa i përket shpenzimeve jetike, ndonëse nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës me rezultatet e hetimit mbi mënyrën e përlllogaritjes së tyre, Komisioni i është referuar të dhënave zyrtare<sup>27</sup> të Institutit të Statistikave në Itali, praktikë e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e tij. Në kushtet që analiza financiare e Komisionit është objekt kontrolli në Kolegj, moskalimi i barrës së provës mbi shpenzimet e jetesës në Itali apo moskërkimi i sqarimeve gjatë seancës dëgjimore, nuk afektojnë procesin e rivlerësimit të kryer në Komision. Efekt në rezultat do të kishin vetëm të ardhurat, kostot e jetesës janë konstante për familje me tre anëtarë, në periudhën në fjalë.

<sup>27</sup> Këto të dhëna gjenden në faqen zyrtare të këtij institucioni në internet.

26.8. Lidhur me trajtimin me dietë për punonjësit e përfaqësive diplomatike, e cila për ditë të plotë pune ka qenë në masën 35 dollarë amerikanë, dhe për gjysmë dite pune në vlerën 12 dollarë, trupi gjykues është përgjigjur në paragrafin 12.4 të këtij vendimi. Ndërsa, pretendimin se të gjitha shpenzimet e nevojshme të jetesës për familjen përballoheshin nga shteti shqiptar si shteti dërgues, dhe se për shpenzimet për ushqim kishte vende të posaçme ku furnizoheshin me produkte ushqimore, si dhe çdo produkt tjetër të nevojave të përditshme, me çmime të skontuara të përjashtuara nga çdo taksë, trupi gjykues e konsideron të mbetur në nivel deklarativ e të pambështetur në prova. Ndryshe nga Komisioni, i cili në analizën financiare të kryer prej tij për periudhën 1993 – 01.09.1996<sup>28</sup> nuk përfshiu as të ardhura, as shpenzime jetike gjatë qëndrimit në Itali, trupi gjykues nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, verifikoi gjendjen financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për të njëjtën periudhë, duke konsideruar në analizën financiare të kontrolluar, të ardhurat e realizuara prej tyre sipas dokumentacionit dhe shpenzimet jetike, sipas Eurostat-it<sup>29</sup>, pa përfshirë shpenzime qiraje, që siç vërtetohet nga urdhri i brendshëm i datës 02.05.1994, i Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Romë, janë mbuluar nga shteti shqiptar. Me këtë arsyetim, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi të kursenin 254.328 lekë për periudhën 1993 – prill 1994, të pamjaftueshme këto për krijimin e vlerës 15.000.000 lireta italiane apo 935.250 lekë,<sup>30</sup> gjatë periudhës janar 1993 – prill 1994, të punësimit të tyre në Ambasadën Shqiptare në Romë. Me fjalë të tjera, pavarësisht se dokumenti bankar provon ekzistencën e kësaj balance në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në Banca Nazionale del Lavoro, analiza financiare e kryer për të njëjtën periudhë tregon pamjaftueshmëri për krijimin e saj. Për këtë periudhë të analizuar, trupi gjykues ka vlerësuar të konsiderojë mundësinë e kursimit të subjektit dhe personit të lidhur, në vlerën 254.328 lekë.

27. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga trajnimi i bashkëshortes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në vijim “ShBA”), Komisioni nuk i ka marrë ato në konsideratë, pasi sipas praktikës së tij, vlerat e përfituara në formën e dietave kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve për nevoja ushqimore apo fjetjeje të kryera gjatë qëndrimit jashtë, prandaj, në analizën financiare nuk janë konsideruar në zërin e të ardhurave.
28. Subjekti në ankim pretendon se Komisioni nuk ka dhënë asnjë argument ligjor për të përligjur mospërfshirjen e tyre në analizë financiare, por është mjaftuar vetëm me një paragraf në vendim, në të cilin citon se ka një praktikë në drejtim të vlerësimit të dietave në raste të ngjashme, por nuk jep asnjë referencë konkrete, duke lënë kështu të paargumentuar këtë pikë, praktikë e përsëritur kjo në rastin konkret të rivlerësimit, në kundërshtim me ligjin.
29. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

---

<sup>28</sup> Këtë analizë të cilën e gjeni në vijim të paragrafit 31, faqja 12 e vendimit nr. 759 (JR), datë 19.04.2024, Komisioni e ka kryer në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit dhe bashkëshortes për të investuar në ndërtimin e banesës në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë.

<sup>29</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/HBS\\_EXP\\_T121\\_custom\\_18219341/default/table](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/HBS_EXP_T121_custom_18219341/default/table)

<sup>30</sup> Konvertuar me kursin e këmbimit sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë për vitin 1994, [https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

29.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga kursi “{\*\*\*}” mbajtur në ShBA për periudhën 12 maj – 12 qershor 1992, organizuar nga USIS<sup>31</sup>, i cili e ka pajisur me *traveller’s cheques* (çeqe), me vlerë 4.800 USD, nga e cila 3.800 USD u kursyen dhe u përdorën në vite prej saj. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* është depozituar një kopje e vërtetimit të lëshuar nga USIS Tirana, me të cilin vërtetohet se znj. R. Zh. ka plotësuar me sukses programin e trajnimit në “{\*\*\*}” në ShBA përgjatë periudhës maj – qershor 1992.

29.2. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se bashkëshortja e tij ka marrë pjesë në një trajnim njëmuor, të zhvilluar në ShBA në periudhën 12.05.1992 – 12.06.1992. Trajnimi është bërë për “{\*\*\*}”. Shpenzimet e udhëtimit janë përballuar nga trajnuesit dhe, nga ana e bashkëshortes është përfituar shuma prej 4.800 dollarë, nga e cila ka kursyer vlerën 3.800 USD, konvertuar sipas kursit të këmbimit të kohës në 513.000 lekë. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti depoziton itinerarin e udhëtimit, agjendën e trajnimit “{\*\*\*}”, organizuar në Arkansas, dhe listën e pjesëmarrësve në të, në të cilën figuron edhe bashkëshortja, si dhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.04.2024, të z. B. H., njëherësh pjesëmarrës në programin njëmuor të organizuar nga USIS, sipas të cilit, organizuesit i pajisën edhe me buxhetin e nevojshëm për nevojat jetike gjatë këtij udhëtimi. Kuota e përcaktuar dhe e dhënë individualisht të gjithë pjesëmarrësve në zyrën e USIS, në Tiranë, ishte 160 USD/ditë/person, për një total prej 32 ditësh, në total 5.120 USD.

29.3. Lidhur me këto të ardhura, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë provuar me dokumentacion masën e pretenduar prej 4.800 USD, por edhe nëse do të pranohej ekzistenca e saj, Kolegji tashmë në jurisprudencën<sup>32</sup> e tij ka mbajtur qëndrim të konsoliduar, duke mos përfshirë në analizë të ardhura nga dietat, pasi ato jepen për përmbushjen e një detyre/qëllimi të caktuar.

30. Në mbështetje të arsyetimit më sipër, sa i përket analizimit të secilit prej burimeve të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, trupit gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, i rezultoi se subjekt i rivlerësimit dhe personi i lidhur ndodhen në kushtet e mungesës kumulative të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën (-) 1.900.003 lekë, për të investuar 25.000 USD, për rikonstrukcionin e banesës dhe katit nën çati, në vitin 1996. Ndryshimi me diferencën negative të konstatuar nga Komisioni prej (-) 2.328.365 lekësh për ndërtimin e banesës në vitin 1996, qëndron në përfshirjen e mundësisë për kursim të subjektit dhe personit të lidhur, në masën 254.328 lekë, gjatë qëndrimit dhe punësimit në Itali, si dhe efekti i prodhuar nga kursi i këmbimit lireta italiane/lekë.
31. Në përfundim, për pasurinë e llojit “truall” me sipërfaqe 101.45 m<sup>2</sup> dhe “ndërtesë” me tri kate, me sipërfaqe totale 269.4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe jo në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për burimin e krijimit të kësaj pasurie, dhe kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimin në

<sup>31</sup> *The United States Information Service.*

<sup>32</sup> *Shih, ndër të tjera, vendimin nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 36, të Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.*

këtë pasuri në vitin 1996, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e këtij ligji.

*B/2. Për pasurinë e llojit “truall”, me sipërfaqe 75 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*

32. Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, pasi ai i referohet balancës pozitive progresive për vitin 2005, metodologji kjo e cila është e gabuar, pasi për periudhën 2003 – 2016 (deklarimi sipas ligjit nr. 9049/2003), tepricat e rezultatit financiar të këtyre viteve nuk mbarten në vitin pasardhës në formën e një mundësie për kursim, por, për secilin vit, në analizën financiare pasqyrohet ajo që është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike dhe, nëse viti rezulton me një balancë pozitive, kjo tregon vetëm se subjekti ka pasur burime të ligjshme atë vit dhe se ajo tepricë konsiderohet e shpenzuar për faktin se nuk rezulton e deklaruar si kursim, pra, ajo nuk mund të mbartet në vitin pasardhës, sikundër ka vepruar subjekti. Gjithashtu, nga analiza financiare e rishikuar nga Komisioni, pas dërgimit të prapësimeve dhe vlerësimit të tyre, rezultoi se në momentin e krijimit të kësaj pasurie, balanca është në vlerën (-) 1.194.780 lekë.
33. Subjekti i rivlerësimit e ka konsideruar të gabuar konstatimin e Komisionit mbi mungesën e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, në kushtet kur, siç rezulton nga akti i ekspertimit, referuar të ardhurave të dokumentuara dhe analizës së raportit të ardhura/shpenzime, rezulton se ka një balancë pozitive progresive, në vlerën 18.434.071 lekë për vitin 2005, kohë në të cilën është blerë kjo pasuri.
34. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:
- 34.1. Në rubrikën “konstatime të tjera” të vendimit objekt shqyrtimi, Komisioni trajton edhe pasurinë “truall” me sipërfaqe 75 m<sup>2</sup>. Nga aktet në fashikull, Komisionit i ka rezultuar se kjo pasuri, e ka zanafillën në një nga dy shtëpitë e blera nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 1965, që, pas çeljes së trashëgimisë, iu dhurua nga trashëgimtarët e tjerë motrës së subjektit, znj. F. Zh., konkretisht shtëpia me nr. {\*\*\*}, e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë.
- 34.2. Kjo pasuri rezulton të jetë tjetërsuar më pas. Më konkretisht, nëpërmjet kontratës nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 28.07.1999, F. Zh. ia shet këtë banesë z. B. T. në vlerën 10.000.000 lireta italiane<sup>33</sup>. Sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 26.04.2001, B. T. i shet banesën nënës së bashkëshortes së subjektit, znj. V. K., kundrejt çmimit 500.000 lekë. Kjo e fundit ia shet më pas këtë pasuri vajzës së saj, znj. R. K., me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 08.04.2005, në vlerën 200.000 lekë, likuiduar para përpilimit të kontratës. AShK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Jug<sup>34</sup>, ka konfirmuar se në pronësi të bashkëshortes së subjektit figuron pasuria me nr. {\*\*\*}, zona kadastrale {\*\*\*}, truall me sipërfaqe 75 m<sup>2</sup>.
- 34.3. Kjo pasuri nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2005, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka ndryshim në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, referuar

<sup>33</sup> Konvertuar në 740.400 lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të lretave italiane në lekë (1.000 lireta me 74.04 lekë) të Bankës së Shqipërisë.

<sup>34</sup> Me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 07.07.2021, dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 26.05.2023.

deklarimit të vitit 2004. Ndërkohë, bashkëshortja nuk ka bërë deklaram në këtë vit. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk e kanë deklaruar këtë pasuri, “truall” me sipërfaqe 75 m<sup>2</sup> dhe “ndërtesë” me sipërfaqe 67 m<sup>2</sup>, që, sipas dokumentacionit të pronësisë, është kufitare me pasurinë nr. {\*\*\*}, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, trajtuar më sipër.

34.4. Në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3 të Komisionit, lidhur me mosdeklarimin e pasurisë dhe burimin e krijimit të saj, subjekti ka sqaruar se motra e tij, në vitin 1994, u vendos në Romë, Itali, ku jeton edhe aktualisht. Pas rikonstruksionit të shtëpisë nga subjekti, edhe e motra vendosi të bënte të njëjtën gjë, por, për shkak se ishte e punësuar në Itali, e kishte të pamundur të ndiqte punimet, duke e lënë atë të rikonstruktuar pjesërisht. Kur nuk ishte më e interesuar për të jetuar në Shqipëri, motra vendosi ta shiste këtë pasuri. Në lidhje me mosdeklarimin, subjekti ka sqaruar se kjo ka ndodhur kohë më parë se të fillonin deklaramin, dhe se ndërtesa tashmë e pabanueshme u shkatërrua dhe, nga ajo kohë, ekziston vetëm si oborr shtëpie dhe përdoret për nevoja të përditshmërisë së tyre. Çmimi i blerjes 200.000 lekë, referuar vlerës së ulët, nuk e bën subjekt deklarami dhe, elementi më i rëndësishëm që ka ndikuar në mosdeklarim ka qenë fakti se është konsideruar gjithmonë si oborr i shtëpisë.

34.5. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni është shprehur se *sqarimet e subjektit për mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë vetting janë jo të logjikshme dhe të pakuptimta, pasi kjo pronë është blerë në vitin 2005, pra, pasi kanë filluar deklaramet, si dhe argumenti se çmimi i blerjes prej 200.000 lekë nuk përbën subjekt deklarami është jologjor*. Sipas Komisionit, subjekti ka sqaruar se në vitin 1994, në shtëpi nuk banonte askush, pasi familja e tij dhe ai punonin në Ambasadën Shqiptare në Romë, gjithashtu edhe motra e tij. Në kushtet që ai ishte personi që kujdesej për shtëpinë, pasi në 1994 nuk ishte bërë ende akti i trashëgimisë dhe, në konsensus, si djali i shtëpisë që kishte mbajtur barrën e shpenzimeve të përditshme, me nevoja për të zhvilluar jetën familjare, nuk ishte diskutuar përfitimi i qirasë së banesës. Subjekti kishte shpjeguar se nuk ka kryer investime në këtë pasuri dhe nuk disponon kontratë për furnizimin me energji dhe ujë, pasi prona ishte truall (oborr shtëpie). Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor<sup>35</sup>, pas kërkesës së Komisionit mbi lartësinë e ndërtesës sipas fotografimeve ndër vite, ka informuar se nuk mund të identifikojë territorin ku ndodhet pasuria nr. {\*\*\*}.

34.6. Në vijim të sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për këto konstatime: (i) mungesën e burimeve të ligjshme për të blerë pasurinë nr. {\*\*\*}, “truall 75 m<sup>2</sup>”; (ii) mosdeklarimin e pasurisë në deklaratën periodike vjetore 2005, dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*; (iii) paqartësinë përse këtë pasuri, fillimisht motra e subjektit ia ka shitur një personi të tretë në shumën prej 10.000.000 lireta italiane ose 740.400 lekë, i cili, më pas, ia ka shitur nënës së bashkëshortes në vlerën 500.000 lekë, e cila, më pas, ia ka shitur bashkëshortes së subjektit më lirë, në vlerën 200.000 lekë.

34.7. Në prapësimet mbi barrën e provës, subjekti i rivlerësimit, pasi bën përkrahimin e origjinës së kësaj pasurie, nga blerja, trashëgimia e dhurimi, i referohet deklaratës noteriale të z. B. T.<sup>36</sup>,

---

<sup>35</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 27.06.2023, përgjigjet se nuk zotëron informacion gjeohapësinor nga AShK, si institucioni përgjegjës për parcelat kadastrale e, për rrjedhojë, nuk mund të identifikojë territorin ku gjenden pasuritë nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*}.

<sup>36</sup> Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.04.2024.

sipas së cilit, qëllimi në momentin e blerjes ka qenë investimi në këtë pronë, duke shembur ndërtimin ekzistues dhe realizimin e një ndërtimi të ri, duke përfshirë edhe pronën fqinje. Sipas deklaruës, për arsye të mosarritjes së një marrëveshjeje të arsyeshme me një nga kufitarët e pronës, vendosi ta shiste atë në favor të znj. V. K. në vitin 2001, kundrejt vlerës 500.000 lekë. Në vijim të prapësimeve, subjekti ka sqaruar se, në kushtet kur nuk u arrit të rikonstruktohej as nga motra, as nga z. T., për shkak të amortizimit, banesa ishte prishur. Kjo ishte arsyeja e shitjes së kësaj pasurie në një vlerë më të ulët në raport me atë të blerjes, pasi banesa vinte duke u amortizuar derisa u shemb. Në kushtet kur pronat ishin kufitare, subjekti sqaron se sipërfaqja e banesës nr. {\*\*\*}, tashmë është oborr i shtëpisë që përdor subjekti që prej vitit 1996. Me shembjen e banesës nr. {\*\*\*}, trualli u ble nga bashkëshortja kundrejt vlerës 200.000 lekë. Shitja në këtë moment është bërë në një vlerë më të ulët në raport me atë të blerjes, për arsye se nga një pasuri “truall + banesë”, kishte mbetur vetëm “truall”, si dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme nënë - bijë.

34.8. Sa i përket burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit subjekti sqaron se, siç rezulton nga akti i ekspertimit, referuar të ardhurave të dokumentuara dhe analizës së raportit të ardhura/shpenzime, rezulton se ka një balancë pozitive progresive në vlerën 18.434.071 lekë për vitin 2005, kohë në të cilën është blerë kjo pasuri. Në lidhje me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2005 apo në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk mund të konsiderohet “mosdeklarim” në kushtet kur kontrata e shitblerjes është lidhur ligjërisht nga bashkëshortja dhe është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Komisioni, sipas subjektit, duhet të mbajë parasysh se, nëse subjekti/personi i lidhur do të kishin pasur vullnetin për të mos deklaruar këtë pasuri, së pari, nuk do të kishin lidhur këtë kontratë shitje, në kushtet ku tashmë ajo zotërohej nga një anëtar i familjes me të cilin kishin marrëdhënie shumë të mira, dhe mund ta kishin gëzuar *de facto* atë pronë, pa asnjë shqetësim. Pra, transferimi i pronësisë së kësaj pasurie në favor të bashkëshortes është bërë me qëllim reflektimin e gjendjes faktike në dokumentacionin ligjor të pasurisë, për efekt korrektese dhe transparence, në përputhje me etikën si subjekt deklarimi. Pas regjistrimit të kësaj pasurie në regjistrin përkatës të pasurive të paluajtshme, nuk mund të mendohet ekzistenca e një tendence për mosdeklarimin e saj, si përpjekje për të fshehur pasurinë.

34.9. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se transaksionet e kryera mbi këtë pronë ofrojnë një situatë faktike e cila nuk duket se përputhet me vullnetin real të palëve të përfshira. Në kuptim të legjislacionit të zbatueshëm të rivlerësimit, subjektet kanë pasur detyrimin që në deklaratën e pasurisë *vetting* të deklaronin me vërtetësi dhe plotësi të gjitha pasuritë në pronësi dhe përdorim të tyre, të shoqëruara me dokumentacionin justifikues ligjor. Nëpërmjet kësaj deklarate, subjekteve iu dha mundësia edhe për të korrigjuar pasaktësitë në deklaratat periodike vjetore apo saktësimin e deklarimeve në to. Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting* janë të pabazuara dhe e vendosin atë në kushtet e deklarimit të pasaktë, dhe jo në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën 17.02.2005 – 08.04.2005 të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj më datë 08.04.2005, në vlerën (-) 90.173 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika

5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Reduktimi i balancës negative nga (-) 1.242.878 lekë e konstatuar nga Komisioni, në vlerën (-) 90.173 lekë, vjen për shkak të mospërfshirjes në këtë analizë, ndryshe nga Komisioni, të gjendjes së likuiditeteve të llogarive bankare të personit fizik “{\*\*\*}”, me emër tregtar “{\*\*\*}”, pasi ato i përkasin subjektit tregtar.

*B/3. Për pasurinë “njësi (dyqan) me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*

35. Komisioni, pasi ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet jetike, nga analiza financiare e rishikuar, i ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 2.145.290 lekë.
36. Subjekti i rivlerësimit, për të kundërshtuar këtë konkluzion, përpos shpjegimeve dhënë në Komision, ka pretenduar në ankim se: (i) Komisioni, pa asnjë argument arsyetues logjik, nuk ka marrë parasysh deklaratën e dhënë nga z. B. T. (ii) Në mënyrë të paarsyeshme dhe të paarsyetuar me argumente logjike në mënyrë shteruese, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë financiare asnjë prej të ardhurave që kanë shërbyer si burim, edhe pse rezultojnë të mbështetura në prova të cilat vetë Komisioni i ka administruar në dosje. (iii) Mënyra e trajtimit të këtij zëri të të ardhurave nga Komisioni është një nga shfaqjet më flagrante të arbitraritetit të përdorur për efekt të paragjyqimit të çështjes në rastin e subjektit, pasi në mënyrë tërësisht joprofesionale, i ka konsideruar të paqena provat e paraqitura, si vërtetimi i llogarisë bankare dhe vërtetimet e marra nga Ministria e Punëve të Jashtme, me argumentin se “[...] shumat e deklaruara si të ardhura nga ky punësim, mbeten në nivel deklarativ”.
37. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

37.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaron: “*Njësi shitje (dyqan), rr. ‘{\*\*\*}’, pall {\*\*\*}, nr. {\*\*\*}, Tiranë [...]. Burimi i financimit janë të ardhurat në vite deri në vitin 1999 nga paga, të ardhura nga veprimtari shoqërore, aktiviteti si ndërmjetëse në sigurime (agjente sigurimesh), të ardhura që do t’i paraqes në pjesën e të ardhurave me vërtetimet përkatëse. Vlera 2.000.000 lekë. Pjesa takuese 100 %*”.

37.2. Në deklaratën e pasurisë 2003, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur deklarojnë: “*Ambient zyre (agjenci), 50 m<sup>2</sup>, në vlerën 2 milionë lekë, pjesa takuese 50%, në rr. ‘{\*\*\*}’, Tiranë. Kontratë shitblerje me firmën ‘{\*\*\*}’ ShPK, viti 1999. Shfrytëzim vetjak*”. Në këtë deklaratë, subjekti deklaron se pronat e blera janë siguruar nga puna e përbashkët e tij dhe e bashkëshortes në Shqipëri dhe në Itali.

37.3. Kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.12.2000, me palë shitëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, dhe palë blerëse R. Zh., me objekt “dyqan” me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 20.000 USD, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Mënyra e likuidimit të çmimit të blerjes provohet nga mandatpagesa e datës 21.08.1999. R. Zh. ka paguar vlerën prej 15.000 USD; ndërsa me mandatpagesën e datës 07.10.1999, janë paguar 5.000 USD. Kjo pasuri figuron e regjistruar në

pronësi të znj. Zh., më datë 30.09.2009. Kjo pronë sipas subjektit është në huapërdorje<sup>37</sup> nga “{\*\*\*}”, me administratore R. Zh., që nga momenti i blerjes e në vazhdim.

37.4. Komisioni, në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të krijuar pasurinë “njësi” me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> me të ardhura nga burime të ligjshme, kreu analizën financiare për periudhën 01.09.1996, pra, pas ndërtimit të shtëpisë në rrugën “{\*\*\*}”, deri në fund të vitit 1999. Rezultatet e analizës treguan se subjekti dhe bashkëshortja kanë mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 2.383.998 lekë për blerjen e kësaj pasurie dhe i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën.

37.5. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, mes bashkëshortes dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK janë nënshkruar dy mandate për realizimin e pagesës për këtë pasuri, konkretisht mandatpagesa e datës 21.08.1999, për pagesën e këstit të parë 15.000 USD, si dhe një mandatpagesë tjetër e cila mban nr. {\*\*\*}, datë 07.10.1999, për shifrën 5.000 USD. Në këtë mandatpagesë, konstatohet shënimi i vendosur nga palët: *“Këto 5.000 \$ janë si shpërblim pune për objektin në tokën e B. T., deri me daljen e lejes. Në qoftë se nuk del leja e këtij pallati, ky mandat është i pavlefshëm”*. Subjekti shpjegon se bashkëshortja, për shkak të njohjes me z. B. T., i cili kishte në pronësi një truall me sipërfaqe 1.000 m<sup>2</sup> në zonën e “{\*\*\*}”, Tiranë, dhe pronarëve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, të cilët ishin të interesuar të realizonin një ndërtim mbi këtë pasuri, ishte ndërmjetëse, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje midis tyre. Për këtë ndërmjetësim, palët u dakordësuan për një shpërblim në shumën 5.000 dollarë amerikanë në favor të bashkëshortes, që do të jepej në eventualitetin e realizimit të ndërtimit. Duke qenë se shoqëria ndërtuese u pajis me lejen përkatëse dhe ndërtimi i pallatit u realizua, ky mandat e humbi fuqinë, sipas dakordësimit mes palëve, materializuar në shënimin e vendosur në mandat. Pra, sipas subjektit, për këtë pasuri është paguar efektivisht vlera 15.000 USD, konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të kohës në 2.000.000 lekë.

37.6. Në vijim të prapësimeve, subjekti i rivlerësimit depozitoi deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.04.2024 të z. B. T., i cili deklaroi se ka në pronësi pasurinë “truall” me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup>, në “{\*\*\*}” dhe, në vitin 1999, ka hyrë në bisedime me ndërtuesin R. H. nëpërmjet R. Zh. (K.), e cila ishte ndërmjetëse në këtë marrëdhënie. Deklaruesi shprehet se i ishte bërë me dije që ndërtuesi ishte i interesuar për të realizuar një ndërtim në pronën e tij. Pas zhvillimit të bisedimeve, sipas tij, kishin rënë dakord të lidhnin kontratën dhe, sipas lejes së ndërtimit, ndërtimi i pallatit u realizua sikurse palët ishin dakordësuar, vetëm për shkak të ndërmjetësimit të znj. R. Zh. (K.).

37.7. Sa i përket mundësisë financiare, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konstatimin e Komisionit, duke pretenduar se ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave, në masë të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie. Të ardhurat e përfshira në analizë nuk i përgjigjen gjendjes faktike, pasi sipas të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni financiar, deri në momentin e realizimit të pagesës në gusht 1999, ai dhe bashkëshortja kanë pasur të ardhura nga pagat, respektivisht subjekti 2.096.592 lekë dhe bashkëshortja në masën 1.453.062 lekë; të ardhura si ndërmjetëse në sigurime nga bashkëpunimi me {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, nga ku, deri

---

<sup>37</sup> Subjekti deklaroi se ka bashkëngjitur kontratë huapërdorje, por që nga verifikimi, nuk rezultoi të jetë paraqitur.

në muajin gusht 1999 janë gjeneruar të ardhura në vlerën 4.922.988 lekë<sup>38</sup>. Nga totali i të ardhurave, duke zbritur shpenzimet jetike dhe shpenzimin për efekt të servitutit të kalimit në vitin 1997, në total 183.887 lekë, rezulton një balancë pozitive, e cila mbulon tërësisht shpenzimin e mësipërm në vlerën 15.000 dollarë amerikanë.

37.8. Për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se nuk është depozituar një kontratë porosie apo sipërmarrjeje, mbi bazën e së cilës të jenë paguar vlerat 15.000 USD dhe 5.000 USD në vitin 1999, ndërkohë që kontrata e shitjes mban datën 22.12.2000. Si mandatpagesa e datës 21.08.1999 për shlyerjen e vlerës 15.000 USD, ashtu edhe mandatarkëtimi i datës 07.10.1999 për vlerën 5.000 USD, rezultojnë pa vullën e shoqërisë ndërtuese. Lidhur me vlerën provuese që subjekti i rivlerësimit pretendon për deklaratën noteriale të z. B. T., *së pari*, nuk rezulton që të jetë nënshkruar ndonjë kontratë ndërmjetësimi mes shoqërisë ndërtimore dhe znj. R. Zh., mbi të cilën të bazohej mandati për përfitimin nga kjo e fundit e vlerës 5.000 USD; *së dyti*, nuk është depozituar leja përkatëse e përfituar nga shoqëria ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK për ndërtimin e pallatit në pronën e z. T.; *së treti*, mes palëve kontraktore, shoqërisë dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, është nënshkruar kontrata e shitjes e datës 22.12.2000, në të cilën nuk rezulton të jetë pasqyruar pretendimi se për këtë pasuri është paguar gjithsej 15.000 USD, por në të përcaktohet 20.000 USD, vlerë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në kushtet kur një deklaratë noteriale është bërë vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit, dhe përmbajtja e së cilës nuk mbështetet nga dokumentacioni ligjor, kontratat e kohës kur është kryer transaksioni, atëherë nuk mund t’i atribuohet fuqi provuese ligjore për efekt të këtij procesi.

37.9. Sa i përket të ardhurave të pretenduara për krijimin e kësaj pasurie për periudhën 01.09.1996 – 1999, duke mos përfshirë të ardhurat si ndërmjetëse në sigurime të bashkëshortes, sipas arsytimit në vijim të këtij vendimi, trupit gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për këtë periudhë, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën (-) 1.935.166 lekë, për krijimin e pasurisë “njësi” deri më 07.10.1999, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Ndryshimi me analizën e kryer nga Komisioni për këtë pasuri konsiston në efektet e kurseve të këmbimit, pasi në Kolegj, pagesat e kryera në dollarë amerikanë janë konvertuar me kurset e këmbimit në datën e ekzekutimit të transaksionit, dhe jo me kursin e datës 31 dhjetor të çdo viti të aplikuar nga Komisioni.

*B/4. Për pasuritë “banesë” I (një) kat dhe “truall”, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*

38. Komisioni, lidhur me këto pasuri, ka arritur në konkluzionin se subjekti ka rezultuar me balancë negative në vlerën (-) 5.797.989 lekë për vitin 2003. Edhe në aktin e ekspertimit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime, viti 2003 rezulton me balancë negative në vlerën (-) 3.399.473 lekë.
39. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit me të njëjtin argument, duke iu referuar aktit të ekspertimit të kryer nga eksperti kontabël, me pretendimin se, deri në vitin 2003, rezulton një balancë pozitive progresive në vlerën 9.025.443 lekë. Po kështu, subjekti i

---

<sup>38</sup> Si shumatore të: 1.149.758 lekë për vitin 1996; 1.272.150 lekë për vitin 1997; 1.649.290 lekë për vitin 1998; 851.790 lekë deri në gusht 1999.

rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka injoruar dokumentet me fuqi të plotë provuese, kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.01.2003, dhe kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.05.2003.

40. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

40.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaroi: *“Banesë 1 kat + truall në rr. “{\*\*\*}”. Vërtetohet me kontratë shitblerje, vërtetim pronësie. Sqarohet se në kontratë është përdorur mbiemri ‘K.’, referuar letërnjoftimit që posedoja, por në dokumentet justifikuese është një kopje e certifikatës së martesës që vërteton mbiemrin. Burimi i krijimit: pagat ndër vite, aktiviteti si person fizik me NIPT {\*\*\*}, nga puna si ndërmjetëse në sigurime me kompaninë {\*\*\*} dhe {\*\*\*} ShA. Sqarohet që në kontratën e shitjes, çmimi total është 4.400.000 lekë (për të dyja pronat banesë + truall), por pjesa takuese e imja është 50%, rrjedhimisht, edhe pagesa është 50% e totalit. Vlera 2.200.000 lekë. Zotëroj 100 %”*. Kjo pasuri deklarohet për herë të parë në deklaratën e pasurisë të vitit 2003.

40.2. Nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep, nr. {\*\*\*} kol, datë 23.01.2003, pala shitëse M. K. i shet palës blerëse, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe znj. R. K., truall me sipërfaqe 250 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 400.000 lekë. Ndërsa, me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep, nr. {\*\*\*} kol, datë 23.05.2003, nënshkruar mes shitësve, A., F., S. dhe F. L., dhe palës blerëse, 1) shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga A. Ç. e F. S., si dhe 2) R. K., me ½ pjesë secili, është përfituar apartament i i ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, pallati {\*\*\*}, shk. {\*\*\*}, ap. {\*\*\*}, kati i parë, me sipërfaqe 74.30 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 4.000.000 lekë. Këto pasuri figurojnë të regjistruara në bashkëpronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe znj. R. K.

40.3. Në të njëjtën datë me blerjen e apartamentit më sipër, nënshkruhet kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.05.2003, mes palës së parë, znj. R. K., dhe palës së dytë, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga z. A. Ç., me objekt dhënien nga pala e parë e ½ pjesë të bashkëpronësisë së truallit me sipërfaqe 250 m<sup>2</sup>, si dhe të ½ pjesë të apartamentit të ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, me sipërfaqe 74.30 m<sup>2</sup>, me qëllim ndërtimin nga shoqëria të një godine banimi dhe ambiente shërbimi me shumë kate. Në përfundim të ndërtimit, shoqëria do t’i japë palës së parë, znj. R. K., 30% të sipërfaqes ndërtimore, e vendosur kjo proporcionalisht në të gjitha katet, *por në qoftë se kjo sipërfaqe është më e vogël se vlera prej 248.000 USD [...], atëherë shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, merr përsipër ta kompensojë atë në vlerën monetare ose sipërfaqe ndërtimore, diferencën e mbetur.*

40.4. Më datë 11.09.2015, rezulton që mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga ortaku z. F. S., pala e parë, dhe znj. R. K., pala e dytë, të jetë nënshkruar aktmarrëveshja nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., me objekt saktësimin e pasurive që pritet të përfitohen në bazë të kontratës së sipërmarrjes, të datës 23.05.2003. Në këtë aktmarrëveshje parashikohet se ortaku i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. F. S., është dakord që pala e dytë, znj. R. K., të përfitojë: (1) apartamentin nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe bruto 119.50 m<sup>2</sup>, sipërfaqe neto 106.70 m<sup>2</sup>, kati i 7 teknik; (2) apartamentin nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe bruto 119.50 m<sup>2</sup>, sipërfaqe neto 106.70 m<sup>2</sup>, kati i {\*\*\*} teknik, dhe (3) zyrë me sipërfaqe 54.7 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e brendshme 50 m<sup>2</sup>, kati {\*\*\*} teknik.

40.5. Mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga administratori A. Ç., dhe

pronarit të truallit, R. K. (Zh.), është nënshkruar aneks kontrate sipërmarrjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.12.2019, me objekt përcaktimin e pjesës takuese të palës pronare të truallit. Në funksion të qëllimit që ky aneks kontrate ka, shoqëria ndërtuese ka rënë dakord dhe angazhohet se do të realizojë për pronarët e truallit këto ambiente: (a) apartament nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe ndërtimi 117.71 m<sup>2</sup>, sipërfaqe neto 105.1 m<sup>2</sup>, në katin e {\*\*\*} teknik; (b) apartament nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 121.86 m<sup>2</sup>, sipërfaqe neto 108.8 m<sup>2</sup>, në katin e {\*\*\*} teknik; (c) si dhe dy poste parkimi me nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}.

40.6. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me kontratat nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.01.2003 dhe nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.05.2003, trupi gjykues arsyeton se objekt i shqyrtimit të tij është vendimi i Komisionit dhe konkluzionet përfundimtare të tij, dhe jo rezultatet e hetimit administrativ. Thënë ndryshe, në kushtet kur Komisioni, në konkluzion për këtë pasuri, ka marrë në konsideratë çmimin sipas këtyre kontratave, provon që nuk i ka injoruar ato siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Ndonëse Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ ka thelluar hetimin edhe në drejtim të mosmarrëveshjeve kontraktore dhe gjyqësore mes palëve, administratorit dhe ortakut të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me bashkëshorten e subjektit dhe, këtë të fundit, lidhur me pjesët takuese në kuadër të zhvillimit të pronës, trupi gjykues i konsideron ato pa rëndësi apo ndikim ligjor në vendimmarrjen e tij. Pavarësisht se vlerëson që në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte situatën faktike ligjore lidhur me zhvillimin e pronës, përkatësisht kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.05.2003 dhe aktmarrëveshjen nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.09.2015, trupi gjykues e fokusoi analizën e tij në drejtim të verifikimit të mundësisë financiare për krijimin e pasurisë në vitin 2003.

40.7. Lidhur me analizimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të krijuar këto pasuri, Komisioni në vendim ka konstatuar balancën negative (-) 5.797.989 lekë për gjithë vitin 2003, në kushtet që në këtë vit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar edhe pasurinë në {\*\*\*}, Kavajë, pa e specifikuar pamjaftueshmërinë për secilën pasuri. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën 01.01.2003 – 23.05.2003, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 2.306.696 lekë për të justifikuar krijimin e këtyre pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*B/4.1. Lidhur me shumën 30.000 euro, të deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2006*

41. Komisioni, në vendim ka konkluduar se: -- subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me përfitimin e shumës 30.000 euro. Mosdeklarimi i kësaj shume nuk konsiderohet i paqëllimtë apo një lapsus, por është vazhde e së njëjtës sjelljeje që ka lidhje me mosdeklarimin e dy marrëveshjeve të lidhura me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK; -- Arsyeja e përfitimit të kësaj shume, për lejimin e ndërtimit, pa respektuar distancat urbanistike ngjitur me pronën e tyre, është e pakuptimtë, pasi kjo pronë ishte në bashkëpronësi me shoqërinë. Pretendimi mbi arsyet e përfitimit të shumës 30.000 euro, përveçse i paprovuar dhe i palogjikshëm, tregon përfitimin nga lejimi i një paligjshmërie; -- marrja e vërtetimeve nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të provuar se z. G. G. ka qenë i punësuar pranë shoqërisë, për të provuar ligjshmërinë e përfitimit të shumës 30.000 euro, vlerësohet irelevante; --

Komisioni nuk e ka konsideruar këtë shumë si të ardhur të ligjshme, pasi as nga marrëveshjet, as nga informacioni i shoqërisë, nuk konfirmohet përfitimi i kësaj vlere.

42. Subjekti i rivlerësimit, përpos pretendimeve të paraqitura në Komision, ka ngritur këto shkaqe ankimore: (i) Mosmarrja në konsideratë e vlerës 30.000 euro nga Komisioni përbën ose një keqkuptim të qëllimshëm, ose një moskuptim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me arsyen e përfitimit të saj. (ii) Ndryshe nga sa pretendon Komisioni, kjo shumë nuk është paguar për zhvillimin e pronës që bashkëshortja kishte blerë me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, por është paguar në formë kompensimi financiar për lejimin e një ndërtimi tjetër, në kufi me pronën e përbashkët të të dy subjekteve. (iii) Ajo që Komisioni është përpjekur të bëjë, duke e trajtuar marrëdhënien e kompensimit si një absurd logjik, është në fakt një marrëdhënie e zakonshme juridike, në të cilën bashkëshortja ka përfituar një kompensim financiar për të lejuar një ndërtim kufitar me pronën e saj. (iv) Mandati prej 10.000 eurosh nuk është bërë i mundur të gjendet, ekzistenca e tij nuk mund të provohet fizikisht, por duhet të prezumohet nga vlerësimi kompleks dhe harmonik i provave të tjera (dëshmia pranë ILDKPKI-së dhe deklarimi në deklaratën vjetore të vitit përkatës).
43. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

43.1. Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Të ardhura nga shitja e ap. banimi mbi truall ndërtimi, pronë e familjes, ndërtim pjesor. Vlera 30.000 euro”*, e cila nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në vitin 2009, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, i pyetur për këtë fakt, subjekti ka deklaruar se: *“Nuk kemi shitur pjesë të shtëpisë së deklaruar në rr. ‘{\*\*\*}’, por i kemi dhënë miratimin firmës së ndërtimit për të ndërtuar një pallat, ngjitur me shtëpinë tonë. Si të thuash i bëmë një favor firmës së ndërtimit sepse ndërtimi ishte ngjitur me pronën tonë dhe shkelte kushtet e urbanistikës. Për këtë, përfituam të ardhura nga firma, shumën 30.000 euro”*.

43.2. Komisioni, në pyetësin nr. 3, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime mbi mosdeklarimin e këtyre të ardhurave në deklaratën e pasurisë *vetting*, informacion se nga cili e ka përfituar vlerën 30.000 euro të provuar me dokument ligjor, si dhe pagesën e tatimit për këtë të ardhur. Në përgjigjet e këtij pyetësi, subjekti shpjegon se kjo shumë nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, për shkak të harresës dhe mungesës së kujdesit në kontrollin e detajuar të deklarimeve periodike. Kjo e ardhur, sipas tij, vjen si rrjedhojë e pronësisë mbi truallin dhe banesën në rrugën “{\*\*\*}”, të lidhur në kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, nga viti 2003. Subjekti shpjegon gjithashtu se për këtë të ardhur ka dhënë shpjegime në ILDKPKI në vitin 2009, se kjo shumë është përfituar si rrjedhojë e aprovimit për të lejuar këtë shoqëri të ndërtonte një pallat ngjitur me pronën e tyre, dhe në kushtet kur projekti i pallatit nuk dispononte asnjë njësi ndërtimore me sipërfaqe në këtë vlerë, u dakordësuan për kompensimin në vlerën monetare prej 30.000 eurosh. Likuidimi i kësaj shume, sipas subjektit, është bërë në *cash* nga shoqëria ndërtimore nëpërmjet dy mandatpagesave, nga të cilat, mandatin në vlerën 10.000 euro nuk e disponon, pasi edhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, përcaktonte se dokumentacioni i detyrueshëm për efekt të kontrollit tatimor ruhet deri në 5 vjet, ndërsa paraqet mandatin e dytë në vlerën 20.000 euro. Lidhur me pagesën e tatimit, subjekti ka sqaruar se referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, tatimi për këto pagesa të ardhurash mbahet në burim.

Mandatpagesa e datës 19.12.2006, në të cilin urdhërohet pagesa 20.000 euro për znj. R. K., me përshkrimin: *“likuidim total për kthim apartamenti”*, rezulton të jetë nënshkruar nga drejtori G. G., por nuk përmban as numër, dhe as vulë të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

43.3. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni është shprehur se ky mandat është firmosur nga drejtori G. G., pra, nuk provohet që ky mandat të jetë dokument si i lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, dhe as nuk është konfirmuar prej saj. Komisioni nuk i mori në konsideratë të ardhurat e pretenduara në vlerën 30.000 euro, pasi nuk provohet me dokument marrëdhënia juridike për përfitimin e kësaj vlere, si dhe nuk provohet pagesa e tatimit mbi të. Në këto kushte, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit, se ai dhe bashkëshortja, në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk kanë deklaruar të ardhurat prej 30.000 eurosh, të pretenduara si të përfituara nga kjo shoqëri, si dhe mbetet e paprovuar dhe e paqartë origjina/ligjshmëria e kësaj vlere.

43.4. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

43.4.1. Në vitin 2006, sipas një marrëveshjeje verbale në kuadër të marrëdhënies miqësore që kishin në atë kohë me ortakët e shoqërisë ndërtuese, bashkëpronare në këto pasuri, kanë rënë dakord që, nga ana e tyre të jepej vlere 30.000 euro, për shkak të dhënies së pëlqimit për të lejuar këtë shoqëri të realizonte një ndërtim ngjitur me pronën e tyre, pa respektuar kufizimet ligjore për mbajtjen e distancave minimale, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 722, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e rregullores së urbanistikës”*, i ndryshuar. Dhënia e pëlqimit ishte një ndër elementet thelbësore që i hapi rrugë shoqërisë ndërtuese për t’u pajisur me lejet e nevojshme për realizimin e ndërtimit. Përpos sa sqaruar në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, lidhur me arsyen e përfitimit të vlerës 30.000 euro, subjekti shpjegon se mandatpagesa për vlerën 10.000 euro nuk është mundur të gjendet, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, dhe se në vitin 2006, nuk ka qenë e nevojshme, sipas ligjit nr. 9049/2003, paraqitja e dokumentacionit provues, arsye se përse mandatet nuk janë depozituar në ILDKPKI në kohën e deklarimit të kësaj shume, dhe as nuk janë kërkuar ndonjëherë prej saj.

43.4.2. Në kushtet kur edhe në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2009 është deklaruar në këtë mënyrë, sipas subjektit të rivlerësimit, duhet të mbahet në konsideratë dhe të zbatohet vlere juridike e procesverbalit si dokument zyrtar i hartuar nga një organ i përcaktuar me ligj, të cilit Kolegji i ka dedikuar një rol thelbësor provues në vendimin nr. 37/2021 (JR), datë 24.11.2021, paragrafi 10.21, duke e konsideruar si dokument me efekt të plotë provues. Subjekti i rivlerësimit sqaron se z. G. G. ka menaxhuar çështjet financiare të kësaj shoqërie, dhe kjo cilësi mund të verifikohet lehtësisht duke marrë të dhënat për pagimin e sigurimeve shoqërore për të nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Subjekti ka paraqitur kërkesë procedurale për ndërhyrjen në marrjen e informacionit pranë ISSh-së, me qëllim vërtetimin se G. G. ka qenë punonjës pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Në përgjigje të kësaj kërkesë të paraqitur, është marrë vendimi i ndërmjetëm (i paarsyetuar), i datës 27.03.2024, në të cilin përcaktohet se: *“Nuk është vënë ndonjëherë në dyshim apo të jetë ngritur ndonjë problematikë në lidhje me faktin që shtetasi G. G. ka qenë ose jo punonjës i shoqërisë ‘{\*\*\*}’ ShPK, për rrjedhojë, vërtetimi i këtij fakti nuk do të sillte ndonjë risi për procesin e rivlerësimit”*.

43.4.3. Sa i përket pagesës së tatimit për këtë shumë të përfituar konform legjislacionit në fuqi në kohën e kryerjes së transaksionit, konkretisht ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pagimi i tatimit në burim për shumat e përfituara nga shoqëritë tregtare si në rastin konkret, i ngarkohej pikërisht shoqërive. Në nenin 33 të këtij ligji, parashikohet se: *“Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, [...] c) pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet e konsulencës, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit”,* si dhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 të Ministrisë së Financave parashikohet: *“Në zbatim të nenit 33 të ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës, jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa”.*

43.5. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar ndërtimin e objektit tjetër ngjitur me pronën e tyre, me ankimin depozitoi leje ndërtimi – formulari nr. 4, me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.01.2005, dhe vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.05.2005 të KRrT-së, Bashkia Tiranë, për leje ndërtimi në favor të subjektit ndërtues “{\*\*\*}” ShPK, që, referuar ekstraktit historik të shoqërisë, në atë periudhë ka qenë administruar dhe zotëruar ashtu si shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, nga A. Ç. e F. S., me 50% të kuotave secili.

43.6. Në ndryshim nga Komisioni, që ka renditur disa arsye për moskonsiderimin të ligjshme të vlerës 30.000 euro, trupi gjykues ndan mendim ndryshe sa i përket *lejimit të paligjshmërisë* nga subjekti në ndërtimin e objektit, pa respektuar distancat minimale, pasi kompetenca për të vendosur mbi respektimin e kondicioneve urbanistike dhe miratimi i lejes së ndërtimit i përket organeve të qeverisjes vendore, që bazuar në vlerësimet përkatëse dhe karakteristikat urbanistike të ndërtimit (për shembull, një faqe e ndërtimit kallkan), lëshon lejet përkatëse. Thënë ndryshe, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur të kenë lejuar veprime të paligjshme, pasi referuar kuadrit ligjor të fushës së ndërtimit dhe marrëveshjes me pronarët e truallit, mund të përcaktohen kondicionet teknike, të parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm.

43.7. Nga ana tjetër, ashtu si Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi të mos përfshijë në mesin e të ardhurave të ligjshme vlerën 30.000 euro, të deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2006, për shkak të: (i) mungesës së dokumentacionit ligjor për vërtetimin e marrëdhënies juridike me shoqërinë ndërtuese (marrëveshje/kontratë), duke e lënë të paqartë dhe të paprovuar ligjshmërinë e kësaj shume; (ii) kjo shumë nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, nga aktet në dosjen gjyqësore, të tilla si materialet e dërguara nga shoqëria ndërtimore në Komision, komunikimet e realizuara mes bashkëshortes së subjektit dhe administratorit/ortakut të shoqërisë, nuk konfirmohet marrja e kësaj vlere; (iii) mandatpagesa prej 20.000 USD, pa numër dhe pa vulën e shoqërisë, nuk plotëson kriteret/kushtet për t’u konsideruar e besueshme dhe nuk mbështetet në asnjë akt ligjor. Në këto rrethana, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për t’i dhënë fuqi provuese procesverbalit të ILDKPKI-së për vitin 2009, gjendet i pabazuar. Sa më sipër, trupi gjykues, në kontrollin e analizës financiare të Komisionit, nuk ka përfshirë si të ardhura të ligjshme për vitin 2006, vlerën 30.000 euro.

*B/5. Për pasurinë “banesë” në {\*\*\*}, fshati i “{\*\*\*}”*

44. Komisioni në vendim, sa i takon vlerës së pasurisë, ka arsyetuar se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që diferenca në çmim ka ardhur si pasojë e një marrëveshjeje me shoqërinë ndërtuese, duke qenë se një pjesë e punimeve do të kryheshin nga vetë porositësit, nuk qëndron, pasi subjekti nuk ka depozituar asnjë marrëveshje me shoqërinë, ku të pasqyrohen pretendimet e tij. Pavarësisht deklarimit për kryerjen e punimeve të brendshme prej tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka përfshirë në analizën e kryer asnjë shumë të shpenzuar për sa ka pretenduar, pavarësisht detyrimit për deklarim ose jo.

Komisioni e ka konsideruar të pabesueshëm pretendimin e subjektit se për deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.12.2005, nuk ka qenë më parë në dijeni dhe nuk duhet marrë në konsideratë nga Komisioni, në kushtet kur kjo deklaratë ndodhet në dosjen e ALUIZNI-t dhe procedurat e legalizimit / regjistrimit janë kryer nga bashkëshortja e subjektit. Në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi se nuk kanë pasur më asnjë detyrim për të paguar shumën 6.000 euro, pasi regjistrimi është bërë prej tyre, duke pranuar faktin se në një moment të caktuar, ky detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese ka ekzistuar, por për shkak të procedurave të legalizimit të ndjekura nga bashkëshortja, ky detyrim është shuar. Nga deklaratimet e vetë subjektit në prapësime, përforcohet vërtetësia e deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.12.2005, në të cilën deklarohet se bashkëshortja e tij ka paguar 54.000 euro. Fakt tjetër që e bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit është se nga aktet në dosjen e regjistrimit të kësaj pasurie, si kontrata e sipërmarrjes datë 23.06.2003, ashtu edhe deklarata noteriale datë 19.12.2005, janë vërtetuar si të njëjta me origjinalin, në të njëjtin vërtetim të noteres M. Ll., me nr. {\*\*\*} rep., datë 12.08.2010. Ndërkohë, vërehet se subjekti, këtë deklaratë, nga njëra anë përpiket ta paraqesë si veprim të njëanshëm, pra, duke e pranuar ekzistencën e saj, nga ana tjetër përpiket ta paraqesë sikur kjo deklaratë nuk ekziston në regjistrin e noteres. Gjithashtu, subjekti nuk e kundërshton vërtetimin e noteres me nr. {\*\*\*} rep., datë 12.08.2010, në të cilin pasqyrohet fakti se vetë subjekti është paraqitur për njësimin e deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.12.2005. Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë që ka pasur burime të ligjshme për pagesën e kësteve prej 33.000 eurosh në vitin 2003, pasi edhe nga analiza e rishikuar financiare, subjekti rezultoi me balancë negative për vitin 2003, në vlerën (-) 5.797.989 lekë.

45. Subjekti i rivlerësimit në ankim kundërshton konkluzionet e Komisionit, me pretendimet se: (i) Arsyetimi i Komisionit në lidhje me punimet e brendshme dhe mobilimin është thellësisht kontradiktor dhe jo profesional, pasi pavarësisht se nga njëra anë pranon faktin që subjekti nuk ka pasur detyrim të deklarojë deri në vitin 2012 investime më të vogla se 5.000 euro, nga ana tjetër shprehet se ky i fundit duhet të kishte deklaruar “vlerën e pronës”, ndërkohë që me këtë term kuptohet vetëm vlera e pasurisë së paluajtshme, si dhe të dhënat në lidhje me të dhe jo shpenzimet e kryera në funksion të saj. (ii) Komisioni ka marrë në konsideratë një deklaratë noteriale (të prezumuar) me nr. {\*\*\*} rep., datë 19.12.2005, e cila pretendohet të jetë lëshuar nga deklaruesit, F. M. dhe përfaqësuesi i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. I. O., të cilët, në mënyrë të njëanshme, deklarojnë se kanë marrë prej bashkëshortes vlerën 54.000 euro dhe deklarojnë se detyrimi i mbetur 6.000 euro do të paguhet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë. Në lidhje me këtë konstatim, për të cilin është kaluar në mënyrë të paligjshme barra e provës bazuar mbi një akt të falsifikuar, në kundërshtim me provat e plota shkresore, subjekti

ka ardhur në dijeni në momentin e pajisjes me një kopje të dokumentacionit, e ndodhur në praktikën e dokumenteve për pasurinë në fjalë, pranë zyrës së noteres. (iii) Ky dokument duhet të konsiderohet si një akt i njëanshëm që përmban një numër dhe datë të cilat nuk i përgjigjen asnjë regjistrimi në regjistrin e akteve dhe veprimeve noteriale të noteres para së cilës supozohet të jetë bërë. Në këto kushte, ai nuk duhet të ishte marrë në konsideratë nga Komisioni, dhe në analizën financiare duhet të përfshihej vlera reale e paguar prej 43.000 eurosh, e deklaruar në deklarin periodik vjetor 2004 pranë ILDKPKI-së, që, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016 përbën provë, e cila, në përputhje edhe me praktikën e konsoliduar të Kolegjit, ka fuqi të plotë provuese. (iv) Komisioni ka dhunuar në mënyrë flagrante procesin, duke mos e marrë në konsideratë dhe duke mos e përmendur në arsyetimin e vendimit provën e falsifikimit (deklaratën e korrigjuar të noteres), e cila hidhte poshtë konstatimet e Komisionit dhe shkakun e kalimit të barrës së provës ndaj subjektit të rivlerësimit. (v) Në kundërshtim me gjetjet e Komisionit dhe fakteve të konsideruara prej tij për efekt të analizës financiare, nga kontratat e sipërcituara dhe deklaratat respektive të subjektit ndërtues, rezulton tërësisht e provuar se vlera totale e paguar është 43.000 euro.

46. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

46.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Banesë në {\*\*\*}, Kavajë, fshati “{\*\*\*}”, me vlerë 43.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat e biznesit dhe ndërmjetësimit me sigurime. Sqaroj që vërtetimi për të ardhurat nga ndërmjetësimi në sigurime janë nga {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, dhe jo nga organet tatimore, pasi tatimi mbahej në burim. Dokumente shoqërues: vërtetimi i pronësisë dhe vërtetimi i pagesës nga sipërmarrësi, i noterizuar”.*

46.2. Kjo pasuri rezulton të jetë porositur nga znj. R. K. përmes kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.06.2003, nënshkruar së bashku me investitorin dhe pronarin e truallit F. M., dhe shoqërinë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga ortaku i vetëm I. O., me objekt ndërtimin në fshatin turistik {\*\*\*}, Kavajë, e një vile dykatëshe, me sipërfaqe ndërtimore 50 m<sup>2</sup> secili kat dhe 300 m<sup>2</sup> truall i shfrytëzueshëm, kundrejt vlerës 55.000 euro. Kjo vlerë është parashikuar të likuidohet: (i) në datën e lidhjes së kontratës 11.000 euro; (ii) në mbarim të punimeve të muraturës do të likuidohet 40% e vlerës totale, 22.000 euro, ndërsa (iii) likuidimi i pjesës tjetër do të bëhet me marrëveshjen e të dy palëve, pa kaluar afatin e përcaktuar. Punimet në objekt kanë filluar dhe dorëzimi i objektit i përfunduar me çelësa në dorë do të bëhet në datën 1 maj 2004 dhe, mbas kësaj date, për çdo muaj vonesë, sipërmarrësi i paguan porositësit 1% të vlerës totale të vilës.

46.3. Në deklaratën e pasurisë 2003, nuk është deklaruar prenotimi i kësaj pasurie nga subjekti apo bashkëshortja, ndërsa në deklaratën periodike vjetore 2004, bashkëshortja ka deklaruar: “*Prenotim i një banese në Plazh, Durrës, në vlerën 43 mijë euro. Pjesa takuese 100%. Data e krijimit të pasurisë: gjatë 2004, me këste”.*

46.4. Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 04.08.2004, të ortakut të vetëm dhe administratorit të shoqërisë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK, z. I. O., i cili deklaron se ka marrë në dorëzim nga znj. R. K. vlerën 43.000 euro, pagesë e cila është bërë nga ana e saj për blerjen e një vile në {\*\*\*}, Durrës, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 23.06.2003.

46.5. Nga dokumentacioni i përcjellë pranë ILDKPKI-së nga ZVRPP Kavajë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.09.2017, rezulton të jetë administruar edhe një deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.12.2005 e deklaruesve F. M. dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga z. I. O., të cilët deklarojnë se kanë nënshkruar një kontratë sipërmarrje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.06.2003, sipas së cilës znj. R. K. ka porositur një vilë në fshatin turistik në {\*\*\*}, Kavajë, ndërtim i realizuar nga shoqëria “{\*\*\*}”, me investitor z. F. M. Ata deklarojnë se kanë marrë në dorëzim nga znj. K. vlerën gjithsej 54.000 euro dhe mbetet për t’u paguar vlera 6.000 euro, e cila do të likuidohet me dorëzimin e dokumenteve të pronësisë nga ZRPP Kavajë, në emër të porositëses.

46.6. Kjo pasuri rezulton t’i jetë nënshtruar më pas procesit të legalizimit pranë ALUIZNI-t, me të cilin znj. R. Zh., në cilësinë e blerëses ka nënshkruar kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.01.2013, për kalimin në pronësi të truallit me sipërfaqe prej 310.56 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e bazës së njësisë 67.31 m<sup>2</sup>, për të cilat ka paguar vlerën e shitjes së truallit me zonën e stimuluar, në shumën 347.082 lekë, dhe tarifën e përditësimit të pronës, në vlerën 9.317 lekë. Në përfundim të procedurave, është lëshuar leje legalizimi nr. {\*\*\*}, datë 01.03.2013, për objektin banesë 2 kate, me adresë “Zona e stimuluar ‘F. M.’, {\*\*\*}, {\*\*\*}, Kavajë”, me sipërfaqe parcele ndërtimore 310.56 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 67.31 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale ndërtimi për banim 134.62 m<sup>2</sup>.

46.7. Në kushtet kur çmimi i blerjes përcaktohet i ndryshëm, pra, në kontratën e sipërmarrjes 55.000 euro, në deklaratën e pasurisë *vetting* 43.000 euro, dhe në deklaratën noteriale të datës 19.12.2005, në vlerën 60.000 euro, me pyetësin nr. 2, Komisioni, ndër të tjera, i kërkon shpjegime dhe dokumentacion provues subjektit të rivlerësimit mbi çmimin e saktë, mospërputhjet e konstatuara, mënyrën e likuidimit të çmimit, kontratën përfundimtare të shitjes së kësaj pasurie, mbi bazën e së cilës është bërë dhe regjistrimi, si dhe gjendjen juridike aktuale dhe përdorimin e kësaj pasurie.

46.8. Në përgjigjet e këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit sqaron se në deklaratën noteriale të datës 04.08.2004, janë bashkëlidhur edhe vërtetimet e pagesave të firmosura në momentin e pagesës fizike nga bashkëshortja R. Zh. dhe I. O., totali i paguar është ai i deklaruar prej 43.000 eurosh. Diferencën midis vlerës në kontratën e sipërmarrjes dhe asaj në deklaratën noteriale, subjekti i rivlerësimit e justifikon si rezultat të disa elementeve të rifiniturave, vetratat, materialeve hidrosanitare etj., të cilët nuk u pëlqyen nga porositësit dhe, në mirëkuptim me administratorin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, u vendos që vlerat e tyre do të zbriteshin nga çmimi i dakordësuar në kontratën e sipërmarrjes. Në përfundim, sipas subjektit, mbeteshin vetëm 6.000 euro për t’u paguar kur të merrnin në dorëzim nga shoqëria dokumentet e pronësisë lëshuar nga ZVRPP-ja. Me kalimin e viteve, nga shoqëria nuk u krye asnjë hap për të mundësuar regjistrimin dhe dorëzimin e certifikatës së pronësisë. Me daljen e ligjit nr. 10186, datë 05.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, bashkëshortja ndoqi procedurën për legalizimin e pronës nëpërmjet ALUIZNI-t.

46.9. Në vijim, subjekti i rivlerësimit sqaron se të gjitha shpenzimet për blerjen e truallit (që ishte parashikuar në kontratën e sipërmarrjes si pjesë e çmimit të dakordësuar me shoqërinë) u paguan nga bashkëshortja, si dhe çdo tarifë tjetër e shpenzim dhe, në këto kushte, detyrimi ndaj shoqërisë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK u zerua, pasi procedura dhe të gjithë shpenzimet e legalizimit

u përballuan plotësisht nga bashkëshortja, në cilësinë e blerësit. Subjekti i rivlerësimit sqaron se, për të verifikuar deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., datë 19.12.2005, bashkëshortja iu drejtua noteres M. Ll., e cila i ka konfirmuar se në këtë numër repertori rezulton i regjistruar një shërbim për shoqërinë “{\*\*\*}” ShA<sup>39</sup>. Shuma e përcaktuar në këtë deklaratë, sipas subjektit, nuk përputhet me atë në kontratën e sipërmarrjes, në të cilën është saktësuar vlera 55.000 euro. Nga bashkëshortja janë ruajtur ndër vite vërtetimet e pagesave, për vetë faktin se ende nuk kishin mbaruar procedurat e marrjes në pronësi. Bashkëshortja nuk disponon vërtetime të tjera pagese përveç atyre, në total 43.000 euro.

**46.10.** Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i kërkon subjektit të rivlerësimit shpjegime mbi vlerën e paguar për materialet e zëvendësuara, si pllaka, hidrosanitare, vettratat etj., duke e provuar me dokumentacion ligjor këtë vlerë. Në përgjigje, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit sqaroi se, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk disponon dokumentacion dhe as nuk mund të kërkojë njësitë në zonën e {\*\*\*}, pasi janë bërë ndryshime të mëdha urbanistike. Sipas tij, kishin detyrim për deklarimin e shpenzimeve me vlerë mbi 500.000 lekë dhe, blerja e pllakave në vitet 2003/2004 nuk e plotësonte këtë kusht, duke marrë në konsideratë se çmimi për m<sup>2</sup> i cilësisë më të lartë ishte 1.400 lek/m<sup>2</sup>, pra, në total 115.000 lekë. Të njëjtit arsytim i përmbahet edhe për sa i përket shpenzimeve për dyert dhe dritaret. Sipas tij, referuar statistikave për vitet 2003 – 2004, çmimi i ndërtimit varionte nga 350 në 500 euro/m<sup>2</sup>, pikërisht për çmimet shumë të lira të punimeve dhe materialeve të tyre.

**46.11.** Për të verifikuar mundësinë financiare për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni konsideroi në analizë vlerën 54.000 euro të paguar për blerjen e saj, respektivisht: (i) 33.000 euro në vitin 2003, nisur nga vërtetimet e nënshkruara nga I. O. dhe R. K., depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit nr. 2<sup>40</sup>; (ii) diferencën 10.000 euro në vitin 2004, nisur nga deklarimi në deklaratën e interesave privatë 2004 se vlera e saj është 43.000 euro; (iii) ndërsa diferencën prej 11.000 eurosh, të paguar në datën 19.12.2005, nisur nga deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep. e kësaj date, e administruar në dosjen e regjistrimit në ZVRPP; (iv) 347.082 lekë të paguar më datë 23.03.2012 për blerjen e truallit nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tiranë, sipas dokumentit bankar dhe kontratës së shitjes. Komisioni konstatoi se burimi i deklaruar “ndërmjetësimi me sigurime”, mbetet i paprovuar dhe, si i tillë, nuk mund të ketë shërbyer si një burim i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie. Ndërsa, në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i “agjencisë së udhëtimit”, këto të ardhura për vitin 2003 kanë rezultuar në vlerën 600.000 lekë, të pamjaftueshme për të mbuluar pagesën e kryer në këtë vit, në një total prej 33.000 eurosh ose 4.410.450 lekë. Në përfundim, analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për vitin 2003 ka

---

<sup>39</sup> Me prapësimet, subjekti depoziton kërkesën drejtuar noteres M. Ll. për t’u pajisur me një kopje të njësuar me origjinalin të aktit “Deklaratë noteriale” nr. {\*\*\*} rep., datë 19.12.2005, me deklarues z. F. M. dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga z. I. O., si dhe kopje të njësuar me origjinalin të fletës së regjistrit ku të rezultojnë nënshkruesit e aktit të sipërcituar. Në përgjigjen e datës 03.04.2024, noterja vë në dispozicion fletën e regjistrit vetëm për këtë numër.

<sup>40</sup> Vërtetime të thjeshta, pa logon e shoqërisë, të nënshkruara nga I. O. dhe R. K., në të cilat z. O. vërteton pagesat e kryera nga bashkëshortja e subjektit, konkretisht: -- vërtetim, datë 15.09.2003, marrë në dorëzim shuma 22.000 euro (kësti i parë 11.000 euro, kësti i dytë, 5.000 euro, kësti i tretë, 6.000 euro); -- vërtetim, datë 20.11.2003, për marrjen në dorëzim të vlerës 5.000 euro, si këst për pagesën e vilës, z. I. O.; -- vërtetim datë 30.12.2003, për marrjen në dorëzim të vlerës 6.000 euro si këst pagese për objektin “vilë” në {\*\*\*}; -- vërtetim i datës 16.02.2004, për pagesën e vlerës 7.000 euro. Në total, janë paguar 40.000 euro.

rezultuar me një balancë negative prej (-) 11.228.629 lekësh. Për vitin 2004, të ardhurat nga aktiviteti i agjencisë së udhëtimit, të përlllogaritura nga Komisioni në vlerën 1.200.000 lekë, janë të mjaftueshme për të mbuluar vlerën 10.000 euro të paguar në vitin 2004. Edhe për vitin 2005, të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes në vlerën 2.000.000 lekë janë të mjaftueshme për të paguar vlerën 11.000 euro ose 1.347.940 lekë si pjesë e çmimit të vilës. Në përfundim, duket se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme për pagesat e kryera në vitin 2003 për banesën në {\*\*\*}.

**46.12.** Me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës lidhur me konstatimet se: (i) bashkëshortja, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo të plotë të sipërfaqes së ndërtimit, si dhe ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës, ashtu si dhe gjatë procesit, e cila, nga aktet shkresore, rezultoi në vlerën 54.000 euro; (ii) ka mungesë burimesh për pagesën e kësteve, në shumën totale prej 33.000 eurosh ose 4.410.450 lekë në vitin 2003, pasi për këtë vit, analiza financiare ka rezultuar me një balancë negative prej 11.228.629 lekësh.

**46.13.** Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se pagesa për këtë pasuri është bërë me këste në këtë mënyrë: (i) deri në datën 15.09.2003, është paguar në favor të sipërmarrësit vlera prej 22.000 eurosh, në tri këste, respektivisht 11.000 euro, 5.000 euro dhe 6.000 euro; (ii) në datën 20.11.2003, është paguar vlera 5.000 euro; (iii) në datën 30.12.2003, është paguar vlera 6.000 euro; (iv) në datën 16.02.2004, është paguar në favor të sipërmarrësit vlera prej 7.000 eurosh. Me deklaratën noteriale të datës 04.08.2004, përfaqësuesi i shoqërisë sipërmarrëse “{\*\*\*}” ShPK ka deklaruar se ka marrë në total në dorëzim nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit vlerën 43.000 euro, për efekt të kontratës së sipërmarrjes të datës 23.06.2003. Në kushtet kur procesi i regjistrimit të pasurisë u krye si pasojë e procesit të legalizimit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur asnjë detyrim ndaj sipërmarrësit për të paguar në favor të tij vlerën 6.000 euro, duke qenë se dokumentacioni ligjor u përfundua nëpërmjet një procedure tjetër, të ndryshme nga ajo e dakordësuar në kontratë.

**46.14.** Subjekti i rivlerësimit, në vijim të prapësimeve ka shpjeguar se ai dhe bashkëshortja nuk kanë qenë më parë në dijeni të kësaj deklarate, por janë njohur në momentin që janë pajisur me një kopje të dokumentacionit të ndodhur në praktikën e akteve për pasurinë e tyre, në zyrën e noteres, e cila, pas interesimit dhe komunikimit shkresor, u ka vënë në dispozicion fletën e regjistrimit noterial të vitit 2005, i cili mbyllet në datën 31.12.2005 dhe në nr. {\*\*\*} repertori, figuron i regjistruar një akt noterial i shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, dhe vendim asambleje. Deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., e datës 19.12.2005, sipas subjektit, konsiderohet një akt i njëanshëm e që përmban ekstremitete që nuk i përgjigjen asnjë regjistrimi në regjistrin e akteve dhe veprimeve noteriale të noteres përpara së cilës supozohet të jetë bërë. Në këto kushte, subjekti ka kërkuar që vlera reale e paguar të konsiderohet ajo prej 43.000 eurosh, e deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2004 që, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përbën provë. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në datën 20.05.2004 kanë marrë në dorëzim dhe kanë poseduar këtë pronë. Të gjitha veprimet juridike (kontrata, deklarata etj.) janë lidhur me bashkëshorten, ndërsa deklarata noteriale e datës 19.12.2005 ka qenë e njëanshme, nga e cila nuk mund të rrjedhin të drejta apo detyrime për subjektin apo bashkëshorten, për sa kohë nuk janë palë nënshkruese të saj. Subjekti vlerëson se nuk mund të ngarkohet me barrë prove mbi

përmbajtjen e saj, pasi nga kontratat dhe deklaratat respektive, rezulton tërësisht e provuar se shuma e paguar është në vlerën 43.000 euro.

46.15. Lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, subjekti pretendon se ato janë të ardhura të ligjshme, pasi burojnë nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes, i cili, deri në vitin 2003 kur janë paguar 33.000 euro, ka gjeneruar të ardhura, në masë të tillë që rezulton viti kalendarik me një balancë progresive pozitive në vlerën 9.025.443 lekë. Ndërkohë, për vitin kalendarik 2004, në të cilin është paguar edhe vlera prej 10.000 eurosh, rezulton një balancë progresive pozitive prej 13.444.079 lekësh. Për këto rezultate, subjekti i rivlerësimit i referohet aktit të ekspertit kontabël, me pretendimin se të ardhurat e familjes kanë qenë ndjeshëm mbi nivelin e vlerës prej 43.000 eurosh, e gjithashtu, edhe të vlerës së supozuar prej 54.000 eurosh. Subjekti sqaron se nuk ka asnjë arsye për të deklaruar një vlerë më të ulët, në rast se kjo nuk i përgjigjet të vërtetës, dhe se në deklaratimet e tij, i qëndron besnik parimit të ligjit dhe të moralit.

46.16. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se në të dyja rastet, si në deklaratën noteriale të datës 04.08.2004, të z. I. O., të depozituar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, ku deklarohet likuidimi i shumës 43.000 euro, dhe në deklaratën noteriale të datës 19.12.2005, të kundërshtuar nga subjekti, në të cilën po nga z. I. O. dhe investitori e pronari i truallit, z. F. M., deklarohet vlera e paguar 54.000 euro, nuk rezulton të jenë firmosur nga znj. Zh. Pra, nëpërmjet këtyre deklaratave noteriale, z. O., ortak dhe administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në datën 04.08.2004, pranon likuidimin e vlerës 43.000 euro dhe, pas më shumë se një viti, më 19.12.2005, deklaron se është likuiduar vlera 54.000 euro. Në këto kushte, nuk mund të pretendohet që një deklaratë noteriale ka më tepër rëndësi se tjetra apo njëra të konsiderohet e njëanshme dhe të dyshohet për falsitet, dhe tjetra, e nënshkruar nga i njëjti person, të konsiderohet ndryshe, pra me vlerë të plotë provuese.

46.17. Ashtu si konstatuar edhe nga Komisioni, trupi gjykues nuk i vlerëson bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për mospasjen dijeni për deklaratën noteriale të datës 19.12.2005, pasi rezultoi e provuar se ky dokument është pjesë e dosjes së legalizimit pranë ALUIZNI-t, procedurat për të cilin janë kryer nga bashkëshortja e subjektit, dhe se bashkëlidhur shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 20.09.2017, të ZVRPP-së Kavajë, dërguar ILDKPKI-së, rezulton edhe vërtetimi noterial nr. {\*\*\*} rep., datë 12.08.2010, i noteres M. Ll., në të cilin citohet: “[...] u paraqit personalisht Agron Zhukri, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i njohur personalisht, i cili më kërkoi vërtetimin e fotokopjes së dokumentit origjinal të ‘Deklaratë noteriale’, datë 19.12.2005 dhe kontratë sipërmarrje ndërmjet shoqërisë ‘{\*\*\*}’ ShPK dhe F. M., datë 23.06.2003”. Për sa më sipër, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të kësaj deklarate noteriale të paktën që më datë 12.08.2010, kur është paraqitur para noteres për të njësuar kopjen e saj me origjinalin dhe, në këto rrethana, qëndrimet e mbajtura rreth saj vlerësohen të pabazuara. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, në mënyrë të paligjshme i ka kaluar barrë prove mbi një akt të falsifikuar, ndërkohë që mund t’i ishte drejtuar vetë organeve kompetente që para shumë kohësh, dhe jo të kërkonte para noterit njësimin me origjinalin të kopjes së saj, janë elemente që afektojnë besueshmërinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

46.18. Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ndodhen në kushtet e deklaratimit të pasaktë, jo në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, sa i përket vlerës së pasurisë të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kushtet kur vlera prej 54.000 eurosh në deklaratën noteriale është e përafërt me atë prej 55.000

eurosh, të përcaktuar nga palët kontraktore në kontratën e sipërmarrjes. Lidhur me aftësitë paguese të kësteve të kësaj pasurie, trupi gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.129.214 lekë, për të shlyer këstet në masën 33.000 euro në vitin 2003, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*B/6. Për pasuritë, dy “apartamente” në Qendrën “{\*\*\*}”, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vlerën 280.000 euro*

47. Komisioni, për këto pasuri ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultuan me pamundësi financiare për pagesën e kësteve në shumën 68.300 euro, në vitet 2006 dhe 2013.
48. Subjekti i rivlerësimit, përpos shpjegimeve të dhëna në Komision, e kundërshton këtë konkluzion me pretendimet se: (i) përllogaritja e mundësisë për të pasur të ardhura të ligjshme, duke e rifilluar përllogaritjen nga gjendja zero në çdo vit kalendarik, dhe duke injoruar çdo vlerë të gjeneruar në vitet e mëparshme të ushtrimit të aktivitetit, të siguruara nga pagat apo çdo burim tjetër i ligjshëm, është në kundërshtim me çdo parim të logjikës ekonomike. Kjo metodë nuk është gjë tjetër veçse një mekanizëm i përdorur qëllimisht për të krijuar balanca negative artificiale për çdo vit, me qëllimin final rëndimin e pozitës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë arsye, duhet të mbahet parasysh, jo balanca vjetore, por ajo progresive, për të përllogaritur mundësinë reale të subjektit për të përballuar këtë shpenzim për vitin 2013. (ii) Komisioni injoron faktin e provuar nëpërmjet dokumentacionit bankar, që lidhet me vlerën e të ardhurave në masën 31.319.989 lekë, e cila është gjeneruar nga bashkëshortja deri në fund të vitit 2009, kur ushtronte aktivitetin si person fizik. Kjo shumë është mbajtur gjendje në llogarinë bankare, që më pas u përdor nga shoqëria tregtare, e themeluar në vitin 2010. (iii) Në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, është e paligjshme mospërfshirja në analizë financiare e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes, të cilat kanë qenë të mundshme dhe janë përdorur efektivisht nga bashkëshortja për të mbuluar shpenzime të nevojshme me karakter personal, pra, që nuk lidheshin me nevoja të biznesit. (iv) Arsyetimi që përdor Komisioni, se bashkëshortja nuk ka deklaruar huamarrje/huadhënie me shoqërinë, nuk mund dhe nuk duhet të përbëjë shkak për moskualifikimin e tyre si të ligjshme dhe, për pasojë, të mos i përfshijë në analizën financiare. (v) Gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë një sqarim të plotë dhe shterues për sa i përket këtij burimi të ardhurash, duke paraqitur edhe provat mbështetëse. Këto shpjegime duhet të konsiderohen plotësisht të deklaratës *vetting* dhe, për këtë arsye, nuk është i ligjshëm konstatimi i Komisionit, kur argumenton paligjshmërinë e kësaj shume vetëm për arsye se mbi të janë dhënë shpjegime vetëm në prapësimet gjatë zhvillimit të hetimit administrativ. Mbi të gjitha, që kjo ka qenë një shumë që është qarkulluar vetëm nëpërmjet shërbimit bankar.
49. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:
  - 49.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *2 apartamente në Qendrën “{\*\*\*}”, në rr. “{\*\*\*}” [...]. Vlera 280.000 euro. [...]. Burimi i krijimit është kredi 180.000 euro, e marrë nga Banka Italo-Shqiptare, në vitin 2006, për 10 vjet. 70.000 euro të*

paguara me këste gjatë vitit 2006 dhe 2007, si dhe 30.000 euro të paguara mbas vitit 2013 me këste të vogla në zyrat e “{\*\*\*}” ShPK. Të mundësuar nga të ardhurat nga biznesi dhe ndërmjetësimi, nga viti 2010, u zëvendësua me licensën e “broker” në sigurime “{\*\*\*}” ShA. Bashkëngjitur kontrata e kredisë (e cila tashmë është likuiduar, dhjetor 2016), Vërtetim nga “{\*\*\*}” ShPK, për mënyrën e pagesës së kësteve, si dhe pagat R. Zh., Agron dhe A. Zh. [...]. Vlera 280.000 euro. Pjesa takuese 100 %”.

49.2. Referuar aktmarrëveshjes<sup>41</sup> së lidhur mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit, me administrator L. V., dhe R. K. në cilësinë e porositësit, është porositur ndërtimi i dy apartamenteve me sipërfaqe 131.82 m<sup>2</sup> secili, me sipërfaqe totale 263.6 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me vlerë 280.000 euro. Kjo vlerë është parashikuar të paguhet me këste, si vijon: (1) kësti i parë 30.000 euro do të likuidohet me lidhjen e kësaj aktmarrëveshje; (2) kësti i dytë 100.000 euro, likuidohet pas dy muajsh nga kësti i parë, në datën 01.07.2006; (3) kësti i tretë 122.000 euro, likuidohet pas dy muajve nga kësti i dytë, më 01.09.2006; (4) me dorëzimin e objektit, kësti i fundit është 10% e vlerës totale të apartamenteve, 28.000 euro.

49.3. Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka paraqitur një vërtetim nr. *ekstra*, datë 14.12.2009, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në të cilin vërtetohet se R. K. ka lidhur kontratë sipërmarrjeje për blerjen e 2 (dy) apartamenteve, me vlerë totale 280.000 euro. Vlera e përgjithshme e apartamenteve është shlyer si vijon: *kësti i parë* 20.000 euro, shlyer më datë 02.05.2006; *kësti i dytë* 85.000 euro, likuiduar më datë 30.09.2006 në Bankën Amerikane; *kësti i tretë* 20.000 euro, likuiduar më datë 19.10.2006; *kësti i katërt* 95.000 euro, likuiduar më datë 05.12.2006, në Bankën Amerikane; *kësti i pestë* 15.000 euro, likuiduar më datë 28.05.2007; *kësti i gjashtë* 15.000 euro, likuiduar më datë 03.12.2007; *kësti i fundit* 30.000 euro do të likuidohet në momentin e hipotekimit të apartamenteve.

49.4. Këto pasuri janë deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2006, por nuk është deklaruar burimi i tyre, ndërkohë, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, është deklaruar kredi 180.000 euro nga Banka Italo-Shqiptare (BIA ShA) për blerjen e apartamenteve. Në deklaratat e interesave privatë 2007 – 2016, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kredisë.

49.5. Me pyetësin nr. 2, Komisioni i kërkon subjektit të rivlerësimit paraqitjen e dokumentacionit provues mbi likuidimin e çmimit prej 280.000 eurosh, si dhe informacion mbi gjendjen juridike aktuale dhe përdorimin e këtyre pasurive. Subjekti i rivlerësimit sqaron se, sipas vërtetimit të datës 14.12.2009, lëshuar nga përfaqësuesi i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, mbeteshin për t’u likuiduar edhe 30.000 euro, të cilat janë shlyer deri në vitin 2014, në Intesa Sanpaolo Bank ShA dhe, pjesërisht në *cash*, vit që përkon me marrjen e certifikatës së vërtetimit të pronësisë, pasi procesi i kalimit të pronësisë zgjati më shumë se parashikimi. Nga veprimet bankare në Intesa Sanpaolo Bank ShA, rezultoi se gjatë vitit 2013 janë paguar me këste, në total 10.500 euro.

49.6. Për këto dy apartamente, më datë 17.10.2014, nënshkruhet kontrata përfundimtare e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., mes znj. R. Zh. dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Në nenin 2 të kësaj kontrate është përcaktuar se çmimi prej 280.000 eurosh, në përmbushje të kontratës së

---

<sup>41</sup> Vërtetim nënshkrimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.05.2006.

sipërmarrjes të datës 02.05.2006, është paguar me këste deri në dhjetor 2007, ndërsa apartamentet janë marrë në dorëzim në dhjetor 2007.

49.7. Për efekt të kryerjes së analizës financiare, Komisioni i konsideroi vlerat e paguara për likuidimin e çmimit 280.000 euro të dy apartamenteve objekt shqyrtimi, si vijon: (i) 30.000 euro më datë 28.04.2006, sipas aktmarrëveshjes së datës 02.05.2006; (ii) 99.200 euro në datën 31.07.2006 dhe 800 euro në datën 05.10.2006, si diferencë kësti, sipas aktmarrëveshjes, se kësti i dytë prej 100.000 eurosh do të likuidohet dy muaj nga nënshkrimi i saj, si dhe përshkrimit të dhënë në transfertën e shumës 800 euro “pagesë e diferencës së këstit prej 99.200 euro, marrë nga BIA për ‘{\*\*\*}’ ShPK, R. Zh.”; (iii) 95.000 euro më datë 05.12.2006, sipas konfirmimit të veprimit bankar në Intesa Sanpaolo Bank, me përfitues “{\*\*\*}” ShPK; (iv) 5.000 euro në datën 18.12.2006, sipas konfirmimit të veprimit bankar në Intesa Sanpaolo Bank, me përfitues A. Ll., për diferencë kësti apartamenti të “{\*\*\*}” ShPK; (v) 22.000 euro paguar në dhjetor 2006, si diferencë e këstit të tretë prej 122.000 eurosh, sipas përcaktimit në aktmarrëveshje; (vi) 17.500 euro (28.000 euro - 10.500 euro) të paguara deri në dhjetor 2007, sipas aktmarrëveshjes / kontratës së shitjes, si dhe fakteve për marrjen në dorëzim të apartamenteve në vitin 2007; (vii) si dhe 10.500 euro, paguar në Intesa Sanpaolo Bank, në vitin 2013.

49.8. Pagesat e shumave 99.200 euro dhe 95.000 euro kanë si burim, respektivisht *overdraft*-in prej 100.000 eurosh, financuar subjektit dhe personit të lidhur nga Banka Italo-Shqiptare ShA më datë 27.07.2006, dhe kredinë bankare prej 180.000 eurosh financuar atyre nga e njëjta bankë më datë 05.12.2006, burime këto që konfirmohen edhe nga Intesa Sanpaolo Bank ShA<sup>42</sup>. Në lidhje me mundësinë financiare për shlyerjen e kredisë, Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2007 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kanë mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurive, mbulimin e shpenzimeve dhe shlyerjen e kredisë.

49.9. Lidhur me pagesën e vlerës 70.000 euro, të paguar me këste gjatë viteve 2006 e 2007, dhe vlerës 30.000 euro, paguar po me këste mbas vitit 2013, në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja ka deklaruar si burim të ardhurat nga biznesi dhe ndërmjetësimi. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara nga ndërmjetësimi, si dhe faktin që për gjendjen *cash* prej 1.000.000 lekësh të deklaruar në vitin 2003, për periudhën 2004 – 2008 nuk janë deklaruar ndryshime të kësaj gjendjeje likuiditeti. Pasi u verifikuan llogaritë bankare personale dhe të personit fizik, ato rezultuan me shtim të likuiditeteve bankare për vitin 2006 dhe, për rrjedhojë, të ardhurat nga aktiviteti, që mund të jenë përdorur për shlyerjen e kësteve të apartamenteve në vitet 2006 dhe 2007, janë të ardhurat e krijuara respektivisht në këto vite. Të ardhurat e përlllogaritura për vitet 2006 – 2007 janë vlerësuar në shumën 2.100.000 lekë për secilin vit. Në këto kushte, të ardhurat nga aktiviteti i agjencisë së udhëtimit prej 2.100.000 lekësh (fitimi i përlllogaritur nga Komisioni për vitin 2006) janë të pamjaftueshme dhe nuk mund

---

<sup>42</sup> Me shkresën “Kthim përgjigje”, nr. {\*\*\*} prot., datë 23.09.2023, Intesa Sanpaolo Bank ShA konfirmon debitimin më datë 31.07.2006 të shumës 99.200 euro, me përshkrimin në gjuhën italiane: “Prelievo ASP BIA {\*\*\*}, 31.07.2006, FAV A Zhukri”, dhe konsiston në linjë *overdraft*-i të akorduar më datë 27.07.2006, në vlerën 100.000 euro nga Banka Italo-Shqiptare [...] më datë 05.12.2006, kreditimi, shuma prej 180.000 eurosh, me përshkrimin në italisht “Erogazione mutuo {\*\*\*}” [...], është linjë kredie 180.000 euro e aprovuar më datë 05.12.2006 [...]. Bashkëlidhur, ndër të tjera, kontrata e kredisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.12.2006, me kredidhënës Banka Italo-Shqiptare ShA dhe kredimarrës Agron Zhukri dhe R. Zh., për shumën e kredisë 180.000 euro, me qëllim: 1) pagesën përfundimtare të çmimit për blerjen e dy apartamenteve, sipas aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK dhe znj. R. Zh., datë 02.05.2006, dhe 2) shlyerja totale e borxhit të mbetur që rrjedh nga kontrata e kredisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.07.2006, për dhënien e kredisë 100.000 euro, me qëllim pagesën e pjesëshme për blerjen e dy apartamenteve, sipas aktmarrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK dhe znj. R. Zh.

të kenë shërbyer si burim i shumës 57.800 euro<sup>43</sup> së paguar në këtë vit. Ndërsa, të ardhurat në vlerën 2.100.000 lekë për vitin 2007 janë të mjaftueshme për të mbuluar pagesën 17.500 euro ose 2.115.925 lekë të kryer në këtë vit, në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Për sa i përket shumës 10.500 euro, e paguar në vitin 2013, Komisioni analizoi të ardhurat që bashkëshortja ka realizuar nga aktiviteti i agjencisë së udhëtimit me emër tregtar “{\*\*\*}”, e regjistruar me statusin ligjor “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” në janar të vitit 2010, me NIPT {\*\*\*}, dhe biznesi i ndërmjetësimit në sigurime, i regjistruar më datë 30.01.2010, me status ligjor “shoqëri anonime”, emër tregtar “{\*\*\*}”, dhe NIPT {\*\*\*}. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>44</sup> konfirmon se shoqëritë tregtare në të cilat bashkëshortja e subjektit është ortakë/aksionare kanë rezultuar me fitim, por nuk kanë shpërndarë dividendë dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e bizneseve të deklaruara si burim për pagesat në vitin 2013 nuk mund të kenë shërbyer si burim i ligjshëm.

**49.10.** Për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit për të porositur në vitin 2006 dy apartamente me vlerën 280.000 euro, Komisioni analizoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për pagesën e secilit këst, referuar burimit të deklaruar dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit. Rezultatet e analizës së Komisionit për periudhën 01.01.2006 – 28.04.2006 treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 8.999.076 lekë për pagesën e këstit 30.000 euro më datë 28.04.2006. Për pagesën 5.000 euro më datë 18.12.2006, dhe 20.000 euro të paguar po në dhjetor 2006, u krye analiza financiare për periudhën 14.08.2006<sup>45</sup> – 31.12.2006, nga e cila rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi në vlerën (-) 3.818.721 lekë për të paguar 25.000 euro. Në vitin 2013, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi për të paguar 10.500 euro, pasi analiza financiare për këtë vit është me balancë negative. Komisioni, për sa më sipër, i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për konstatimet se: (i) ka bërë deklarime të pasakta dhe kontradiktore në lidhje me likuidimin e vlerës së apartamenteve në deklaratimet periodike, *vetting* dhe gjatë procesit të hetimit; (ii) subjekti i rivlerësimit rezultoi me pamundësi financiare për pagesën e kësteve, në vlerën totale 68.300 euro<sup>46</sup>, për blerjen e dy apartamenteve.

**49.11.** Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera ka shpjeguar se:

**49.11.1.** Në lidhje me pamundësinë financiare të konstatuar nga Komisioni për pagesën e vlerës 30.000 euro më datë 28.04.2006, subjekti i rivlerësimi i referohet aktit të ekspertimit të realizuar nga eksperti kontabël, sipas së cilit, balanca progresive pozitive deri në vitin kalendarik 2005 është në vlerën 18.434.071 lekë, të cilat kanë qenë të mundshme dhe janë përdorur për pagesën e kësteve në vitin 2006. Po sipas aktit të ekspertimit që subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës,

---

<sup>43</sup> Vlera 57.800 euro konsiston në totalin e pagesave 30.000 euro / 28.04.2006 + 800 euro / 05.10.2006 + 5.000 euro / 18.12.2006 + 22.000 euro / dhjetor 2006.

<sup>44</sup> Shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.6.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

<sup>45</sup> Në konsideratë të faktit që deri më 14.08.2006, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me pamundësi financiare për ndërtimin e shtesës 125.2 m<sup>2</sup>.

<sup>46</sup> Vlera totale e pajustifikuar për blerjen e dy apartamenteve, prej 68.300 eurosh konsiston në pagesat e paraqitura në poshtëshënimin nr. 43 më sipër në këtë vendim, shtuar vlerën 10.500 euro të paguar me këste në vitin 2013, si vijon: likuiduar nga 1.500 euro në datat 07.03.2013, 10.04.2013, 16.05.2013, 18.06.2013, 16.07.2013, 04.09.2013 dhe 03.10.2013 përkatësisht, sikurse provohet nga lëvizjet e llogarisë nr. {\*\*\*} në monedhën euro në ISP ShA, në emër të R. Dh. Zh.

rezulton se të ardhurat e gjeneruara nga bashkëshortja nëpërmjet aktivitetit si agjente në sigurime deri në vitin 2007, kanë qenë në vlerë të tillë që mbulojnë shpenzimet e kryera deri në atë vit, konkretisht në vlerën 21.419.800 lekë. Ndërkohë, balanca progresive e vitit 2007, është pozitive në vlerën 18.163.339 lekë. Për këtë arsye, rezulton i pasaktë konstatimi i Komisionit se të ardhurat e përlllogaritura për vitet 2006 – 2007 janë vlerësuar në shumën 2.100.000 lekë për secilin vit. Ndërkohë, të ardhurat për këtë periudhë janë në vlerë konsiderueshëm më të larta.

**49.11.2.** Lidhur me të ardhurat nga shoqëritë tregtare në të cilat bashkëshortja është ortakë/aksionare, të cilat kanë rezultuar me fitim, por nuk kanë shpërndarë dividendë dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e bizneseve të deklaruara si burim për pagesat në vitin 2013 nuk mund të kenë shërbyer si burim i ligjshëm, subjekti i rivlerësimit i referohet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 11.06.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sipas së cilës, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK<sup>47</sup>, nga viti 2010 deri në vitin 2013, ka realizuar të ardhura/fitim pas tatimit në vlerën 27.652.447 lekë. Subjekti prapëson se xhiroja vjetore e një shoqërie tregtare përgjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, sidomos duke pasur parasysh llojin e veprimtarisë që ushtron kjo shoqëri, janë në dispozicion të plotë të ortakut/administratorit që në momentin që paratë janë arkëtuar nga klienti. Për këtë arsye, pavarësisht momentit në të cilin bëhen deklaratimet e bilanceve, pagesat e tatimeve etj., nuk mund të diskutohet disponibiliteti i shumave të qarkulluara. Nga xhiro vjetore e disponuar, është përlllogaritur sa ka qenë fitimi i realizuar, pasi është zbritur vlera e tatimeve të paguara.

**49.11.3.** Subjekti i rivlerësimit, duke pasur parasysh nocionin ligjor të “të ardhurave të ligjshme”, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pretendon se të ardhurat që janë realizuar nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes duhet të konsiderohen të ligjshme. Për sa kohë paratë kanë qarkulluar në llogaritë bankare të shoqërisë, është i verifikuar dhe i konfirmuar burimi i tyre si arkëtime nga klientët e biznesit konkret, dhe janë paguar detyrimet tatimore për to, duhet të jenë të dhëna të mjaftueshme për Komisionin për t’i konsideruar të ligjshme dhe përfshirë në analizë financiare këto të ardhura. Subjekti vë në dukje se në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, bashkëshortja është administratore dhe ortakë e vetme. Duke pasur parasysh që forma ligjore e organizimit të shoqërisë është me përgjegjësi të kufizuar, aplikohen nenet 68 e vijues të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Argumenti i përdorur, se meqë nuk është shpërndarë dividend, të ardhurat nuk merren në konsideratë në analizën financiare, nuk ka mbështetje në këtë ligj, për arsye se, në rastin në fjalë, organi vendimmarrës është “ortaku i vetëm”, duke qenë se ajo është ortakë dhe administratore e vetme e shoqërisë në fjalë.

**49.11.4.** Ky subjekt i regjistruar në datën 05.01.2010, me emër tregtar “{\*\*\*}” ShPK, me NUIS {\*\*\*}, por ka qenë e njëjta veprimtari tregtare me “{\*\*\*}”, person fizik, pasi veprimtarinë tregtare e ushtron në bazë të licencës me të cilën është pajisur që në vitin 1999. Llogaritë bankare të përdorura deri në këtë moment për efekt të aktivitetit si “person fizik tregtar” vijuan të përdreshin edhe për efekt të ushtrimit të aktivitetit si person juridik. Pra, këto të ardhura të ligjshme (neto, për të cilat ishin paguar tatimet nga personi fizik), të alokuara në llogaritë bankare të personit fizik tregtar, kanë qenë në dispozicion të bashkëshortes dhe mund të

---

<sup>47</sup> Referuar ekstraktit historik, më datë 02.03.2018, emri i subjektit ishte “{\*\*\*}”, u bë “{\*\*\*}”, ndërsa më datë 19.01.2022, u bë “{\*\*\*}”.

përdoreshin në mënyrën dhe kohën që ajo e çmonte të arsyeshme. Fillimisht, bashkëshortja, këto shuma ka çmuar t'i vendosë në dispozicion të shoqërisë së re tregtare, të cilën sapo e kishte regjistruar, me qëllim zhvillimin e aktivitetit të saj. Këto shuma, praktikisht kanë përbërë një hua të dhënë nga ortaku i vetëm në favor të personit juridik, të cilat, sipas logjikës juridike të nocionit të “huas”, sigurisht që do të ktheheshin në favor të bashkëshortes në një moment të dytë.

**49.11.5.** Në bazë të dispozitave ligjore të sipërcituara, sipas subjektit, ajo që faktikisht ka ndodhur është që, bashkëshortja, duke përdorur paratë e qarkulluara nga aktiviteti tregtar (nga pjesa e mbetur pas pagimit të tatimeve), ka krijuar në një mënyrë faktike një “marrëdhënie huaje” me shoqërinë tregtare. Kjo “hua”, në kushtet kur cilësitë e “asamblesë së përgjithshme të shoqërisë” dhe bashkëshortes materializohen në një subjekt të vetëm, krijon mundësinë që këto veprime të kryhen pa pasur domosdoshmërinë e formalizimit me akte shkresore. Ky konkluzion mbështetet në ligjin nr. 9901/2008, që, në nenin 81 të tij, parashikon se: “3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen”. Huaja, sipas subjektit, mund të shlyhet nga bashkëshortja në momentin kur efektivisht shoqëria do të shpërndajë dividendin, të drejtë të cilën e ka në prerogativë ekskluzive ta ushtrojë në mënyrën dhe kohën që ajo e vlerëson të arsyeshme.

**49.11.6.** Në arsyetim të subjektit të rivlerësimit, rëndësi në procesin e rivlerësimit ka fakti nëse shumat janë përfituar në mënyrë të ligjshme dhe nëse mbi to janë paguar detyrimet tatimore. Në këtë rast, të dyja këto kushte marrin përgjigje pozitive dhe nuk ka asnjë arsye të ligjshme për të mos i përfshirë këto të ardhura në analizën financiare.

**49.11.7.** Lidhur me mosdeklarimin e ndryshimit të gjendjes *cash* për periudhën 2004 – 2008, subjekti shpjegon se në çdo vit, tepricat pozitive nuk janë tërhequr dhe mbajtur *cash*, por janë mbajtur në llogarinë bankare të cilat janë në përdorim për efekt të aktivitetit tregtar të bashkëshortes. Këto shuma të akumuluar si teprica pozitive ndër vite janë alokuar pikërisht në këto llogari, për nevoja të herëpashershme të biznesit. Më pas, pikërisht nga kjo llogari, për nevoja të ndryshme të familjes, janë kryer transaksione nga bashkëshortja, si për qëllime të pagesës së tarifave të shkollimit të fëmijëve, apo të pagesave të kësteve në favor të shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK etj. Në vijim të linjës arsyetuese të mësipërme, është vepruar nga bashkëshortja në raport me shoqërinë tregtare që ajo drejton, si për të ardhurat familjare që janë alokuar në kartën e biznesit, ashtu edhe për të ardhurat e biznesit që shpesh janë përdorur për nevoja të familjes.

**49.11.8.** Nga lëvizjet bankare për kryerjen e këtyre transaksioneve në vitin 2006, rezulton se ato janë bërë nga llogaria e shoqërisë “{\*\*\*}”. Shuma prej 10.500 eurosh është rezultat i pagesave të shtatë kësteve nga 1.500 euro secili, të bëra përsëri nga llogaria bankare e shoqërisë “{\*\*\*}”, me qëllim pagesën e vlerës së plotë të blerjes së pasurisë. Pagesat për këtë shumë janë kryer nga llogaria bankare e shoqërisë “{\*\*\*}” dhe nuk ka asnjë kuptim konsiderimi i tyre si burime të paligjshme, në një kohë që pagesat janë kryer nga një llogari bankare, e cila, nga ana e saj furnizohet nga të ardhura që burojnë nga aktiviteti tregtar i saj. Referuar faktit që shumat e mësipërme kanë qenë të disponueshme në llogarinë bankare të shoqërisë “{\*\*\*}”, këto shuma rrjedhin nga veprimtari e ligjshme tregtare, për to janë paguar detyrimet tatimore në respektim të kuadrit ligjor në fuqi, pagesat janë kryer po nëpërmjet sistemit bankar dhe, në këto kushte,

subjekti vlerëson se provohet qartësisht mundësia e tyre për kryerjen e pagesave me burime të ligjshme.

49.12. Trupi gjykues, për sa më sipër, konstaton se në kuadër të procesit të rivlerësimit, neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar se: *Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.* Ky përcaktim kushtetues është zbërthyer në nenin 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, i cili termin “të ardhura të ligjshme” e përkufizon si: *janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.* Ligji nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 4 të tij liston burimet e të ardhurave, ndërsa në nenin 8, pasqyron “të ardhurat e tatueshme”<sup>48</sup>. Dispozita e përdorur nga subjekti i rivlerësimit që, sipas tij, legjitimon veprimin e bashkëshortes për të përdorur fitimin e shoqërisë pas tatimit, lidhur me pagesat e kryera për blerjen e apartamenteve, duket se nuk është respektuar në rastin konkret, pasi neni 81, pika 3 e ligjit “Për shoqëritë tregtare” parashikon se: *“Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime; ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. [...]”.*

49.13. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e alokuara në llogaritë bankare të personit fizik tregtar kanë qenë në dispozicion të bashkëshortes dhe mund të përdroreshin në mënyrën dhe kohën që ajo çmonte të arsyeshme, trupi gjykues konstaton se ky pretendim është ngritur si në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore. Më saktësisht, subjekti ka pretenduar se, nga llogaria e biznesit të bashkëshortes janë kryer transaksione prej saj, për qëllime të pagesës së tarifave të shkollimit të fëmijëve dhe të likuidimit të kësteve në favor të shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK në vitet 2006 dhe 2007. Trupi gjykues sjell në vëmendje se të ardhurat e ligjshme të znj. R. Zh. nuk konsistojnë apo barazohen me qarkullimin e shumave monetare në llogaritë bankare të biznesit që ajo ushtron. Në kuadër të këtij procesi, në analizë merret fitimi neto nga aktiviteti i personit fizik, pasi janë zbritur shpenzimet e aktivitetit dhe janë paguar tatimet përkatëse. Qarkullimi në llogarinë bankare të biznesit nuk konsiderohet automatikisht e ardhur personale e disponueshme, në kushtet kur identifikohet fitimi real i përdorshëm.

49.14. Në një shoqëri tregtare, administratori apo ortaku i vetëm nuk mund të përdorë qarkullimin/fitimin vjetor të shoqërisë për qëllime personale apo familjare, pa ndjekur procedurat ligjore të shpërndarjes së *dividendit*, si dhe pa i reflektuar ato në regjistrat/librat kontabël. Qarkullimi apo fitimi vjetor i shoqërisë i përkasin vetëm shoqërisë si person juridik

---

<sup>48</sup> Neni 8, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar, parashikon se, për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: [...], b) të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionarit në shoqërinë tregtare.

dhe janë të destinuar për të përmbushur nevojat e aktivitetit tregtar, investime, shlyerje detyrimesh, shtim kapitali etj. Derisa fitimi i shoqërisë nuk shpërndahet me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve, ai mbetet në bilanc të shoqërisë dhe nuk konsiderohet e ardhur e ortakut. Përdorimi i vlerave monetare të shoqërisë pa një vendim asambleje mund të konsiderohet abuzim nga ana e administratorit/ortakut të saj dhe, në kuadër të procesit të rivlerësimit, afekton ligjshmërinë e burimit të krijimit. Të ardhura të ligjshme të ortakut të shoqërisë, në gjuhën e ligjit, janë ato të përfituara në formën e dividendit, pasi t'i jenë nënshtruar detyrimit tatimor përkatës. Pasuria e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit si individ vlerësohet më vete dhe është e pavarur nga ajo e shoqërisë si person juridik.

49.15. Nëse shumat do të konsideroheshin hua të dhëna nga shoqëria, nuk rezulton që ky fakt të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore apo deklaratën e pasurisë *vetting*, as të jetë provuar me dokumentacion të shoqërisë, *vendimmarrje / regjistrim / pasqyrim në pasqyrat financiare*, apo nga transferimi i këtyre shumave të provohet se janë pasojë e ndonjë huaje të marrë nga shoqëria. Përpos mungesës së provueshmërisë së këtij pretendimi, që duket si një përpjekje e subjektit për të justifikuar kështu e paguara, vetë dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare, përkatësisht neni 13, pika 7 e ligjit nr. 9901/2008, parashikon se: *“Një person, i cili është njëkohësisht administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë, nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë dhe mospërmbushja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative”*. Nga analizimi i pasqyrës financiare për vitin 2013, së shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në faqen zyrtare të QKB-së, në zërin “aktive të tjera financiare afatshkurtra”, nën zëri “llogari / kërkesa të tjera të arkëtueshme”, në të cilën pasqyrohen të drejtat që shoqëria ka ndaj personave të tretë, përfshirë dhe huat e dhëna prej saj, rezulton për vitin 2012 vlera 152.202 lekë, dhe 527.303 lekë për vitin 2013, pra me një rritje të këtij zëri prej 374.801 lekësh, të pamjaftueshme këto për të mbuluar kështu prej 10.500 eurosh paguar shoqërisë së ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK për likuidimin e çmimit të dy apartamenteve në vitin 2013.

49.16. Komisioni, në vendim ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë qenë në pamundësi financiare për të shlyer kështu prej 57.800 eurosh në vitin 2006 dhe 10.500 euro në vitin 2013. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se metoda e hartimit të analizës financiare nga Komisioni, duke e rifilluar përllogaritjen nga gjendja zero në çdo vit kalendarik dhe duke injoruar çdo vlerë të gjeneruar në vitet e mëparshme të ushtrimit të aktivitetit, apo të siguruara nga pagat, apo çdo burim tjetër i ligjshëm, përpos arsyesimit në paragrafin 11.5.3 të këtij vendimi, trupi gjykues e gjen të arsyetuar mjaftueshëm nga Komisioni në paragrafin 83.2 të vendimit objekt shqyrtimi, duke e konsideruar referimin në balancën pozitive progresive: *“metodologji kjo e cila është e gabuar, pasi për periudhën 2003 – 2016 (deklarimi sipas ligjit nr. 9049/2003), tepricat e rezultatit financiar të këtyre viteve nuk mbarten në vitin pasardhës në formën e një mundësie për kursim, por, për secilin vit, në analizën financiare pasqyrohet ajo që është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike dhe, nëse viti rezulton me një balancë pozitive, kjo tregon vetëm se subjekti ka pasur burime të ligjshme atë vit dhe se ajo tepriç konsiderohet e shpenzuar, për faktin se nuk rezulton e deklaruar si kursim, pra, ajo nuk mund të mbartet në vitin pasardhës, sikundër ka vepruar subjekti”*.

49.17. Në kuadër të kontrollit të analizës financiare së Komisionit, mbështetur në të dhënat që ofrojnë aktet në dosjen gjyqësore, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi

i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të shlyer këstet në vlerat 30.000 euro dhe 27.800 euro në vitin 2006, si dhe këstin 10.500 euro në vitin 2013, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016.

*B/7. Për gjendjen cash 7.500 euro dhe 400.000 lekë, deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting*

50. Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e burimit të likuiditeteve *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimet e ligjshme për krijimin e tyre, pasi jo vetëm rezultoi me balancë negative totale në shumën (-) 83.110.519 lekë, por edhe në analizën financiare të aktit të ekspertimit të depozituar nga vetë subjekti si provë në parashtrime, balanca negative totale është në vlerën (-) 12.055.828 lekë, konkretisht: (-) 3.399.473 lekë në vitin 2003; (-) 708.293 lekë në vitin 2006; (-) 1.625.845 lekë në vitin 2010; (-) 1.592.585 lekë në vitin 2011; (-) 958.793 lekë në vitin 2012; (-) 1.661.649 lekë në vitin 2013, dhe; (-) 2.109.190 lekë në vitin 2014.
51. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se Komisioni vijon me arsyetimin e gabuar, duke pretenduar se, nga akti i ekspertimit kontabël i paraqitur prej tij, pohohet balanca negative për vitet 2003, 2006, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Dukshëm, Komisioni refuzon të bëjë dallimin midis një balance totale progresive, e cila për çdo vit rezulton pozitive për subjektin, me balanca pjesore vjetore, të cilat, në vite të caktuara kanë rezultuar negative. Për efekt të analizës dhe të shprehjes së konkluzioneve, Komisioni i referohet gjithmonë balancave pjesore, duke e injoruar përgjatë gjithë vendimmarrjes aspektin total dhe progresiv të vlerësimit ekonomik që duhet t’i bëhej subjektit të rivlerësimit.
52. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues analizon dhe vlerëson si vijon:

52.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja deklaroi: “*Gjendje cash në posedimin tim, 7.500 euro, 400.000 lekë*”. Në këtë deklaratë nuk deklarohet burimi i krijimit të tyre. Nga leximi i deklaratave periodike vjetore, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në vitin 2003, nuk ka deklaruar ndryshime të gjendjes *cash* në vitet 2004 – 2008, si dhe ka deklaruar gjendje *cash* për vitet 2009 – 2016<sup>49</sup>, të cilat janë përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni, në zërin “ndryshim i gjendjes së likuiditeteve”.

52.2. Me pyetësin nr. 3, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes *cash*, të provuar me dokument ligjor. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit sqaroi se gjendja *cash* në dispozicion të bashkëshortes rrjedh nga të ardhurat e saj ndër vite në formën e pagës në të dyja bizneset, të qirave sipas kontratave të lidhura ndër vite, si dhe të bizneseve. Nuk ekziston një datë precize, një moment i caktuar, apo një veprim financiar i caktuar që ka sjellë gjendjen e referuar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

52.3. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për krijimin e çdo pasurie të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, nga ku rezultoi që ata kanë mungesë burimesh të ligjshme për

---

<sup>49</sup> Në DIPPV 2009, 20.000 euro; DIPPV 2010, 21.000 euro; DIPPV 2011, 25.000 euro; DIPPV 2012, 23.000 euro; DIPPV 2013, 21.000 euro; DIPPV 2014, 19.000 euro; DIPPV 2015, 21.000 euro; DIPPV 2016, 1.500.000 lekë.

mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat, edhe gjendjen *cash* të deklaruar në këtë deklaratë.

52.4. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i referohet aktit të ekspertimit të realizuar nga kontabilisti i miratuar, sipas së cilit, për periudhën 2009 – 2016, për çdo vit ka një balancë progresive pozitive e, për këtë arsye, duhet të konstatohet se kjo gjendje *cash* është formuar mbi bazën e të ardhurave të ligjshme. Sipas subjektit, arsyeja përse nuk është deklaruar ndryshimi i gjendjes *cash* ka qenë, sepse në çdo vit, tepricat pozitive nuk janë tërhequr dhe mbajtur *cash*, por ato janë mbajtur në llogarinë bankare, të cilat janë në përdorim për efekt të aktivitetit tregtar të bashkëshortes. Këto shuma të akumuluar si teprica pozitive të të ardhurave ndër vite janë alokuar pikërisht në këto llogari, pasi për nevoja të biznesit, herë pas here i janë nevojitur bashkëshortes. Ka qenë më pas pikërisht nga kjo llogari që, për nevoja të ndryshme të familjes, janë kryer transaksione nga bashkëshortja, si për qëllime të pagesës së tarifave të shkollimit të fëmijëve, pagesa të kësteve të kredisë në Intesa Sanpaolo Bank ShA, si dhe çdo shpenzim i nevojshëm për nevojat e përditshmërisë familjare. Në këtë llogari, janë arkëtuar edhe të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e pasurive të bashkëshortes, të ardhura të cilat efektivisht janë personale, por janë alokuar në llogarinë bankare të shoqërisë. Në vijim të linjës arsyetuese të mësipërme, është vepruar nga bashkëshortja në raport me shoqërinë tregtare që ajo drejton, si për të ardhurat familjare që janë alokuar në kartën e biznesit, ashtu edhe për të ardhurat e biznesit që shpesh janë përdorur për nevoja të familjes.

52.5. Për sa sipër, trupi gjykues, ashtu sikurse dhe Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtyre shumave në deklaratën e pasurisë *vetting*. Sa i përket pretendimit se arsyeja e mosdeklarimit të ndryshimit të gjendjes *cash* ka qenë se, në çdo vit, tepricat pozitive nuk janë tërhequr nga ana e familjes së tij, por ato janë mbajtur në llogari bankare në përdorim të aktivitetit tregtar të bashkëshortes apo për nevoja familjare, trupi gjykues vëren se subjekti duket se ka paqartësi sa i përket ndryshimit mes konceptit ekonomik “kursime *cash*” të cilat disponohen jashtë sistemit bankar, dhe “kursime në bankë” që konsistojnë në likuiditete të cilat janë gjendje në llogari bankare (llogari rrjedhëse, depozitë, kursimi etj.), ndërkohë që ato deklarohen veçmas, siç përcaktuar në nenin 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, dhe në formularin e deklaratës së interesave privatë/periodikë vjetorë.

52.6. Sa i përket pretendimit të subjektit se Komisioni nuk ka marrë në vlerësim faktin që, sipas aktit të ekspertimit të kryer nga kontabilisti i miratuar, rezulton se për periudhën 2009 – 2016, për çdo vit ka balancë progresive pozitive e, për këtë arsye, duhet të konstatohet që kjo gjendje *cash* është formuar mbi bazën e të ardhurave të ligjshme, trupi gjykues, ashtu si më sipër në këtë vendim, arsyeton se subjekti ngre këtë pretendim pa pasur në konsideratë parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, sipas të cilit, *subjektet detyrohen të deklarojnë brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valute të huaj*”. Ndërsa në nenin 6 të këtij ligji parashikohet: “*Të gjitha subjektet [...] që mbartin detyrimin për deklarim, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre*”. Në bazë të këtyre dispozitave,

si dhe në referim të jurisprudencës së Kolegjit<sup>50</sup>, kontrolli i analizës financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, është kryer për çdo vit analitikisht, mbështetur në të dhënat e dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore të Komisionit. Trupit gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e këtyre kursimeve, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*B/8. Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit*

53. Komisioni çmoi se subjekti nuk dha shpjegime bindëse dhe nuk paraqiti prova për të provuar të kundërtën e barrës së provës.
54. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke iu referuar në ankim efektive të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.02.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe pretendimeve të ngritura prej tij para gjykatës, në kuadër të konfliktit gjyqësor. Përpos këtyre, subjekti ka pretenduar se: (i) Në rastin konkret, Kolegji duhet të ketë parasysh që, për efekt të zbatimit të tij, ligji nuk mund të jetë diskriminues. Pra, ose gjyqtarët/prokuratorët janë një kategori e veçantë e ligjit dhe do të trajtohen sipas dispozitave të veçanta, ose janë “zyrtarë” në sytë e ligjit dhe do të trajtohen si të tillë, me të gjitha kufizimet apo privilegjet e zyrtarit. Nëse janë kategori më vete, çështja e interpretimit nuk shtrohet fare, pasi ata përmenden vetëm nominalisht në ligj, dhe rrethi i personave të lidhur zbatohet vetëm për zyrtarët. Nëse do të konsiderohen si “zyrtarë”, çështja që shtrohet është, nëse do të quhen zyrtarë të nivelit të ulët / mesëm apo të nivelit të lartë. (ii) Ligjvënësi i ka barazuar për efekt të ndalimeve/lejimeve zyrtarët e mesëm dhe të ulët me gjyqtarët dhe prokuratorët e shkallës së parë dhe të apelit, ndaj, në rastin e subjektit, do të aplikohet detyrimisht kriteri vlerësues i lidhjes së kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit ku ai ushtron funksionin. Kjo, edhe për shkak të faktit që zyrtarët e lartë ose në nivel qendror, dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese trajtohen sipas neneve 31, 32 dhe 33 të ligjit, të cilat bëjnë përcaktimet konkrete dhe ndalimet, pikërisht për kategoritë specifike. (iii) Të jesh në kushtet e konfliktit të interesit, do të thotë të mundesh objektivisht që, për shkak të pozicionit, funksionit apo mjeteve në dispozicion, të ushtrosh një ndikim material në vendimmarrjen eventuale favorizuese për vete ose për familjarët. Ky nocion nuk mund të jetë abstrakt dhe i pabazuar në disa kriteret racionale, ndaj, edhe fryma e ligjit për të lidhur fushën e ndikimit me territorin dhe juridiksionin ku objektivisht mund të ushtrohet ndikim në funksion të interesave privatë. (iv) Kushtet e dispozitës në fjalë

---

<sup>50</sup> *Vendimi nr. 1/2024 (JR), datë 17.01.2024, i Kolegjit, që i përket subjektit E. T., paragrafi 99. “[...] për sa kohë që referuar parashikimit të nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, detyrimi ligjor për deklarimin e shtesave dhe pakësimeve të likuiditeteve nga ana e subjekteve deklaruese, në secilin lloj dhe formë që ato disponohen, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, ka qenë i qartë. [...] analiza financiare kryhet për çdo vit të periudhës së rivlerësimit, me qëllim verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaruarra dhe atyre të përlllogaritura sipas standardeve tashmë të konsoliduara nga ana e institucioneve të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, çdo vit që rezulton me një bilanc pozitiv në analizë nuk provon faktin se subjektet kanë pasur kursime në gjendje cash, por mundësinë e tyre për t’i justifikuar me burime të ligjshme këto kursime nëse ato do të ishin deklaruar si të tilla në kuptim të detyrimit të sipërcituar ligjor”.*

janë kumulative, pra, duhej që kontratat e lidhura nga agjencia e bashkëshortes të ishin jo vetëm në territorin e Tiranës, por edhe të lidhura me aktivitetin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjë e cila nuk ka ndodhur në rastin konkret, dhe as pretendohet prej ILDKPKI-së apo Komisionit. (v) Në mungesë të vërtetimit të kërkesave të ligjit se bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontrata me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ose institucione të lidhura varësisht me këtë të fundit, nuk rezulton i plotësuar kushti thelbësor për zbatimin e ndalimit të nenit 21 pika 1, ndaj masa e gjobës e, për rrjedhojë, konstatimi i Komisionit për këtë “shkelje të prezumuar” është totalisht i paligjshëm. (vi) Nuk provohet se në veprimtarinë si gjyqtar, subjekti i rivlerësimit të ketë gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit me institucionet shtetërore që ka aplikuar dhe ka lidhur kontratë bashkëshortja nëpërmjet sistemit të prokurimit publik elektronik. Nëse eventualisht këto kontrata do të bëheshin objekt konflikti gjyqësor, ato do të ishin në kompetencë lëndore të Gjykatës Administrative, pjesë e së cilës subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë asnjëherë.

55. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

55.1. Në lidhje me shoqëritë “{\*\*\*}” ShA, me NIPT {\*\*\*}<sup>51</sup>, dhe “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, në të cilat bashkëshortja e subjektit është ortakë/aksionare me 100% të kuotave të kapitalit dhe administratore, u evidentua se Agjencia e Prokurimit Publik, me shkresën nr. {\*\*\*} prot, datë 31.10.2018, ka njoftuar ILDKPKI-në se këto shoqëri janë regjistruar në sistemin e prokurimit elektronik (në vijim “SPE”) dhe janë shpallur fituese në 175 procedura prokurimi elektronik për periudhën 2013 deri më 28.01.2017.<sup>52</sup>

55.2. Komisioni ka referuar nenin 21, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”*. Në nenin 24, pika 1 e këtij ligji përcaktohet se: *“Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”*. Në interpretim të këtyre dispozitave, gjyqtari i Shkallës së Parë dhe i Apelit, dhe personat e lidhur me të, nuk mund të lidhin kontrata me institucione publike.

55.3. Sipas Komisionit, një ndalim i tillë është bërë me ligjin nr. 44/2014, datë 24.04.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’, i ndryshuar”, i cili ka hyrë në fuqi më datë 03.06.2014. Çdo kontratë e lidhur me institucione publike, nga data 03.06.2014 e në vazhdim,

<sup>51</sup> Referuar ekstraktit historik, më datë 02.12.2020, emri i subjektit nga “{\*\*\*}” u bë “{\*\*\*}”.

<sup>52</sup> Shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2013 është shpallur fituese në 35 procedura; në vitin 2014 është shpallur fituese, në total në 41 procedura; në vitin 2015 është shpallur fituese, në total në 75 procedura; në vitin 2016 është shpallur fituese, në total në 21 procedura; në vitin 2017 (deri më 28.01.2017), është shpallur fituese, në total në 2 procedura. Shoqëria “{\*\*\*}” ShA, në vitin 2013 është shpallur fituese, në total në 2 procedura; në vitin 2015, është shpallur fituese në 1 procedurë.

është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, me ndryshimet përkatëse. Referuar përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit Publik, rezulton se, në vitin 2014, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është shpallur fituese në 41 procedura prokurimi në total, ndërsa nga viti 2015 deri më datë 28.01.2017, në total në 98 procedura prokurimi, kurse shoqëria “{\*\*\*}” ShA është shpallur fituese në vitin 2015 në një procedurë prokurimi.

55.4. Në këto kushte, Komisioni i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se bashkëshortja e subjektit ka përfituar të ardhura në kundërshtim me nenet 21 dhe 24 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar. Në prapësimet mbi barrën e provës:

55.4.1. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 14 (JR), datë 16.05.2022, paragrafët 19.1, 19.5, 19.10, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Z. Ai sqaron se i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2021 ‘Për marrjen e masave administrative për shkelje të ligjit për deklarimin e interesave privatë dhe për konfliktin e interesave të ILDKPKI-së’”. Kjo gjykatë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.02.2022, ka vendosur: *“Pranimin e padisë. Shfuqizimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2021 ‘Për marrjen e masave administrative për shkelje të ligjit për deklarimin e interesave privatë dhe për konfliktin e interesave, të ILDKPKI-së’”, vendim gjyqësor ky, i cili ka marrë formë të prerë në datën 28.02.2022. Sipas subjektit të rivlerësimit, aspektet e konfliktit të interesit janë analizuar gjerësisht dhe ai ka ndërmarrë veprimet e nevojshme të mundshme në drejtim të pretendimit për gjendjen e konfliktit të interesit. Për këtë arsye, ajo çfarë është disponuar në këtë vendim përbën “gjë të gjykuar”, e cila, në këndvështrim të “res judicata”, i shtrin efektet jo vetëm për palët ndërgjyqëse, por edhe për çdo subjekt tjetër publik apo privat, për efekt të garantimit të sigurisë juridike në një shoqëri demokratike.*

55.4.2. Në vijim, subjekti sqaron se nuk provohet që në veprimtarinë e tij si gjyqtar ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit me institucionet shtetërore që ka aplikuar dhe ka lidhur kontratë bashkëshortja, nëpërmjet sistemit të prokurimit publik elektronik. Nga momenti që subjekti është vënë në dijeni për ekzistencën e këtij pretendimi të konfliktit të interesit nga ILDKPKI-ja, bashkëshortja nuk ka marrë më pjesë në prokurime të institucioneve publike me shoqëritë tregtare që ajo zotëron. Në zbatim të praktikës gjyqësore të konsoliduar tashmë të Kolegjit në këtë drejtim, sikundër është rasti i sipërcituar, në kushtet e një situatë analoge, i njëjti standard arsyetimi duhet të aplikohet edhe në këtë rast. Ashtu si Kolegji arriti në konkluzionin e konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit A. Z., për shkak se nuk gjeti shkelje për këtë aspekt vlerësimi, në të njëjtat rrethana dhe bazë ligjore gjendet edhe subjekti i rivlerësimit.

55.5. Së bashku me prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit depoziton edhe një kopje të njëzuar të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.02.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përmbajtje të së cilit rezulton se:

55.5.1. Me Urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 18.02.2021, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, është urdhëruar kontrolli i plotë i deklaratave të interesave privatë/periodike vjetore 2017 – 2020 të subjektit Agron Zhukri. Në përfundim të kontrollit të ushtruar, përveç të tjerash, është konkluduar se: *“Subjekti ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit rast për rast të interesave për çështje të veçanta, ‘Ndalimi i lidhjes së kontratave’, dhe nuk ka marrë masat e duhura ligjore për parandalimin sa më të hershëm të tij, pasi bashkëshortja e subjektit, shtetasja R. Zh., ortak*

me 100% të aksioneve të shoqërisë ‘{\*\*\*}’ ShPK [...] është shpallur fitues për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020 në procedurat e prokurimit elektronik dhe ka lidhur kontrata me institucione publike [...], për vitin 2018 në 226 raste, për vitin 2019 në 290 raste, si dhe për vitin 2020 në 92 raste. Në përfundim, nga ILDKPKI-ja është marrë vendimi nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2021 “Për marrjen e masave administrative për shkelje të ligjit për deklarimin e interesave privatë për konfliktin e interesave”, duke vendosur marrjen e masës administrative, gjobë në vlerën 400.000 lekë ndaj subjektit Agron Zhukri, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

55.5.2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pa analizuar nëse veprimet/mosveprimet e paditësit përbëjnë apo jo kundërvajtje administrative, ka vlerësuar se pala e paditur, ILDKPKI-ja, nuk ka provuar respektimin e afatit gjashtëmuor, i sanksionuar në pikën 1 të nenit 17, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, në nenin 40, pika 4 të ligjit nr. 9049/2003, si dhe në nenin 44, pika 5 të ligjit nr. 9367/2005 dhe, për rrjedhojë, vendimi nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2021, për marrjen e masës administrative, është i paligjshëm. Mosrespektimi i këtij afati ligjor ka sjellë humbjen e së drejtës për të shqyrtuar kundërvajtjen administrative. Afati për shqyrtimin e saj është i prerë dhe shkelja e tij shkakton humbjen e së drejtës së shqyrtimit të kundërvajtjes administrative. Po kështu, duke qenë se vlera e vendimit objekt gjykimi është më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, bazuar në nenin 45, shkronja “a” e ligjit nr. 49/2012, ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim. Në përfundim, gjykata vendos pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2021, të ILDKPKI-së, “Për marrjen e masave administrative për shkeljen e ligjit për deklarimin e interesave privatë dhe për konfliktin e interesave”.

55.6. Nga aktet në fashikullin gjyqësor, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe mbetet e provuar gjendja e konfliktit të interesit. Bazuar në nenet 21 dhe 24 të ligjit nr. 9367/2005, duke filluar nga data 03.06.2014, me ndryshimet ligjore të sjella nga ligji nr. 44/2014, subjekti ishte në shkelje të ndalimeve, sipas këtij ligji. Në pikën 1 të nenit 21, “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, parashikohet se: *1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.* Ky ligj, në nenin 24 të tij, përcakton se fusha e zbatimit të ndalimeve dhe kufizimeve është e detyrueshme jo vetëm për zyrtarët, por dhe personat e lidhur me të<sup>53</sup>. Sa më sipër, rezulton se shoqëritë tregtare në të cilat bashkëshortja e subjektit rezulton administratore dhe ortakë e vetme, janë shpallur fituese në procedura prokurimi dhe kanë lidhur kontrata me institucione të ndryshme publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës ku subjekti ushtronte detyrën.

55.7. Sa i përket pretendimeve të subjektit se vendimi nr. {\*\*\*}, datë 28.2.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili ka shfuqizuar vendimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, ka marrë formë të prerë dhe, për këtë arsye, ajo çfarë është

---

<sup>53</sup> Neni 24 i këtij ligji përcakton se rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenet 21 dhe 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

disponuar në këtë vendim, përbën “gjë të gjykuar”, trupi gjykues vëren se gjykata, në vendimin e saj, pa analizuar nëse veprimet/mosveprimet e subjektit përbëjnë apo jo kundërvajtje administrative, ka shfuqizuar vendimin e Inspektorit të Përgjithshëm, pasi për shkak të kalimit të afatit ligjor prej 6 muajsh ka humbur e drejta për të shqyrtuar kundërvajtjen administrative. Në këto kushte, trupi gjykues, në kuadër të procesit të rivlerësimit, e gjen pa efekt këtë vendim gjyqësor, në drejtim të vlerësimit të gjendjes së konfliktit të interesit për subjektin dhe personin e lidhur.

**55.8.** Sa i takon vendimit të Kolegjit nr. 14/2022 (JR), datë 16.05.2022, të cilit i referohet subjekti, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim, se *faktet dhe rrethanat në rastin e vendimit të Kolegjit*<sup>54</sup>, me rastin e subjektit të rivlerësimit, janë të ndryshme, pasi: (i) *Subjekti nuk paraqiti ndonjë provë për të provuar se bashkëshortja, si person i lidhur, nuk i zotëron më kuotat e shoqërive.* (ii) *Subjekti nuk paraqiti ndonjë provë për të provuar se bashkëshortja nuk ka pasur kontrata publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës ku subjekti ushtron detyrën.* (iii) *Sa i takon vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.02.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse Agron Zhukri, dhe palë të paditur ILDKPKI-në, e cila ka shfuqizuar aktin administrativ nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2021, të ILDKPKI-së, gjykata nuk ka analizuar nëse veprimet/mosveprimet e paditësit përbëjnë apo jo kundërvajtje administrative, por e ka shfuqizuar atë për shkak të tejkalimit të afatit 6-mujor të ILDKPKI-së, pra, arsyet janë të ndryshme me rastin e trajtuar nga Kolegji.* (iv) *Subjekti nuk paraqiti ndonjë provë për të provuar se nuk ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit me institucionet shtetërore që ka lidhur kontratë bashkëshortja.* (v) *Subjekti nuk paraqiti ndonjë provë për të provuar pretendimin se, nga vënia në dijeni për ekzistencën e konfliktit të interesit nga ILDKPKI-ja, bashkëshortja nuk ka marrë më pjesë në prokurime të institucioneve publike me shoqëritë tregtare që ajo zotëron.* (vi) *Ndryshe nga rasti i trajtuar nga Kolegji, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi t'i ketë shpëputur interesat e tij financiarë me personin e lidhur dhe, për shkak të lidhjes martesore dhe regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, rezultoi të jenë krijuar të ardhura në situatë të konfliktit të interesit.*

**55.9.** Trupi gjykues vlerëson se rrethanat e konstatuara në rastin e subjektit të rivlerësimit janë tërësisht të ndryshme nga rrethanat në këtë vendim, sa i takon: (i) statusit të personit të lidhur me zyrtarin, parë kjo si në raport me mundësinë për të pasur dijeni ose jo, por dhe në raport me krijimin e pasurisë dhe përfitimin e drejtpërdrejtë nga të ardhurat e fondeve publike, të ndërthurura me njëra-tjetrën në mënyrë të pashmangshme, si rezultat i regjimit martesor; (ii) lidhja e kontratave publike në zonën e kompetencës territoriale ku subjekti ushtron detyrën, si dhe; (iii) qasja dhe veprimet e ndërmarra ndaj situatës së konstatuar, në drejtim të shmangies së këtij konflikti.

**55.10.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës. Në këto kushte, ndonëse Komisioni në vendim nuk ka përmendur situatën në të cilën gjendet subjekti i rivlerësimit në raport me parashikimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë krijuar të ardhura si pasojë e situatës së konfliktit të interesit, nëpërmjet lidhjes së kontratave nga shoqëritë tregtare në pronësi dhe administrim të

<sup>54</sup> Referuar vendimit nr. 14/2022 (JR), datë 16.05.2022, të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Z.

bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me institucione të ndryshme publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës, në të cilën subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

#### *B/9. Analiza financiare për periudhat 1993 – 2002 dhe 2003 – 2016*

56. Komisioni, në vendim konkludoi se subjekti i rivlerësimit për periudhën 1993 – 2002 dhe 2003 – 2016, rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, respektivisht në vlerat (-) 20.361.407 lekë dhe (-) 62.749.112 lekë, në total në vlerën (-) 83.110.519 lekë.
57. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, me pretendimin se balanca negative është përfituar: (i) si produkt i mospërfshirjes së të ardhurave të ligjshme të dokumentuara nga subjekti; (ii) përfshirje në analizë të shpenzimeve në shifra të supozuara dhe joreale; (iii) shtim fiktiv dhe fryrje artificiale të shpenzimeve; (iv) metodologji analize financiare në kundërshtim me çdo logjikë ekonomike; (v) sipas një analize financiare të cilën, edhe përse e ka kërkuar për efekt të ushtrimit të ankimit, nuk i është vënë në dispozicion. Balanca negative prej 83.110.519 lekësh, sipas subjektit të rivlerësimit, përmbysset pas përfshirjes në analizën financiare të të ardhurave të ligjshme të panjohura nga Komisioni, që konsistojnë nga fitimi i bashkëshortes si person fizik “{\*\*\*}” për vitet 2001 – 2009 dhe të ardhurat nga ndërmjetësimi në sigurime, marrëdhënia me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, si dhe përllogaritja e shpenzimeve të udhëtimit. Në vijim të këtij vendimi, trupi gjykues do të marrë në analizë dhe vlerësojë, të ardhurat/shpenzimet/pasuritë e trajtuara në kuadër të analizës financiare.

#### *B/9.1. Për të ardhurat nga biznesi*

58. Komisioni, deri në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me të ardhurat nga biznesi si person fizik me aktivitet agjenci udhëtimesh, ka konstatuar se: (i) nuk përputhen deklaratimet në deklaratat periodike vjetore me ato në deklaratën e pasurisë *vetting*; (ii) vlera e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si fitim neto 35.790.000 lekë, është më e madhe edhe se qarkullimet e konfirmuara nga tatimet prej 33.046.666 lekësh.
59. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e Komisionit, lidhur me këto të ardhura, efekti financiar i të cilave përbën më shumë se 1/3 e balancës negative që kundërshton subjekti i rivlerësimit, i cili pretendon se: (i) Analiza që Komisioni i bën institutit të huas dhe ndalesa ligjore që referon për dhënien e huas nga ortaku i vetëm, nuk mund dhe nuk duhet të aplikohet në rastin konkret, pasi jo vetëm që marrëdhënia nuk mund të cilësohet ligjërisht si hua (në kuptimin juridik të termit), por as nuk ka qenë ndonjëherë huaja qëllimi i bashkëshortes, e cila, si çdo sipërmarrëse e kujdesshme, thjesht ka vijuar normalisht aktivitetin e saj tregtar, pa dashur të prodhojë situata të komplikuar financiare, të cilat, ndër të tjera, as e afektonin nga pikëpamja ekonomike, duke qenë ajo titullare me 100% në secilin aktivitet. (ii) Arsyeimi i Komisionit se pagesat e kryera nga këto fonde për qëllime personale, drejtpërdrejt nga llogaritë e shoqërisë, nuk mund të quhen të ligjshme, për shkak të mosshpërndarjes së dividendit e, rrjedhimisht, mospagimit të tatimit për dividendin, është tërësisht i gabuar, pasi Komisioni ometon faktin evident që të ardhurat e aktivitetit si person fizik përfaqësojnë fitim neto, dhe për to janë paguar të gjitha detyrimet tatimore nga personi fizik. Ndaj, pavarësisht se ato ndodheshin

në llogaritë bankare të shoqërisë, nuk mund të paguanin tatim për dividendin, pasi jo vetëm që nuk përfaqësojnë fitim të shoqërisë, por as nuk mund të paguhej dy herë tatim për to.

60. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

60.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja deklaron: “Gjatë zhvillimit të aktivitetit të personit fizik me NIPT {\*\*\*} prej vitit 2001 – 2009, referuar rekordeve që kam në zyrë dhe vërtetimeve të marra, pas zbritjes së tatimit që përcaktohej fiks çdo vit nga tatimet në bazë tremujore, fitimi i mbetur nuk ka detyrim për trajtim si dividendë deri në 8 milionë lekë, ka qenë quajtur biznes pa TVSH. Totali i përfaqësuar për vitin 2011 – 2009, d.m.th. për 9 vjet është 35.790.000 lekë”. Në deklaratën e pasurisë 2003, dhe në deklaratat periodike vjetore 2004, 2006, 2007, 2008 dhe 2009, subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur kanë deklaruar të ardhura nga aktiviteti ekonomik “person fizik”.

60.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se bashkëshortja e subjektit, znj. R. Zh.: -- ndonëse me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.09.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte vendosur për regjistrimin si person juridik “{\*\*\*}” ShPK, me ortak dhe administrator të vetëm znj. R. Zh., me objekt veprimtarie “agjenci sigurimesh” (për të gjitha llojet e sigurimeve), turistike, udhëtimi, për transport ndërkombëtar udhëtarësh, detar dhe rrugor, fluturime ajrore ndërkombëtare, shoqëri e cila u regjistrua më datë 05.01.2010; -- është pajisur me licence nr. {\*\*\*}, datë 13.10.1999, lëshuar nga Komiteti i Zhvillimit të Turizmit, për të ushtruar aktivitetin si agjenci udhëtimi turistike me emër “{\*\*\*}” ShPK; -- me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.03.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur për regjistrimin si person fizik të kërkueses R. K., për të ushtruar aktivitet privat në fushën e agjencisë së sigurimeve për të gjithë llojet e sigurimeve, dhe shitjen e biletave të udhëtimit për transportet detare, ajrore e tokësore. Referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit person fizik “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, ajo rezulton e regjistruar më datë 16.03.2001, me emër tregtar “{\*\*\*}”; -- referuar informacionit që Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë i përcjell nëpërmjet komunikimit elektronik ILDKPKI-së më datë 29.10.2018, rezulton se personi fizik “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, është regjistruar në sistemin tatimor si biznes i vogël më datë 16.05.2001 dhe çregjistruar më datë 23.02.2010. Sipas këtij komunikimi, referuar të dhënave tatimore për vitet 2001 dhe 2002, nuk ka të dhëna për qarkullimin, ndërsa për vitin 2007, kjo kategori subjektësh ka qenë në administrim të bashkisë. Për vitet 2003 – 2006 dhe 2008 – 2009, ka realizuar qarkullim vjetor, në vlerë totale 33.046.666 lekë. Në vijim të këtij informacioni, rezulton se ka të dhëna për fitimin e realizuar vetëm për vitet 2008 – 2009, në vlerën totale prej 3.777.230 lekësh, ndërsa për vitet 2003 – 2006, nuk ka të dhëna për fitimin e realizuar, por vetëm për tatimin e paguar në vlerën totale prej 559.130 lekësh.

60.3. Në rezultatet e hetimit administrativ dhe në vendim, Komisioni ka konstatuar se meqenëse për vitet 2003 – 2006: (a) konfirmohet nga organi tatimor qarkullimi, si dhe pagesa e tatimit; (b) ka deklarime në deklaratat periodike nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti si person fizik, në analizën financiare do të konsiderohet për këtë periudhë fitimi i mundshëm. Ky fitim është llogaritur si rezultat i aplikimit të normës mesatare të fitimit për vitet 2008 – 2009, mbi qarkullimin e realizuar, të konfirmuar nga tatimet. Nga përllogaritja, ky fitim i mundshëm, për periudhën 2003 – 2006 rezulton në vlerën 8.000.000

lekë. Për vitin 2007, marrë në konsideratë përgjigjen e Bashkisë Tiranë<sup>55</sup> se ka likuiduar detyrimet për taksën e biznesit të vogël në vlerën 123.000 lekë, me nivel xhiroje 7-8 milionë lekë, Komisioni në analizë financiare ka marrë si fitim të mundshëm fitimin e përllogaritur për vitin 2006, në vlerën 2.100.000 lekë. Deri në këtë fazë të hetimit administrativ, lidhur me këto të ardhura, Komisioni konstatoi se: (i) nuk përputhen deklaratimet e subjektit dhe personit të lidhur në deklaratat periodike vjetore, me ato në deklaratën e pasurisë *vetting*; (ii) vlera e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si fitim neto 35.790.000 lekë, është më e madhe edhe se qarkullimet e konfirmuara nga tatimet, prej 33.046.666 lekësh.

**60.4.** Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit i është referuar përllogaritjes së fitimit për periudhën 2001 – 2009 në aktin e ekspertimit të kontabilistit të miratuar, sipas së cilit, në total, fitimi rezulton në vlerën 31.319.989 lekë<sup>56</sup>. Subjekti i rivlerësimit, në vijim të prapësimeve, sqaron se në datën 23.02.2010, personi fizik u çregjistrua si i tillë, duke u regjistruar më datë 05.01.2010, me emër subjekti “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*} (por ka qenë i njëjti subjekt, pasi veprimtarinë tregtare e ushtron në bazë të licencës me të cilën është pajisur në vitin 1999). Llogaritë bankare të përdorura për efekt të aktivitetit si “person fizik tregtar” vijuan, sipas subjektit, të përdorëshin nga bashkëshortja për efekt të ushtrimit të aktivitetit të personit juridik. Pra, të ardhurat neto të alokuara në llogaritë bankare të personit fizik tregtar kanë qenë në dispozicion të bashkëshortes dhe mund të përdorëshin prej saj kur të çmohej e arsyeshme. Ajo ka çmuar t’i vendosë këto likuiditete në dispozicion të shoqërisë së re tregtare, me qëllim dhënien *hov* aktivitetit të saj, fakt i rezultuar në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.01.2010, të ortakut të vetëm të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK<sup>57</sup>. Këto shuma, sipas subjektit, përbëjnë një hua të dhënë nga ortaku i vetëm në favor të personit juridik, të cilat, sipas logjikës juridike të nocionit të “huas”, sigurisht që do të ktheheshin në favor të bashkëshortes në një moment të dytë.

**60.5.** Në analizën financiare të kryer, Komisioni i ka përllogaritur të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes si person fizik për periudhën 2003 – 2009, në vlerën totale 15.887.230 lekë<sup>58</sup>. Për vitet 2003 – 2006, duke përllogaritur fitimin neto në masën 30% mbi qarkullimin e provuar nga tatimet, për vitin 2007, në masën e viteve të mëparshme, kurse në vitet 2008 – 2009, sipas informacionit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Nga aktet në dosje, provohet konstatimi i Komisionit se shuma e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si e ardhur nga biznesi si person fizik, prej 35.790.000 lekësh, nuk përputhet as me shumën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në prapësime apo në ankim, prej 31.319.989 lekësh. Referuar pretendimeve të ngritura në ankim, rezulton një paqartësi në të kuptuarit e nocionit “e ardhur nga biznesi” në raport me “qarkullim vjetor”. Nga trupi gjykues, edhe të ardhurat e biznesit u konsideruan në analizën financiare të Komisionit, kontrolluar në Kolegj nga Njësia e Shërbimit Ligjor, sipas dokumentacionit provues të administruar në fashikullin gjyqësor.

<sup>55</sup> Përgjigjja e Bashkisë, me nr. {\*\*\*} prot., datë 28.10.2016.

<sup>56</sup> Shih faqe 39 – 41 të aktit të ekspertimit të kontabilistit.

<sup>57</sup> Në të cilin është vendosur: “1. Miratimin e shumës së likuiditeteve të cilat vijnë nga biznesi i personit fizik “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, si dhe të ardhurave si agjente në sigurime, të konsiderohen si likuiditete të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Vlera e likuiditeteve të përdorura në çeljen e vitit ushtrimor 2010 është rreth 22.6 milionë lekë [...]”.

<sup>58</sup> Për vitin 2003, në vlerën 600.000 lekë; për vitin 2004, në vlerën 1.200.000 lekë; për vitin 2005, në vlerën 2.000.000 lekë; për vitin 2006, në vlerën 2.100.000 lekë; për vitin 2007, në vlerën 2.100.000 lekë; për vitin 2008, në vlerën 1.115.000 lekë, dhe; për vitin 2009, në vlerën 2.662.230 lekë.

60.6. Në kushtet kur të ardhurat nga biznesi si person fizik deri në vitin 2009 janë pretenduar si hua e dhënë nga bashkëshortja, vënë në dispozicion të shoqërisë tregtare të krijuar prej saj në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit në ankim ka shpjeguar se konsiderimi prej tij i vlerës objekt analize “praktikisht një formë huaje”, nuk ka pasur parasysh institutin klasik të huas (së cilës i referohet Komisioni), ku ortaku derdh para *cash* ose kalon në llogarinë e shoqërisë nga llogaria personale, të cilat i merr mbrapsht në një moment të dytë. Rasti objekt trajtimi është një rast i veçantë (*sui generis*), ku vazhdimësia e të njëjtit aktivitet tregtar, me të njëjtat llogari bankare, nga i njëjti person, por me dy subjekte juridike të ndryshme të njëpasnjëshme, ka prodhuar rezultatin që likuiditetet të ishin ekzistuese në llogaritë bankare dhe kontabël të shoqërisë së re tregtare. Kjo marrëdhënie financiare nuk është hua nga pikëpamja ligjore, pasi mungon elementi thelbësor i shprehjes së vullnetit për dhënien e huas nga pikëpamja kontraktore, por është quajtur e tillë në vlerësim të elementit të marrjes mbrapsht ose të përdorimit për qëllime personale/familjare të kësaj vlere nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

60.7. Në vijim të arsytimit të dhënë në paragrafët 49.12 - 49.15 të këtij vendimi, trupi gjykues, këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit e gjen pa ndikim ligjor në vlerësimin e kriterit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, në kushtet kur objekt shqyrtimi janë pasuritë e tyre, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të këtij procesi, objekt analizimi janë të ardhurat e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ligjshmëria e tyre, të tilla si paga si administratore / fitimi neto / dividendi, të vërtetuara me dokumentacion provues, të deklaruar si burim për krijimin e pasurive të subjektit dhe personit / personave të lidhur, në deklaratën e pasurisë *vetting*.

#### *B/9.2. Për të ardhurat nga ndërmjetësimi në sigurime*

61. Në përfundim, duke marrë në konsideratë se nuk u shpjeguan mospërputhjet lidhur me shumat e përfituara, kohën e përfitimit, nuk u provua në mënyrë shteruese se shumat e shënuara në vërtetime janë përfituar nga bashkëshortja e subjektit, si dhe nuk u provua pagesa e tatimit në burim për këto të ardhura, Komisioni vlerëson të mos i marrë të ardhurat nga ndërmjetësimi në konsideratë. Edhe nëse këto të ardhura do të përfshiheshin si të ardhura të ligjshme, konkretisht për periudhën 1996 – 2008, shuma 10.312.633 lekë nga {\*\*\*}, dhe 12.911.596 lekë për periudhën 1999 – 2008, nga {\*\*\*}, përsëri analiza financiare e rishikuar ndër vite do të ishte me balanca negative totale, në vlerën (-) 62.319.711 lekë.
62. Subjekti i rivlerësimit në ankim, përpos shpjegimeve të dhëna më herët në Komision, që do të trajtohen në vijim në këtë vendim, kundërshton konkluzionet Komisionit, me pretendimet se: (i) Për pagimin e tatimit në burim, arrihet një nga pikat më absurde dhe në shkelje flagrante të ligjit nga Komisioni, pasi nga njëra anë detyrohen të pranojnë që bashkëshortja, për rrjedhojë edhe subjekti, nuk kanë asnjë detyrim ligjor për këtë pagesë apo vërtetimin e saj dhe, nga ana tjetër, në sfidim të logjikës, me një frazë të pakuptimtë, shprehen se: “*bashkëshortja e subjektit duhet të tregonte kujdesin e duhur për të provuar përfitimin e të ardhurave nga ndërmjetësimi në sigurime dhe pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat nga ndërmjetësimi*”. (ii) Bashkëshortja ka treguar jo vetëm kujdesin e duhur, por e ka tejkaluar edhe barrën e provës, duke dëshmuar e detajuar pagesat e përfituara, të cilat janë konfirmuar edhe nga vetë shoqëritë e sigurimeve, licencat e ushtrimit të aktivitetit dhe konfirmimin nga administrata tatimore, lidhur

me pamundësinë e detajimit të pagesave të tatimit në burim (pavarësisht se nuk ishte detyra e saj). (iii) Në kushtet kur vetë Komisioni e pranon që ky detyrim rëndonte mbi subjektet paguese të cilat edhe e kanë konfirmuar pagesën e tatimeve, nuk mund ta penalizonte subjektin për një detyrim që ligji nuk ia ngarkonte dhe ta kalonte këtë shkelje flagrante të procesit duke e përkufizuar si “kujdesin që duhet të ishte treguar”. (iv) Komisioni nuk analizon dhe nuk jep asnjë sqarim se për cilën arsye nuk i pranon deklaratimet e shoqërive të sigurimit, kur këto të fundit u janë referuar rekordeve të brendshme, sipas të dhënave të ruajtura në bazën e të dhënave të përmbledhura ndër vite për të gjithë agjentët e tyre dhe, për shkak të veprimtarisë së tyre të posaçme, bëjnë pjesë në grupin e bizneseve të monitoruara nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (*fakt që rezulton edhe nga përgjigjet e ardhura nga kjo drejtori*), duke pasur çdo vit një kontroll shumë të rreptë në lidhje me tatimet e paguara, si ato të vetë shoqërisë, ashtu edhe tatimet e mbajtura në burim. Jo vetëm kaq, por {\*\*\*}, deri në vitin 2016 ka qenë shoqëri me kapital 100% shtetëror, ndaj vënia në dyshim e veprimtarisë dhe pagimi i detyrimeve fiskale nga ana e një organi shtetëror, për një institucion tjetër shtetëror, tregon për një qasje joetike të Komisionit ndaj procesit; (v) Komisioni nuk kishte asnjë arsye të ligjshme për të vënë në dyshim saktësinë e vërtetimeve që janë lëshuar prej tyre dhe, aq më pak, t’ia rëndonte subjektit të rivlerësimit balancën negative krejtësisht në kundërshtim me ligjin.

63. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

63.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit deklaron: “Nga viti 1996 deri në shkurt 2010, kam ushtruar ndërmjetësinë në sigurime, fillimisht në kompaninë {\*\*\*}. Në dokumente shoqëruese, vërtetimi për të ardhurat e realizuara, pasi tatim fitimi mbahej në burim. Shuma 4.325.503 lekë, 35.026 USD dhe 10.970 euro. Nga [...] shkurt 1999 – shkurt 2010, kam kryer ndërmjetësen në sigurime dhe për kompaninë {\*\*\*} ShA, më vonë {\*\*\*}, tatimi mbahej në burim [...]. Shuma 12.911.683 lekë.

63.2. Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka depozituar: (i) Kontratë e datës 25.04.1997, e lidhur mes {\*\*\*} ShA dhe agjentit R. Zh., me objekt ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të sigurimeve vullnetare, në formën e gjetjes së klientit për t’u siguruar pranë {\*\*\*}, përgatitjes së dokumentacionit të marrjes në sigurim, dhe nënshkrimit e lëshimit të kontratës së sigurimit brenda territorit të Shqipërisë. Sipas nenit 2 të kontratës, agjenti do të marrë shpërblimin sipas tarifave të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme që i bashkëngjiten kësaj kontrate, dhe janë pjesë përbërëse e saj (ndërkohë që, bashkëlidhur, nuk janë përcjellë tarifatat e shpërblimit të agjentit sipas llojeve të sigurimeve). Kontrata është me afat njëvjeçar. (ii) Shkresat nr. {\*\*\*} prot., dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 27.01.2017, me lëndë “Njoftim mbi të ardhurat vjetore 1996 – 2008”, të {\*\*\*} ShA, sipas së cilave, për periudhën 1996 – 2008, znj. R. Zh. ka realizuar të ardhura neto si ndërmjetëse në tregun e sigurimeve, në total 4.325.503 lekë, 35.026 USD dhe 10.970 euro, të ndara analitikisht sipas viteve<sup>59</sup>; (iii) Shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.10.2016, të shoqërisë

<sup>59</sup> Për vitin 1996, 743.900 lekë dhe 3.979 USD; për vitin 1997, 625.490 lekë dhe 4.340 USD; për vitin 1998, 897.600 lekë dhe 5.365 USD; për vitin 1999, 712.349 lekë dhe 4.091 USD; për vitin 2000, 447.780 lekë dhe 5.215 USD; për vitin 2001, 237.900 lekë dhe 3.278 USD; për vitin 2002, 265.060 lekë, 3.640 USD dhe 540 euro; për vitin 2003, 198.567 lekë, 2.180 USD, 1.790 euro; për vitin 2004, 97.500 lekë, 1.865 USD, 1.940 euro; për vitin 2005, 24.790

“{\*\*\*}” ShA, sipas së cilës, R. Zh. ka përfituar të ardhura neto në shumën prej 12.911.683 lekësh në periudhën 1999 – 2008, të ndara analitikisht për çdo vit. Nëpërmjet kartelës “Analizë veprimesh në llogari”, e lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, për vitin 2009 vërtetohet që R. Zh. është paguar gjatë këtij viti me 1.967.938 lekë.

63.3. Komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për informacion në lidhje me tatimin në burim mbi të ardhurat e përfituara nga ndërmjetësit / agjentët e sigurimeve për shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 1996 – 2008, dhe shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 1999 – 2008. Kjo drejtori, në përgjigjen me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.11.2023, sqaron se administrata tatimore, duke mos pasur detyrimin ligjor për mbajtjen e të dhënave në lidhje me ndërmjetësit / agjentët e sigurimeve, në veçanti gjatë pagesës së tatimit në burim nga ana e subjektit tregtar, nuk e administron këtë lloj informacioni. Këto të dhëna, sipas Drejtorisë Tatimore, mund të gjenden pranë shoqërive përkatëse të sigurimeve, duke pasur parasysh faktin se, në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 48, të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhen nga tatimpaguesit për të paktën 5 vite, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentet.

63.4. Ndërkohë, shoqëritë e sigurimit kanë ofruar këtë informacion: (i) “{\*\*\*}” ShA, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.10.2023, informon se për periudhën 1996 – 2008, i njohur si “{\*\*\*}”, shoqëri me kapital shtetëror, ka operuar për çdo rast në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi, që prej themelimit të saj, duke përllogaritur dhe paguar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet me ndërmjetësit në sigurime. Kjo shoqëri informon se, për shkak të faktit që ka kaluar kohë e gjatë dhe shoqëria i është nënshtruar ndryshimeve thelbësore, nuk disponon të dhëna analitike mbi llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit në burim për znj. R. Zh. (ii) “{\*\*\*}” ShA konfirmon se të ardhurat e përfituara për periudhën 1999 – 2008, në vlerën 14.346.633 lekë, nga të cilat 1.443.633 lekë (10% e shumës bruto) janë mbajtur si tatim në burim dhe janë derdhur në organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi. Të ardhurat neto të përfituara nga R. Zh. janë në vlerën 12.911.683 lekë. Pas kërkesës së Komisionit për dokumentacionin mbi të cilin ishte hartuar tabela e llogaritjes së komisioneve të ndërmjetësimit, kjo shoqëri<sup>60</sup> deklaroi se disponon vetëm tabelat e llogaritjes së komisioneve të ndërmjetësimit në sigurime për znj. Zh., të ndara në vite, sipas monedhave. Lidhur me dokumentacionin e kërkuar kontabël ose justifikues si transaksione pagesash etj., shoqëria konfirmon se nuk e disponon, pasi kanë kaluar të paktën 15 vite dhe, sipas politikave të brendshme të shoqërisë, por edhe atyre për arkivin e shtetit, pas 10 vitesh, nuk mbahen më, pra, nxirren jashtë përdorimit dhe asgjësohen.

63.5. Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë me dokument ligjor vlerat e të ardhurave neto të përfituara nga shoqëritë e sigurimit {\*\*\*} dhe {\*\*\*} ShA, si dhe pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, sipas pikës 3 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Në përgjigjet e tij, subjekti shpjegoi se ka depozituar vërtetimet e këtyre dy shoqërive, të cilat kanë deklaruar të ardhurat e realizuara ndër vite nga bashkëshortja prej vitit 1996 deri në vitin 2009, pasi në vitin 2010 u miratua kuadri ligjor dhe u mundësua licencimi i *broker-ave* me status *person/persona fizikë e shoqëri anonime*, dhe bashkëshortja ka qenë në 5 (pesë) shoqëritë e para të licencuara si *broker*, me status ligjor *shoqëri anonime*. Lidhur me tatimin, subjekti sqaron se, referuar ligjit nr. 8438/1998 dhe udhëzimit nr. 5, datë

---

lekë, 647 USD, 1.490 euro; për vitin 2006, 1.426 USD, 2.370 euro; për vitin 2007, 36.740 lekë, 1.577 euro; për vitin 2008, 46.827 lekë dhe 120 euro.

<sup>60</sup> Me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 23.10.2023; nr. {\*\*\*} prot., datë 18.12.2023; nr. {\*\*\*} prot., datë 02.02.2024.

30.01.2006, dalë në zbatim të tij, tatimi për këto të ardhura mbahet në burim, siç përcaktohet në nenin 33, shkronja “c” e këtij ligji. Pavarësisht se aktiviteti i agjentit në sigurime ishte përfshirë në aktivitetin e agjencisë, për këtë pjesë të aktivitetit nuk lejohej të kryhej vetë pagesa e tatimeve, pasi ishte rreptësisht e kontrolluar nga kompanitë e sigurimit, duke qenë se u kërkohej tatimi në burim për çdo policë sigurimi të faturuar dhe komision të realizuar nga agjentët e kontraktuar. Çdo kompani sigurimi kishte agjentët e saj. Një agjent sigurimi nuk mund të punonte në më shumë se një kompani sigurimi, në dallim nga *broker*-i me status *shoqëri anonime*, i cili mund të lidhë kontrata dhe të punojë me të gjitha kompanitë e sigurimit që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga viti 2010, kjo paqartësi nuk ekziston më, pasi *broker*-at (qofshin persona fizikë apo shoqëri anonime), paguajnë tatimet me NIPT-in e tyre dhe të gjitha detyrimet fiskale që rrjedhin në bazë të ligjit.

63.6. Referuar informacionit të përcjellë nga Procredit Bank ShA, rezulton se nga llogaritë bankare të personit fizik janë kryer pagesa për shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 2002 – 2003, në vlerat 6.312.138 lekë, 9.010 USD dhe 17.512 euro. Komisioni, me pyetësin nr. 3, iu drejtua subjektit të rivlerësimit për të sqaruar se çfarë përfaqësojnë këto vlera, si dhe me çfarë statusi ligjor (person fizik apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT-in përkatës) është operuar. Subjekti ka sqaruar se këto veprime janë xhirimet periodike për punën si agjente sigurimesh dhe, referuar përshkrimeve të transfertave, në bazë të procesverbaleve e rakordimeve mujore, është bërë pagesa e policave të arkëtuara në zyrë ose në llogari, në rastet kur klienti paguante me bankë. Sipas subjektit, veprime financiare të lidhura me sigurimet janë kryer edhe në Bankën Amerikane dhe Bankën Popullore.

63.7. Komisioni verifikoi llogaritë bankare të identifikuar nga subjekti i rivlerësimit dhe konstatoi se në Intesa Sanpaolo Bank ShA (ish-Banka Amerikane) ka pagesa për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 2001 – 2004, në vlerat si vijon: 2.761.681 lekë, 4.090 USD dhe 8.600 euro, si dhe pagesa të kryera nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 2008 – 2009, me përshkrimin “komisione agjenti për muajin”, në vlerat 19.312 lekë, 1.507 USD dhe 7.102 euro. Nga verifikimi i llogarisë bankare të personit fizik “{\*\*\*}” në OTP ShA (ish-Banka Popullore), e depozituar nga vetë subjekti në Komision, nuk u konstatuan veprime (pagesa/arkëtime) për / nga shoqëritë e sigurimit “{\*\*\*}” apo “{\*\*\*}” ShA. Në këtë llogari, evidentohen veprime deri në fund të vitit 2009, vetëm në lidhje me aktivitetin “agjenci udhëtimesh”, pasi më 05.01.2010, R. Zh. ka regjistruar subjektin “{\*\*\*}”, me NIPT {\*\*\*}, i organizuar me përgjegjësi tatimore “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, në të cilin ajo figuron ortak e vetme dhe administratore, ndërsa personi fizik, më 23.02.2010, u çregjistrua.

63.8. Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës për këto konstatime: (i) Ka mospërputhje të të ardhurave si ndërmjetëse në sigurime të bashkëshortes, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore, me ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*. (ii) Ka mospërputhje në lidhje me periudhën e përfitimit të këtyre të ardhurave, pasi nga vërtetimet e kompanive rezulton harku kohor 1996 – 2008, ndërsa subjekti pretendon periudhën 1996 – 2010. (iii) Nuk është provuar pagimi i tatimit në burim mbi të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti i bashkëshortes si ndërmjetëse sigurimesh me shoqëritë “{\*\*\*}” ShA dhe “{\*\*\*}” ShA; (iv) Kompanitë e sigurimeve nuk kanë provuar me dokumentacion vlerat e deklaruara në vërtetimet e depozituara. (v) Nga verifikimi i veprimeve

bankare, nuk mund të identifikohet sa është shuma e përfituar nga ndërmjetësimi në periudhat përkatëse. (vi) Nga informacioni i administruar nga faqja e zyrtare e QKB-së për vitet që janë më afër deklarimit të këtyre të ardhurave, si për shembull, 2010 – 2012, rezulton se fitimi i deklaruar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA është në vlera më të vogla se ato të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën para vitit 2010. Bazuar në sa më sipër, deri në këtë fazë të hetimit administrativ, duket se nuk janë vërtetuar të ardhura të ligjshme nga ndërmjetësimi i bashkëshortes, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës e, për rrjedhojë, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga ndërmjetësimi në sigurime.

**63.9.** Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera ka sqaruar si vijon:

**63.9.1.** Bashkëshortja e ka filluar këtë aktivitet në vitin 1996, pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ({\*\*\*}), marrëdhënie e cila u formalizua më pas nëpërmjet kontratës së datës 25.04.1997, e vetmja kontratë që kanë mundur të gjejnë, ndërkohë që këto janë kontrata të nënshkruara përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 9049/2003, nga i cili buroi për herë të parë detyrimi si subjekt për të deklaruar pasuritë dhe burimet përkatëse të krijimit të tyre. Nëpërmjet shkresave të lëshuara nga dy shoqëritë e sigurimit, konfirmohen të ardhurat neto që ka gjeneruar bashkëshortja.

**63.9.2.** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si gjatë hetimit, ashtu në ankim dhe parashtrime, se i është drejtuar Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, me qëllim marrjen e informacionit në lidhje me pagesën e tatimit të mbajtur në burim, në mënyrë analitike, për agjenten e sigurimeve, znj. R. Zh., për periudhën 1996 deri në vitin 2010, konkretisht nga bashkëpunimi me shoqërinë “{\*\*\*}” ShA për vitet 1996 – 2008, dhe shoqërinë “{\*\*\*}” ShA për vitet 1999 – 2009. Me anë të përgjigjes me shkesën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2024, kjo drejtori informon se, për atë periudhë: *“Tatimi në burim paguhej nëpërmjet urdhërpagesave nga jashtë sistemit tatimor, pasi kjo përgjegjësi nuk ishte e formalizuar nëpërmjet një deklarate tatimore. Pagesa nga ana e subjekteve kryhej në total për të gjitha detyrimet e lindura për një periudhë tatimore të caktuar, në lidhje me tatimin në burim. Detajimi i çdo pagese të kryer nga ana e subjekteve mbetet përgjegjësi e tyre dhe, si e tillë, nuk administrohet nga ana jonë. [...], subjektet të cilët pretendohet se kanë kryer pagesat e tatimit në burim, në cilësinë e agjentëve tatimore, në përputhje me nenin nr. 5 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, duhet të paraqesin detajim të çdo pagese të kryer për secilën periudhë tatimore, së cilës i referoheni në shkresën tuaj, për të vijuar më pas me përputhjen e totalit të pagesave të kryera nga tatimpaguesit dhe regjistruar nga administrata tatimore. Ky informacion mund t’i ofrohet në vijim vetëm tatimpaguesve, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, që rregullojnë marrëdhëniet administrate tatimore – tatimpagues [...].”*

**63.9.3.** Nisur nga përmbajtja e kësaj shkrese, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka qenë në asnjë moment detyrim i bashkëshortes, si agjente pranë këtyre shoqërive, për të paguar këtë tatim. Kjo, pasi veprimtaria e saj si agjente konsiston në gjetjen e klientit, informimin e tij në lidhje me llojet e sigurimeve që mund të përdorë në jetën e tij private apo aktivitetin e biznesit, dhe t’i sigurojë klientit ofertën më të mirë në lidhje me shoqërinë e sigurimit. Duke qenë se për shoqërinë e sigurimit kjo përkthehet në një “të ardhur”, agjenti shpërblehet me komision nga primi i sigurimit, i cili arkëtohet i plotë nga shoqëria e sigurimit. Më pas, në bazë të procesverbaleve përkatëse, përllogaritet komisioni sipas llojit të policës së sigurimit. Nga kjo

shifër, bëhej zbritja e tatimit në burim dhe komisioni neto i jepej *cash* ose me *çek* bankar agjentit. Në mbështetje të sqarimit të mësipërm, subjekti vendos në dispozicion, në cilësinë e provës, dokumente të ruajtura në mënyrë rastësore. Sipas subjektit, pagesat për tatimin në burim janë bërë në bllok nga shoqëritë e sigurimeve për të gjithë agjentët, pjesë e të cilëve ka qenë edhe bashkëshortja. Të ardhurat e gjeneruara nga bashkëshortja si agjente në tregun e sigurimeve janë të ligjshme dhe duhet të përfshihen si të tilla në analizën financiare.

63.9.4. Me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 79, datë 28.01.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, dhe vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.03.2010, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, bashkëshortja u pajis me licencën nr. {\*\*\*} për ushtrim veprimtare *broker*-i në sigurimet e *jojetës*, dhe, më pas, në klasat e *jetës* dhe *risigurimeve*. Që pas këtij momenti, të ardhurat në fushën e tregut të sigurimeve bashkëshortja i ka gjeneruar nëpërmjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, me NUIS {\*\*\*}.

63.9.5. Për mospërputhjet në deklaram të të ardhurave të bashkëshortes nga ndërmjetësimi, në deklaratat periodike vjetore me atë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se konstatimi i Komisionit nuk është i saktë, pasi në deklaratën e vitit 2003, ajo ka deklaruar “3.5 milionë lekë në vit”, dhe jo siç e pasqyron Komisioni “gjithsej 3.5 milionë lekë”. Sa i përket konstatimit se ka mospërputhje në lidhje me periudhën e përfitimit të këtyre të ardhurave, pasi nga vërtetimet e kompanive të sigurimit rezulton realizimi i tyre në harkun kohor 1996 – 2008, ndërsa subjekti i pretendon ato për vitet 1996 – 2010, ai shpjegon se periudha e deklaruar është e saktë, në kushtet që nga bashkëshortja nuk është pretenduar në asnjë moment përfitimi i të ardhurave në këtë mënyrë në vitin 2010. Subjekti pretendon se ka paraqitur prova që nga viti 2010 e në vijim, që vërtetojnë se të ardhurat në fushën e tregut të sigurimeve bashkëshortja i ka gjeneruar nëpërmjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShA.

63.9.6. Për konstatimin e Komisionit se: “Kompanitë e sigurimit nuk kanë provuar me dokumentacion vlerat e deklaruara në vërtetimet e depozituara, si dhe nga verifikimet bankare, nuk mund të identifikohet sa është shuma e përfituar nga ndërmjetësimi në periudhat përkatëse”, subjekti sqaron se shoqëritë e sigurimit i janë referuar rekordeve të brendshme të ruajtura në bazën e të dhënave të përmbledhura ndër vite për të gjithë agjentët e tyre. Shoqëritë e sigurimit, të monitoruara nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, i janë nënshtruar çdo vit një kontrolli shumë të rreptë në lidhje me tatimet e paguara, si ato të vetë shoqërisë, ashtu edhe tatimet e mbajtura në burim. Në kushtet kur bashkëshortja provon marrëdhënien e saj me shoqëritë e sigurimit dhe të ardhurat e përfituara prej saj janë të ligjshme, ato duhet të konsiderohen si të ardhura me burime të ligjshme, të ardhurat e saj për periudhën e sipërcituar, në shumën totale të deklaruar. Ky qëndrim vjen në përputhje edhe me praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>61</sup>.

<sup>61</sup> Në vendimin nr. 6/2022 (JR), të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit H. K., paragrafi 17.4, shkruhet shprehimisht se: “[...]. Në këto rrethana, për sa kohë që detyrimi i përket një personi tjetër dhe jo subjektit të rivlerësimit, dhe nuk ka dyshime për ekzistencën/përfitimin e këtyre të ardhurave nga një burim i ligjshëm, ngarkimi me përgjegjësi i subjektit, sipas ligjit nr. 84/2016, edhe në rast të mosshlyerjes së detyrimeve tatimore nga subjekte të tjera të së drejtës, nuk duket se vjen në harmoni me qëllimin dhe kërkesat e ligjit, i cili konsideron të ardhura të

63.9.7. Sa i përket konstatimit të Komisionit se, nga informacioni i marrë në Qendrën Kombëtare të Biznesit për vitet që janë më afër deklarimit të të ardhurave (2010 – 2012), rezulton se fitimi i deklaruar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA është në vlera më të vogla se të pretenduara nga subjekti për periudhën para vitit 2010, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka prapësuar se: (i) kjo shoqëri, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, ka filluar të gjenerojë të ardhura vetëm në gjashtëmujorin e dytë të vitit, për arsye se në pjesën e parë të tij, bashkëshortja ka qenë e angazhuar intensivisht në dhënien e provimeve, me qëllim marrjen e licencës së *broker-it*. Pra, kjo periudhë ka qenë e ndërmjetme e tranzitore për kalimin e saj nga statusi i *agjentit* në atë të *broker-it të licencuar*, i cili, pas marrjes së licencës duhet të rilidhte tashmë kontrata me të gjitha shoqëritë që ushtronin aktivitet në fushën e sigurimeve. Deri në vitin 2009, të ardhurat neto të përfituara nga komisionet si ndërmjetës në sigurime ishin një e ardhur e disponueshme në mënyrë të menjëherëshme për t’u shpenzuar; (ii) referuar bilanceve të viteve 2011 – 2012 të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, konstatohet se zëri “shitjet neto” është i përafërt në vlerë me komisionet neto të marra deri në vitin 2009. Por, në momentin që aktiviteti kaloi në formën e organizimit si shoqëri aksionare, shpenzimet dhe taksat e nevojshme për t’u paguar për zhvillimin e këtij lloji aktiviteti, sigurisht që janë të konsiderueshme, duke passjellë një ulje të fitimit neto.

63.10. Përveç sa konstaton Komisioni në vendim, paragrafi 77.3. shkronja “a”, se, *sipas informacionit nga ProCredit Bank, rezulton që nga llogaritë bankare të personit fizik, janë kryer pagesa për llogari të “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 2002 – 2003 [...], në vlerat 6.312.138 lekë, 9.010 USD dhe 17.512 euro*, nga analizimi i lëvizjeve të llogarive të znj. R. Zh. në monedhat lek, USD dhe euro në ProCredit Bank ShA, rezulton të jenë kryer disa transaksione që tregojnë se personi i lidhur me subjektin ka ushtruar aktivitetin e ndërmjetësimit me kompanitë e sigurimit, të cilat Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë në analizën e kryer prej tij. Konkretisht, nga llogaria në dollarë amerikanë e R. Zh. në këtë bankë, janë kryer pagesa për shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, në vlerat 2.364 USD, për vitin 2001 dhe 9.266 USD, për vitin 2002. Nga llogaria në euro, janë kryer pagesa për këtë shoqëri sigurimi, në vlerën 3.038,09 euro, ndërsa nga llogaria në lekë, janë kryer pagesa për të njëjtën shoqëri, në vlerat 1.457.137 lekë për vitin 2001, dhe 363.504 lekë për vitin 2002. Pra, nga analizimi i llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit në ProCredit Bank ShA, provohet, *së pari*, ushtrimi i aktivitetit të ndërmjetësimit për sigurime nga ana e saj, prej vitit 2001 e në vijim dhe, *së dyti*, pagesat për shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 2001 – 2003, rezultojnë në total 8.132.779 lekë, 20.640 USD dhe 20.550 euro.

63.11. I pyetur nga Komisioni për sa sipër, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këto pagesa, veprime të kryera në llogaritë e bashkëshortes, të aktivitetit të saj në ProCredit Bank ShA, *janë xhirimet periodike për punën si agjente në sigurime. Gjatë muajit, shiste polica sigurimi të automjeteve, shëndeti e udhëtimi, dhe shumë lloje të tjera policash sigurimi të furnizuara nga shoqëria {\*\*\*}, që u krijua ne shkurt të vitit 1999. Nga vetë*

---

*ligjshme ato të deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, kur këto detyrime i takojnë subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur apo të tjerë të lidhur me të. Kolegji konfirmon qëndrimin e tij mbajtur edhe në çështje të mëparshme që, për sa kohë që të ardhurat janë deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë vetting dhe në ato periodike, dhe provohet se ekzistojnë dhe vijnë pikërisht nga burimi i deklaruar si i tillë prej subjektit, në rast se mosprovueshmëria e pagimit të detyrimeve tatimore i përket një subjekti tjetër, dhe se subjekti nuk ka dijeni apo një sjellje bashkëpunuese në këtë drejtim, duhet të kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016”.*

*përshkrimet e transfertave, është e qartë që, në bazë të procesverbaleve, rakordimeve mujore, është bërë pagesa e policave të arkëtuara në zyrë ose në llogari, kur klienti paguante në bankë. Mund të shikoni dhe, në Bankën Amerikane, Bankën Popullore, ka veprime financiare të lidhura me sigurimet.*

**63.12.** Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, verifikoi llogaritë bankare të personit të lidhur në Intesa Sanpaolo Bank ShA,<sup>62</sup> si individ dhe person fizik, nga të cilat konstatoi se ajo ka kryer pagesa për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 2001 – 2004, në vlerat 2.761.681 lekë, 4.090 USD dhe 8.600 euro, si dhe pagesa të kryera nga kjo shoqëri për periudhën 2008 – 2009, me përshkrimin “komisioni, agjenti për muajin”, në vlerat 19.312 lekë, 1.507 USD dhe 7.102 euro. Sa i përket llogarisë bankare në OTP Bank ShA<sup>63</sup>, të depozituar nga vetë subjekti në Komision, trupi gjykues, sikurse edhe Komisioni, nuk konstaton veprime të kryera për apo nga shoqëritë e sigurimit “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” ShA. Në këtë llogari, evidentohen veprime deri në fund të vitit 2009, vetëm për aktivitetin “agjenci udhëtimesh”, të ushtruar nga personi i lidhur deri në fund të vitit 2009, pasi më datë 05.01.2010, R. Zh. ka regjistruar aktivitetin “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*} (ortake e vetme dhe administratore), i themeluar më datë 28.09.1999, me objekt “agjenci udhëtimi dhe operator turistik, bileta të transportit ajror, detar etj., dhe siguracione [...]”, i organizuar në përgjegjësi tatimore “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”.

**63.13.** Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare më sipër, nuk rezulton asnjë pagesë e kryer nga R. Zh. si individ apo person fizik në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 1999 – 2004 dhe, aq më pak të rakordojë me të ardhurat e konfirmuara nga kjo shoqëri në vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 27.01.2017. Sipas këtij vërtetimi, për vitin 2001, nga ndërmjetësimi me këtë shoqëri, R. Zh. ka realizuar të ardhura në vlerën 237.900 lekë dhe 3.278 USD, ndërkohë që nuk ka paraqitur dokumente analitike për të provuar të dhënat e pasqyruara dhe, nga ana tjetër, nga lëvizjet e llogarive bankare, nuk provohet pagesë e kryer nga bashkëshortja e subjektit në favor të “{\*\*\*}” ShA, por as nga shoqëria për llogari të saj. Edhe sa i përket të ardhurave të provuara nga vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.10.2016, është e njëjta situatë, nuk provohet masa e të ardhurave sipas vërtetimeve, me ato të rezultuara nga lëvizjet e llogarive bankare. Konkretisht, për vitin 2001, sipas vërtetimit të “{\*\*\*}” ShA, rezultojnë të ardhura në masën 914.429 lekë dhe 1.163 USD, ndërkohë që, nga lëvizjet e llogarive bankare, pagesat që R. Zh. ka kryer në favor të kësaj shoqërie për këtë vit rezultojnë në total 2.364 USD, 3.225 euro dhe 2.304.137 lekë, pra, konstatohen mospërputhje mes të dhënave sipas vërtetimit, dhe të dhënave sipas lëvizjeve të llogarive bankare.

**63.14.** Në këto rrethana, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, konstaton se: (i) nga verifikimi i veprimeve bankare nuk mund të identifikohet sa është shuma e përfituar nga ndërmjetësimi në periudhat përkatëse; (ii) të ardhurat sipas këtyre provave, lëvizjeve të llogarive bankare, nuk përputhen me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike, por as me ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, konkretisht, personi i

---

<sup>62</sup> Intesa SanPaolo Bank ShA, ish-Banka Amerikane e Shqipërisë ShA.

<sup>63</sup> OTP Bank ShA, ish-Banka Popullore ShA.

lidhur deklararon 3.500.000 lekë<sup>64</sup> të ardhura nga ndërmjetësimi për vitin 2003. Nga lëvizjet e llogarive bankare, i rezultojnë pagesa vetëm për “{\*\*\*}” ShA në vlerën 9.010 USD, 17.512 euro dhe 5.571.367 lekë, ndërsa, sipas vërtetimeve të dy shoqërive, për vitin 2003, këto të ardhura rezultojnë në vlerën 2.297.410 lekë (674.745 lekë<sup>65</sup> nga “{\*\*\*}” ShA + 1.622.665 lekë nga “{\*\*\*}” ShA<sup>66</sup>); (iii) sa i përket periudhës së përfitimit, vërtetimet e sipërcituara të lëshuara nga dy shoqëritë, “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” ShA, vërtetojnë të ardhura të realizuara nga aktiviteti i ndërmjetësimit, përkatësisht për periudhat 1996 – 2008 dhe 1999 – 2008, ndërkohë që, referuar deklaratimit të subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, rubrika “Të ardhura nga angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike” rezultojnë që të ketë deklaruar të ardhura nga ndërmjetësimi me shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, të realizuara gjatë viteve 1996 – 2010, ndërsa me “{\*\*\*}” ShA, për periudhën 1999 – 2010; (iv) shoqëritë e sigurimit nuk kanë paraqitur dokumentacion provues bashkëlidhur vërtetimeve të të ardhurave, listëpagesa, listë komisionesh etj., për të provuar vlerat e specifikuar në to; (v) sikurse shpjeguar edhe më lart në këtë vendim, nuk është provuar pagimi i tatimit në burim për të ardhurat e deklaruara nga ndërmjetësimi për sigurimet, as nga personi i lidhur me subjektin, dhe as nga shoqëritë e sigurimit, pavarësisht se shoqëritë deklarojnë pagesat e tatimit për këto të ardhura në bllok, por nuk kanë depozituar ndonjë dokument analitik për të provuar sa deklarojnë lidhur me pagesat e tatimeve për të ardhurat nga sigurimet, realizuar nga personi fizik “{\*\*\*}”; (vi) sa i përket pretendimit të subjektit se, referuar kartelës “{\*\*\*}” 2009, ‘Analizë veprime llogarie’, e depozituar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA bashkëlidhur vërtetimit të mësipërm, se kjo shoqëri i ka paguar znj. R. Zh. për këtë vit vlerën 1.967.938 lekë, nuk rakordon me të dhënat e vërtetimit të kësaj shoqërie, e cila nuk ka vërtetuar nga ana e saj të ardhura për vitin 2009; (vii) Referuar të dhënave të pasqyrave financiare<sup>67</sup> të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, e regjistruar më 30.01.2010, rezultojnë që fitimi neto i saj për vitin 2012 të ketë qenë në vlerën 740.269 lekë dhe, për vitin 2013, në vlerën 280.221 lekë, më të ulëta këto se sa i ka pretenduar subjekti i rivlerësimit për periudhën para vitit 2010.

**63.15.** Komisioni, në analizën e kryer, nuk ka marrë në konsideratë asnjë të ardhur lidhur me ushtrimin e aktivitetit si ndërmjetëse të bashkëshortes së subjektit për të gjithë periudhën 1996 – 2009. Po kështu, Komisioni ka vepruar edhe për periudhën tjetër 2010 – 2016, periudhë në të cilën R. Zh. figuron administratore dhe ortakë e vetme në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, regjistruar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.09.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistruar në QKB më datë 05.01.2010, me NIPT {\*\*\*}, dhe në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, regjistruar më datë 30.01.2010, me NIPT {\*\*\*}<sup>68</sup> pasi, sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 11.06.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore, edhe pse këto shoqëri kanë rezultuar me fitim për periudhën 2010 – 2020,

---

<sup>64</sup> Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim, 2003, subjekti i rivlerësimit në formularin “A-6”, rubrika “Të ardhura nga pagat [...]”, ka deklaruar: Agjenci udhëtimi dhe sigurime, (të ardhurat sigurohen nga aktiviteti i udhëtimeve dhe sigurimeve), në shumën 3.5 milionë lekë, NIPT sekondar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, biznes i vogël për udhëtimet. 15% të ardhura nga sigurimet dhe 130.000 lekë si biznes i vogël, nga ku rezultojnë që të ardhurat nga ndërmjetësimi të kenë qenë rreth 525.000 lekë për vitin 2003 dhe 130.000 lekë fitim neto si biznes i vogël. Sa më sipër, nuk rakordon me të ardhurat neto të vërtetuara me vërtetimet e dy shoqërive të sigurimit.

<sup>65</sup> Që konsiston në 198.567 lekë, 2.180 USD, të konvertuar në 236.944 lekë, dhe 1.790 euro, të konvertuar në 239.234 lekë.

<sup>66</sup> Që konsiston në 988.403 lekë, 1.442 USD, të konvertuar në 156.730 lekë dhe 3.573 euro, të konvertuar në 477.531 lekë.

<sup>67</sup> Konkretisht, “Pasqyrë e të ardhurave dhe shpenzimeve” e kësaj shoqërie.

<sup>68</sup> Informacion i konfirmuar edhe nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.06.2021.

ato nuk kanë shpërndarë dividendë<sup>69</sup>. Për periudhën 2010 – 2016, ashtu si edhe Komisioni në analizën e kryer prej tij, në linjë me jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues ka konsideruar vetëm të ardhurat e bashkëshortes nga pagat si administratore në këto shoqëri, provuar me dokumentacion justifikues ligjor.

63.16. Në cilësinë e subjektit deklarues që në vitin 2003, për shkak të të cilit i është nënshtruar edhe kontrollit nga ILDKPKI-ja në vitet 2005 dhe 2009, trupi gjykues, ashtu siç është shprehur edhe Komisioni në vendim, çmon se bashkëshortja e subjektit duhet të tregohet e kujdesshme në ruajtjen e dokumentacionit që provon të ardhurat neto, si dhe të pajiset me dokumentacion përkatës mbi të ardhurat, në kuadër të plotësimit të deklaratës periodike vjetore. Gjithashtu, nisur nga fakti që për vitet 2001 – 2009 rezultojnë disa transfera mes bashkëshortes si person fizik, dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, në përgjigje të barrës së provës, që në kuadër të këtij procesi i ngarkohet subjektit të rivlerësimit, ai mund të kishte saktësuar nga këto lëvizje llogarie me shoqërinë e sigurimit, masën e komisioneve të përfituara.

63.17. Për gjithë sa arsyetuar më lart, trupi gjykues, ashtu sikurse edhe Komisioni, vlerëson që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të provojnë se të ardhurat nga ndërmjetësimi kalojnë testin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të jenë deklaruar e provuar në masën e pretenduar, dhe të jetë provuar pagesa e tatimit për to e, në këto kushte, është vlerësuar që këto të ardhura të mos përfshihen në analizën financiare të kontrolluar në Kolegji. Nga ana tjetër, në linjë me Komisionin, trupi gjykues, në kuadër të kontrollit të analizës financiare 2003 – 2016, ka verifikuar situatën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, në eventualitetin e përfshirjes së këtyre të ardhurave në masën e vërtetuar nga shoqëritë e sigurimit, rezultatet e së cilës gjenden në paragrafin 69 të këtij vendimi.

### *B/9.3. Në lidhje me automjetet ndër vite*

64. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, rezulton që Komisioni të ketë konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë qenë në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e tri automjeteve ndër vite<sup>70</sup>. Subjekti i rivlerësimit, duke përdorur në ankim të njëjtat argumente si në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit lidhur me automjetet.
65. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, as subjekti i rivlerësimit, dhe as personat e lidhur nuk kanë deklaruar automjete në pronësi. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 03.06.2021, po ashtu konfirmon se, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të nuk rezultojnë automjete të regjistruara. Në kushtet kur automjete e analizuar nga Komisioni, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore nga subjekti dhe personi i lidhur, nuk disponoheshin në momentin e plotësimit të deklaratës së

<sup>69</sup> Për shoqërinë “{\*\*\*}” ShA është kryer pagesë tatim mbi dividendin, 872.000 lekë, për periudhën korrik 2019.

<sup>70</sup> (1) Automjeti “Mitsubishi Pajero”, i blerë më datë 10.4.2002, rezultoi me balancë negative në momentin e blerjes, në vlerën (-) 10.973.809 lekë. (2) Për automjetin “Peugeot 206”, rezultoi me balancë negative për pagesat e kryera në datat 29.01.2005 dhe 17.02.2005, përkatësisht në vlerat (-) 2.290.875 lekë dhe (-) 529.408 lekë. (3) Për automjetin “Volkswagen Touareg”, i cili rezulton të jetë vjedhur, më datë 08.06.2012, Agron Zhukri ka bërë kallëzim pranë Komisarariatit të Policisë nr. 2 për vjedhjen e tij.

pasurisë *vetting*, dhe kur të ardhurat nga shitja e tyre nuk janë deklaruar si burim për krijimin e pasurive në këtë deklaratë, trupi gjykues, me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, ndryshe nga Komisioni, nuk verifikoi mundësinë financiare të subjektit në momentin e krijimit të këtyre pasurive, por i ka analizuar ato në kuadër të analizës financiare për secilin vit të periudhës së rivlerësimit 2003 – 2016. Në rrethanat kur efektet financiare gjenden në analizën përmbledhëse financiare, konstatimi i pamjaftueshmërisë financiare për krijimin e tyre duket si një vlerësim joefektiv në kuadër të procesit.

#### *B/9.4. Në lidhje me shpenzimet për udhëtimet familjare dhe ato për qëllime biznesi*

66. Komisioni, në vendim ka vlerësuar se pretendimet dhe shpjegimet lidhur me shpenzimet e udhëtimit janë në nivel deklarativ dhe të pambështetura në prova dhe, si të tilla, Komisioni vlerësoi të mos i marrë në konsideratë ato.
67. Subjekti i rivlerësimit në ankim kundërshton konkluzionin e Komisionit, me pretendimet se: (i) metodologjia e gabuar në përlllogaritjen e shpenzimeve për udhëtimet ka dhënë një impakt negativ total në balancën e subjektit të rivlerësimit, në vlerën 15.800.774 lekë, të cilat duhet të zbriten nga Kolegji në kuadër të shqyrtimit të këtij ankimi. (ii) Komisioni nuk ka dhënë asnjë shpjegim se përse nuk e pranon këtë shpenzim në vlerën 4.124.978 lekë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, i mbështetur nga *statement*-i bankar dhe i regjistruar në librat kontabël të shoqërisë “{\*\*\*}”, por insiston në një përlllogaritje mbi bazë hamendësimi dhe të disa tarifave *shabllon*, pa logjikë tregtare apo juridike që mund t’i pranojë në rastin konkret. (iii) Nuk është e logjikshme dhe arsyeshme të arrihet në konkluzionin që një familje, e cila ka në pronësi një biznes agjenci turistike prej më shumë se 25 vitesh, të ketë shpenzuar për udhëtime të njëjtat shifra si cilido individ i zakonshëm, që nuk ka asnjë lidhje me këtë aktivitet.
68. Nga analizimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon:

68.1. Lidhur me shpenzimet e udhëtimit, në analizën financiare përcjellë subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit, evidentohet se për periudhën 2004 – 2016, “shpenzimet sipas TIMS” janë përlllogaritur në vlerën 19.925.751 lekë. Në kuadër të metodologjisë së përdorur për kryerjen e analizës financiare, Komisioni ka shpjeguar se këto shpenzime “u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje / dalje nëpërmjet sistemit TIMS, të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit, të dhëna në pyetësorë. Për llogaritjen e shpenzimeve, i kemi referuar deklaratimeve të subjektit, si dhe standardit të vendosur nga Kolegji në lidhje me çmimet e biletave dhe shpenzimeve për karburant; shpenzimeve ditore të qëndrimit, kur këto nuk janë provuar me dokumentacion. Nga verifikimi i llogarive bankare, kanë rezultuar pagesa të ndryshme për veshje etj., të cilat i janë ngarkuar subjektit në shpenzimet e kryera gjatë udhëtimeve. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për qëndrimin te të afërmit”.

68.2. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime se të gjitha shpenzimet për të mbuluar këto udhëtime janë përballuar nga shoqëria “{\*\*\*}”, duke përfshirë shpenzimet për biletat e udhëtimit, shpenzimet për akomodimin në hotele, pagesën e tarifës për siguracione ndërkombëtare. Kjo ka ndodhur për faktin se këto shërbime përbëjnë objektin e veprimtarisë tregtare të kësaj shoqërie, e cila krijon mundësinë për t’i përfituar ato me

një kosto minimale, për shkak të *Agent Discount në stand by*<sup>71</sup>. Në asnjë rast, bashkëshortja nuk ka paguar për udhëtimet për vete dhe për familjarët e saj. Në shumë raste, në udhëtimet e punës, ajo është shoqëruar nga subjekti ose djemtë. Një pjesë e udhëtimeve janë mbuluar nga operatorët me të cilët bashkëpunonte dhe, në rastet e pushimeve familjare vjetore, janë rezervuar dhe paguar nga shoqëria “{\*\*\*}”. Gjithashtu, edhe siguracionet për automjete udhëtimi jashtë vendit, që janë pjesë e aktivitetit si agjent në tregun e sigurimeve dhe, më pas si *broker* në sigurime, janë paguar respektivisht nga kjo shoqëri dhe, më pas, nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA. Së bashku me prapësimet, subjekti ka paraqitur një tabelë analitike të shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit, sipas së cilës, shpenzimet sipas TIMS janë përlllogaritur në vlerën 4.124.978 lekë. Në analizën financiare që subjekti i rivlerësimit ka kryer nëpërmjet ekspertit kontabël, në përlllogaritjen e shpenzimeve për këtë zë, është përjashtuar vlera e biletave, e siguracioneve, si dhe kosto e udhëtimeve për qëllime biznesi.

68.3. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka përlllogaritur shpenzimet e udhëtimeve bazuar në metodologjinë<sup>72</sup> e përcaktuar nga Kolegji. Ndonëse logjikshëm të krijohet përshtypja se administrimi dhe zotërimi i një shoqërie me aktivitet “agjenci udhëtimesh” mund të ketë përfitime në drejtim të çmimeve preferenciale, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë akt provues për të mbështetur rezultatin e pretenduar prej tij, edhe pse në kuptim të procesit të rivlerësimit, barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit i ngarkohet atij. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar kontrata, aktmarrëveshje me operatorët me të cilët ka bashkëpunuar bashkëshortja në kuadër të aktivitetit të saj, komunikime mes tyre, në të cilat të jenë parashikuar kushte të tilla si udhëtime falas, pagesa pjesore për udhëtime, ulje në kostot e biletave të akomodimit etj. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se, në asnjë rast bashkëshortja nuk ka paguar për udhëtimet e saj dhe të familjarëve, përveçse nëpërmjet shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në interpretim të trupit gjykues, nuk tregojnë që operatorët u kanë ofruar udhëtime pa kosto, por që kostot e udhëtimeve janë përballuar plotësisht nga shoqëria në pronësi të saj. Këto shpenzime duhet të ishin të bazuara në dokumente justifikuese ligjore apo edhe financiare, marrëveshje, kontrata mes shoqërisë dhe individit, transfertat për pagesa biletash në bazë të një marrëveshje, për të dokumentuar në vijim këto transaksionet, dhe pasqyruar ato në regjistrat kontabël të shoqërisë. Përlllogaritjet e kryera nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ekspertit kontabël për shpenzimet e udhëtimet nuk janë mbështetur në dokumente justifikuese, mbeten në nivel deklarativ dhe, për pasojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë arsyetimin e Komisionit në këtë drejtim.

69. Në mbështetje të arsyetimit më sipër në këtë vendim, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit, nga rezultatet e të cilit trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk justifikojnë më të ardhurat e tyre nga burime të ligjshme, pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara, në vlerën (-) 11.682.545 lekë, për periudhën 1993 – 2002, dhe në vlerën (-) 60.728.266 lekë, për periudhën 2003 – 2016, në total (-) 72.856.380 lekë. Ndryshe nga Komisioni, trupi gjykues nuk ka konsideruar në analizën e kontrolluar, kostot e investimit për ndërtimin e katit papafingo në vitet 2004, 2005 dhe 2006, në vlerën totale 1.407.669 lekë, si dhe gjendjen e likuiditetit të personit

<sup>71</sup> Zbritje në kosto për agjenci udhëtimesh.

<sup>72</sup> Shih vendimin nr. 11/2019 (JR) të Kolegjit.

fizik me emër tregtar “{\*\*\*}” në banka të nivelit të dytë<sup>73</sup>, për periudhën 2001 – 2009, me arsyetimin se aktiviteti ekonomik është krejtësisht i pavarur nga ai i njësisë familjare të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues, pavarësisht efektit financiar që do të prodhonte përfshirja e të ardhurave të bashkëshortes së subjektit nga ndërmjetësimi në sigurime, për pasuritë e trajtuara më sipër në këtë vendim, në kuadër të analizës financiare, edhe në një variant garantist të përfshirjes së tyre, rezultatet do të tregonin një balancë negative në vlerën (-) 51.034.255 lekë. Për sa më sipër, rezultatet financiare provuan se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

70. Në përfundim, trupi gjykues në Kolegj, mbështetur në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe, për pasojë, çmon se vendimi nr. 759, datë 19.04.2024, i Komisionit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 759, datë 19.04.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Agron Zhukri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 06.11.2025, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

---

<sup>73</sup> Intesa Sanpaolo Bank ShA, Credins Bank ShA, Raiffeisen Bank ShA, Procredit Bank ShA dhe OTP Bank ShA.